



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Empowered lives
Resilient nations.

SHQYRTIM KRAHASUES I ROLIT TË KËSHILLAVE KOMUNALË



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Empowered lives
Resilient nations.

SHQYRTIM KRAHASUES I ROLIT TË KËSHILLAVE KOMUNALË

AUTOR

Antonella Valmorbida

“Le vivre, c’est servir (...) et en veut faire un acte d’honneur et de vertu”

“Të jetosh është të shërbesh (...) duke e konsideruar atë një akt nderi dhe virtuti ”

Michel de Montaigne (1533–1592), *Essais - Livre II.*

“To know how to be, to know how to do, to know how to become”

“Të dish të jesh, të dish të bësh, të dish si të bëhesh”

Motivimi i shprehur nga një pjesëmarrës në një kurs trajnimi rreth Demokracisë Pjesëmarrëse,

Oran, Algjeri, shkurt 2017

Rezultati më i mirë i kapaciteteve të trajnimit për arsimin e të rriturve është “të mësuarit duke bërë”

Parimet e Arsimit të të Rriturve

Ky Shqyrtim Krahasues u hartua si pjesë e projektit “Fuqizimi i Këshillave Komunalë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Pikëpamjet e paraqitura në këtë shqyrtim janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të SDC dhe UNDP.

Përmbajtja

Shkurtesa	4
Fjalor i termave	5
Rreth autorit	6
1. PËRMBLEDHJE	7
2. HISTORIKU DHE METODOLOGJIA	8
2.1. Vendet e përfshira në shqyrtim - disa elemente kryesore	9
2.1.1. Faktorët e jashtëm	9
2.1.2. Faktorët e brendshëm	10
2.2. Metodologjia e hulumtimit	11
3. GJETJE DHE REKOMANDIME	12
3.1. Gjetjet e përgjithshme	12
3.2. Rekomandimet e përgjithshme	12
3.3. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet për secilin tregues	13
3.3.1. Funksionimi dhe struktura e këshillave komunalë	13
3.3.2. Këshillat komunalë dhe roli i tyre në financa dhe buxhetim	17
3.3.3. Roli i këshillave komunalë në qeverisjen e mirë dhe demokracinë në nivel lokal	20
3.3.4. Tregues të tjerë relevantë (bashkëpunimi ndër-komunal, zhvillimi i kapaciteteve dhe rrjetëzimi)	23
4. SHQYRTIM KRAHASUES	27
4.1. Këshillat komunalë në Maqedoni, pika jonë fillestare dhe përfundimtare	27
4.2. Funksionimi i këshillave komunalë dhe struktura e tyre	29
4.2.1. Zgjedhja e këshillave komunalë	29
4.2.2. Kompetencat e këshillave komunalë	30
4.2.3. Komisionet dhe organet e brendshme të këshillave komunalë	31
4.2.4. Rregullorja e punës e këshillit komunal, përgatitja dhe shpërndarja e materialit për vendimet e këshillit	34
4.2.5. Kompensimi i këshilltarëve komunalë	35
4.3. Këshillat komunalë dhe roli i tyre në financa dhe buxhetim	36
4.3.1. Roli i këshillave komunalë në procesin buxhetor	36
4.3.2. Këshillat komunalë kontrollojnë mbishpenzimet	37
4.3.3. Roli i këshillave komunalë në përcaktimin e taksave komunale	40
4.3.4. Planet e prokurimit, borxhet dhe asetet e autoriteteve lokale	41
4.3.5. Kontrollat e brendshme dhe të jashtme	44
4.4. Roli i këshillave komunalë në qeverisjen e mirë dhe demokracinë në nivel lokal	47
4.4.1. Marrëdhëniet ndërmjet këshillave komunalë, kryetarëve të komunave dhe administratës komunale	48
4.4.2. Roli i këshillave komunalë në forma të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare (referendume lokale, iniciativa qytetare, dëgjime publike dhe forma të tjera)	49
4.4.3. Këshillat komunalë dhe përfshirja ndëretnike	53
4.4.4. Dispozitat ligjore dhe politikat e orientuara drejt barazisë gjinore në nivel lokal	55
4.5. Tregues të tjerë të rëndësishëm	57
4.5.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe përzgjedhja e kreut të administratës	57
4.5.2. Roli i këshillave komunalë në bashkëpunimin ndër-komunal	58
4.5.3. Instrumentet për ngritjen e kapaciteteve dhe skemat e motivimit për këshilltarët komunalë	61
4.5.4. Skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të rrjetëzimit për këshilltarët komunalë	62
5. INTERVISTAT DHE MBËSHTETJA	63
6. MATERIALE DHE BIBLIOGRAFI	64

SHKURTESA

ALAL	»	Asociacioni i Autoriteteve Lokale të Lituanië
ALDA	»	Asociacioni Evropian për Demokraci Lokale
OSHC	»	Organizata të Shoqërisë Civile
BE	»	Bashkimi Evropian
PLDK	»	Autoritetet Lokale në Danimarkë
KK	»	Këshilli Komunal
NALAS	»	Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore
OJQ	»	Organizata joqeveritare
OECD	»	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OSBE	»	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SIGMA	»	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit, iniciativë e përbashkët e OECD-së dhe Bashkimit Evropian
UNDP	»	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	»	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Ndihmë dhe Bashkëpunim
BNJVL	»	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë

FJALOR I TERMAVE

Institucione

- **Auditor:** Kontrollues i llogarive.
- **Komisione/komitete:** Organet punuese të përbërë nga një numër i kufizuar këshilltarësh komunalë, shpesh të organizuar sipas temës, të cilët takohen ndërmjet seancave plenare të këshillit komunal.
- **Kontrollues:** Zyrtar që zbaton kontrollin e jashtëm në Lituani.
- **Këshilltarë:** Zyrtarët e zgjedhur në zgjedhjet lokale si anëtarë të këshillave komunalë (ose kuvendet komunale në Serbi).
- **Bashkësitë etnike:** Term që përdoret në Maqedoni për t'iu referuar pakicave etnik.
- **Magjistrat:** Organ pune ndërmjetës i përbërë nga këshilltarë komunalë në qytetet e mëdha në Danimarkë.
- **Kryetar i Komunës:** Kryetari i komunës është zyrtari më i lartë në pushtetin komunal. Në Serbi quhet Kryetar i Komunës.
- **Këshilli Komunal:** Kuvendi i këshilltarëve komunal të zgjedhur në zgjedhjet lokale. Mund t'iu referohet edhe atyre që quhen këshillat e qytetit. Në Serbi, këshilli komunal është organi ekzekutiv që ndihmon kryetarin e komunës.
- **Kuvendi Komunal:** Në Serbi, kuvendet komunale janë ekuivalente me këshillat komunalë.
- **Anëtarët e Kuvendit Komunal:** Termi serb për këshilltarët komunalë.
- **Bashkësi lokale:** Një njësi e zgjedhur ose e emëruar e pushtetit lokal që përfaqëson një lagje.
- **Kryetar i Kuvendit:** Kryetar i kuvendit komunal në Serbi.
- **Sekretar i Komunës:** Kreu i administratës në komunat e Maqedonisë.
- **Organi mbikëqyrës:** Ky organ kontrollon financat komunale në Slloveni.
- **Lagje:** Nën-komuna në Lituani.

Termet specifik

- **Qeverisja** i referohet proceseve të ndërveprimit dhe vendimmarrjes midis aktorëve të përfshirë në një çështje që çon në krijimin, përforcimin dhe riprodhimin e normave dhe institucioneve shoqërore.
- **Qeverisja lokale** iu referohet mënyrave të organizimit të vendimmarrjes së një bashkësie lokal, rregullave, institucioneve dhe ndërveprimeve të tyre me shoqërinë civile.
- **Afërsia** i referohet politikave që vlerësojnë shërbimet dhe politikat në komunitetet më të ngushta.
- **Bashkimi Evropian** është një bashkim politik dhe ekonomik i 28 shteteve anëtare që janë të vendosura kryesisht në Evropë. Maqedonia ende nuk është midis 28 anëtarëve.
- **Këshilli i Evropës** është organizatë ndërkombëtare qëllimi i së cilës është të mbështesë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë dhe të promovojë kulturën evropiane. Përfshin 47 vende (duke përfshirë edhe Maqedoninë).
- **Procesi i Zgjerimit të BE-së** është përcaktuar nga BE-ja si proces i zgjerimit të anëtarësimit të saj në përputhje me Kriteret e Kopenhagës dhe rrugëtimin politik. Të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë dhe Shqipëria janë ose në proces të aderimit në BE ose tashmë janë anëtare të BE-së.

RRETH AUTORIT

Antonella Valmorbida është eksperte e lartë për qeverisjen lokale dhe demokracinë pjesëmarrëse në nivel lokal. Ka marrë pjesë në zhvillimin dhe drejtimin e Asociacionit Evropian për Demokraci Lokale (ALDA) që nga krijimi i tij në vitin 1999. Ajo është ndër ekspertët kryesorë në Evropë që promovojnë dhe zbatojnë programe të demokracisë pjesëmarrëse dhe demokracisë lokale. Në Evropën Juglindore ka punuar që nga viti 1996. Ka jetuar në Kroaci nga viti 1996 deri në vitin 2000, duke themeluar Agjencinë për Demokraci Lokale (një program i Këshillit të Evropës që më vonë ka krijuar ALDA) në Sisak. Ka drejtuar Agjencitë e Demokracisë Lokale dhe programe të tjera në Bosnje Hercegovinë dhe pastaj në pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor, në periudhën e pasluftës në procesin e para-aderimit në BE. Që nga viti 2000, është përgjegjëse, së bashku me stafin lokal, i një spektri të gjerë të programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar që mbështesin qeverisjen lokale në Ballkan, Evropën Lindore dhe zonën e Mesdheut, duke përfshirë Maqedoninë.

Angazhohet në analizën e qeverisjes lokale, në zbatimin e projekteve, në punën e menaxhimit dhe avokimit në vendet anëtare të BE-së, si dhe në zgjerimin e BE-së dhe në vendet fqinje. Ka njohuri të gjera në këtë fushë dhe kontribuon në hartimin e politikave në Këshillin e Evropës dhe në nivel të BE-së. Ka mbështetur hartimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe parimin e "lokalizimit" të tyre. Ka botuar libra dhe artikuj akademikë mbi temat e bashkëpunimit të decentralizuar, qeverisjes lokale dhe demokracisë pjesëmarrëse dhe inkluzive. Është eksperte, konsulente dhe trajnere për programe të mëdha të UNDP-së dhe Komisionit Evropian për qeverisjen lokale, demokracinë, dhe fuqizimin e autoriteteve lokale dhe e shoqërisë civile.

Është Sekretare e Përgjithshme e ALDA-s, Kryetare e Bordit të Partneritetit Evropian për Demokraci (EPD), dhe koordinatore e nëngrupit për Reformën e Qeverisjes Lokale dhe Administratës Publike të Forumit të Shoqërisë Civile për Partneritetin Lindor. Ajo është gjithashtu e përfshirë në Concord, Konfederata e OJQ-ve Evropiane për Ndihmë dhe Zhvillim.

Flet rrjedhshëm italisht, frëngjisht, anglisht dhe rusisht. Kupton spanjishten, gjermanishten dhe serbishten.

1. PËRMBLEDHJE

Ky Shqyrtim krahasues është pjesë e një projekti më të gjerë të quajtur "**Fuqizimi i Këshillave Komunalë**", që synon përmirësimin e performancës dhe rolit të këshillave komunalë në kuadër të njëjësive të vetëqeverisjes lokale në Maqedoni¹ nëpërmjet një game të gjerë masash mbështetëse. Objektivi kryesor i projektit është të fuqizojë këshillat komunalë në mënyrë që të bëhen organe më efektive dhe autonome, në gjendje për të përballuar më mirë ndikimin e pushtetit ekzekutiv, duke përbushur në mënyrë të duhur rolet e tyre të ligjvënies, mbikëqyrjes dhe përfaqësimit të caktuara me Kushtetutë. Projekti synon të arrijë një ekuilibër më të mirë dhe më demokratik të pushteteve, të angazhojë gratë dhe bashkësitë etnike në politikbërje dhe të gjitha aspektet e qeverisjes lokale, duke u fokusuar në proceset novatore pjesëmarrëse. Këshillat komunalë kanë potencial për forcimin e llogaridhënies dhe mbikëqyrjen e performancës së vetëqeverisjes lokale, si dhe për vendosjen e lidhjeve të forta me qytetarët (duke arritur kështu një qasje më të suksesshëm pjesëmarrëse në qeverisjen lokale). Këshillat komunalë duhet të kontribuojnë për të siguruar një balancë të shëndoshë institucionale të kompetencave në lidhje me fushëveprimin e kompetencave të funksionit të kryetarit të komunës dhe stafit të tij, të cilët janë shpesh qendra fokale e vendimmarrjes në nivelin lokal. Programi ka për qëllim përforcimin e kapaciteteve të këshilltarëve komunalë (përmes legjislacionit dhe praktikave) për të krijuar ndryshime sistematike dhe për t'i bërë ato vlerë e shtuar e rolit të tyre pro-aktiv në demokracinë lokale. **Ky shqyrtim krahasues do të kontribuojë në arritjen e këtyre qëllimeve duke paraqitur kornizat ligjvënëse dhe institucionale për këshillat komunalë në vende të ndryshme, duke identifikuar praktikat e mira, dhe masat mbështetëse për të reformuar sistemin ekzistues në Maqedoni.** Shqyrtimi do të shërbejë si një projekt për të filluar diskutimet në ngjarjet e rrjetëzimit që do të organizohen në tema të ndryshme që lidhen me vetëqeverisjen lokale brenda kornizës së projektit. Krahasimi i mjediseve të ndryshme do të mundësojë një kuptim më të hollësishëm të kontekstit maqedonas, si dhe do të mbështesë me rekomandime të mëtejshme, duke përfshirë rregullimet e mundshme legjislative dhe paraqitjen e zgjidhjeve dhe praktikave inovative.

1 Në pajtim me Rezolutën 817 të Këshillit për siguri të Kombeve të bashkuara, për shtetin shfrytëzohet referenca e përkohshme "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" për të gjitha qëllimet në kuadër të Kombeve të bashkuara.

2. HISTORIKU DHE METODOLOGJIA

Treguesit e krahasimit të përdorur për këtë shqyrtim janë përzgjedhur nga aktorë të ndryshëm të projektit së bashku me ekipin e projektit dhe në koordinim të ngushtë me konsulentin ndërkombëtar të kontraktuar për të përgatitur këtë shqyrtim krahasues.

Treguesit krahasues mbulojnë katër tema të vetëqeverisjes lokale relevante për projektin:

a) Funksionimi i këshillave komunalë dhe struktura e tyre

Kjo pjesë e shqyrtimit përqendrohet në funksionet themelore të këshillave komunalë dhe mënyrat në të cilat ato janë të strukturuar për të zbatuar kompetencat e tyre. Njohja e mënyrave në të cilat anëtarët e këshillit zgjidhen dhe organizohen për të kryer proceset e tyre vendimmarrëse, nevojitet për të kuptuar potencialin e tyre dhe për të identifikuar mundësitë dhe sfidat. Më konkretisht, shqyrtimi është i orientuar drejt treguesve në vijim:

- Zgjedhjet për këshillat komunalë
- Kompetencat e këshillave komunalë
- Komisionet dhe organet e brendshme të këshillave komunalë
- Rregulloret e këshillave komunalë dhe përgatitja e materialeve për informimin e vendimeve të këshilltarëve
- Kompensimi i këshilltarëve komunalë

b) Këshillat komunalë dhe roli i tyre në financa dhe buxhetim

Kjo pjesë e shqyrtimit përqendrohet në kontrollin financiar dhe kompetencat përkatëse të këshilltarëve komunalë. Roli i rëndësishëm që luajnë këshillat komunalë në financa dhe buxhetim shton vlerën e rolit të tyre në përkrahjen e llogaridhënies demokratike dhe ekuilibrit midis roleve të ndryshme të kryera nga organe të ndryshme të institucioneve të vetëqeverisjes lokale. Brenda këtij grupi treguesish, analiza është e orientuar drejt:

- Rolit të këshillave komunalë në procesin buxhetor
- Kontrollit të mbishpenzimeve nga këshillat komunalë
- Rolit të këshillave komunalë në përcaktimin e taksave komunale
- Planet e prokurimit, borxhet dhe asetet e autoriteteve lokale
- Kontrollat e brendshme dhe të jashtme

c) Roli i këshillave komunalë në qeverisjen e mirë dhe demokracinë në nivel lokal

Kjo pjesë e shqyrtimit përqendrohet në rolin e këshillave komunalë në inkluzivitetin dhe kohezionin në raport me përfaqësuesit e ndryshëm të komunitetit. Në veçanti, këtu argumentohet se këshillat komunalë duhet të përfaqësojnë një trup demokratik legjitim dhe këshillëdhënës, duke balancuar rolet ekzekutive të pushtetit lokal. Në kuadër të këtij shqyrtimi janë analizuar treguesit specifik në vijim:

- Marrëdhëniet ndërmjet këshillave komunalë, kryetarëve të komunave dhe administratës komunale
- Roli i këshillave komunalë në forma të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare (referendume lokale, nisma qytetare, dëgjime publike etj.)
- Këshillat komunalë dhe përfshirja e minoriteteve
- Dispozitat ligjore dhe politikat e orientuara drejt barazisë gjinore në nivel lokal.

ç) Tregues të tjerë relevantë (menaxhimi i burimeve njerëzore, bashkëpunimi ndër-komunal, zhvillimi i kapaciteteve dhe rrjetëzimi)

Për të identifikuar potencialin e plotë të këshillave komunalë për fuqizimin e qeverisjes lokale në nivel lokal, janë përzgjedhur një numër treguesish të tjerë relevantë. Ato kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm

dhe mundësitë e trajnimit. Më konkretisht, analiza orientohet drejt:

- Menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përzgjedhjes së Kreut të Administratës
- Rolit të Këshillave komunalë në bashkëpunimin ndër-komunal
- Instrumentet për ngritjen e kapaciteteve dhe skemat e motivimit për këshilltarët komunalë
- Skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të rrjetëzimit për këshilltarët komunalë

2.1. Vendet e përfshira në shqyrtim - disa elemente kryesore

Pesë vendet që ishin objekt i këtij shqyrtim krahasues janë Shqipëria, Serbia, Sllovenia, Lituania dhe Danimarka. Dy nga këto vende (Shqipëria dhe Serbia) ndajnë kufirin me Maqedoninë, ndërsa Sllovenia i takon rajonit të njëjtë më të gjerë dhe tanimë është anëtare e BE-së. Lituania dhe Danimarka janë përfshirë si vende relativisht të vogla dhe të krahasueshme. Danimarka u anëtarësua në BE në vitin 1973 ndërsa Lituania në vitin 2004. Këto vende u përzgjedhën përmes një procesi konsultimi midis konsulentit ekspert dhe ekipit të projektit pas shqyrtimit dhe vlerësimit të disa vendeve. Pesë vendet u përzgjedhën gjithashtu për të siguruar një grup të ekuilibruar eksperiencash, duke përfshirë vende anëtare dhe jo-anëtare të BE-së, të cilat duhet të jenë të dobishme dhe relevante në kontekstin e Maqedonisë.

Më poshtë janë dhënë faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që sollën deri te përzgjedhja e këtyre vendeve.

2.1.1. Faktorët e jashtëm

Dy nga vendet e përfshira në këtë shqyrtim, Sllovenia dhe Serbia, në të kaluarën kanë qenë pjesë e Federatës Jugosllave, ashtu si Maqedonia. Shqipëria është pjesë e një rajoni më të gjerë të Ballkanit Perëndimor, por ka ndjekur një rrugë tjetër historike nga këto vende ish-Jugosllave. Sllovenia u anëtarësua në BE në vitin 2004. Procesi i para-anëtarësimit në BE,² të cilin ende e ndjekin Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia, ka shërbyer për të niveluar dallimet midis konteksteve lokale në aspektin e administratës publike dhe qeverisjes lokale duke vendosur standarde dhe objektiva. Të gjitha vendet e përfshira në këtë shqyrtim kanë nënshkruar Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale të Këshillit të Evropës dhe kështu ndajnë të kuptuarit e përbashkët të sistemeve të qeverisjes lokale. Megjithatë, mentalitetet dhe kontekstet administrative në Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni mbeten të ndikuara fuqimisht nga e kaluara e afërt.

Lituania dhe Danimarka janë të vendosura në Detin Baltik në Evropën Veriore, një rajon me një histori të gjatë bashkëpunimi rajonal, transferim të njohurive dhe shkëmbim praktikash të mira.³ Kjo vendndodhje e veçantë territoriale gjithashtu krijoi një ndjenjë të fortë solidariteti dhe përkatësie të ndërsjellë.

Procesi i anëtarësimit në BE, për më tepër, ka siguruar një *raison d'être* të ri për vendet në këtë rajon.⁴ Lituania ka qenë një histori suksesi në tranzicionin demokratik dhe rimëkëmbjen ekonomike që kur fitoi pavarësinë nga BRSS. Danimarka është një nga vendet më demokratike në botë dhe një nga vendet më të pasura në BE. Është vend që respekton të drejtat e qytetarëve dhe gëzon një nivel shumë të lartë të qeverisjes së mirë.

2 Serbia është zyrtarisht vend kandidat për BE që nga shkurti i vitit 2012, ndërsa Shqipëria që nga 23 qershori 2014.

3 Të gjitha vendet në Detin Baltik i përkasin një forme organizatash rajonale, siç është Këshilli i Shteteve të Baltikut: <http://www.cbss.org> or <http://www.balticcouncil.org/en/sakums/>.

4 Termi francez fjalë për fjalë do të thotë "arsyeja për të qenë". Këtu kuptohet si 'një lloj i ri i të qenurit/ një gjendje e re esenciale'.

2.1.2. Faktorët e brendshëm

Shqipëria, Lituania dhe Sllovenia kanë përafërsisht të njëjtin numër të banorëve (2-3.5 milionë), ndërsa Serbia ka një popullsi prej 7 milionë banorësh.⁵ Popullsia e Danimarkës është pak më shumë se 5 milionë.

Lituania, Serbia dhe Sllovenia, të gjitha kanë dy nivele të qeverisjes lokale, pra qeveri të nivelit shtetëror dhe pushtet në nivel të komunës/zytytetit. Këto tre vende gjithashtu kanë një sistem të rajoneve statistikore, kryesisht për qëllime administrative. Shqipëria dhe Danimarka kanë administrim të nivelit rajonal, me sisteme të ndryshme të emërimit/zgjedhjeve dhe kompetencave. Shqipëria dhe Danimarka kanë zbatuar reforma të gjera territoriale që kanë çuar në njësi shumë të zgjeruar të qeverisjes lokale.

VENDET	NIVELET E QEVERISJES LOKALE	NUMRI I KOMUNAVE
SHQIPËRIA	Niveli qendror, regjional dhe komunal	61
SERBIA	Niveli qendror dhe komunal	174
SLOVENIA	Niveli qendror dhe komunal	212
LITUANIA	Niveli qendror dhe komunal	60
DANIMARKA	Niveli qendror, regjional dhe komunal	98

Danimarka filloi me zbatimin e reformave të qeverisjes lokale në vitin 2007 me të cilat e reduktoi numrin e komunave të saj nga 271 në 98 dhe i organizoi ato në pesë rajone të mëdha (duke zëvendësuar qarqet e vogla të organizimit administrativ të mëparshëm). Në vitin 2016, Shqipëria reduktoi numrin e bashkive të saj nga 373 në 61, të organizuara në 12 qarqe. Të gjithë kryetarët e këtyre dymbëdhjetë qarqeve, së bashku me disa këshilltarë bashkiak, janë të përfaqësuar në një këshill të qarkut.⁶

Ashtu si e konfirmon ky shqyrtim krahasues i këtyre pesë vendeve dhe shembujve në vendet e tjera evropiane, ka një **tendencë drejt bashkimit të komunave më të vogla në regjione më të mëdha. Kjo tendencë ka për synim të sigurojë nivele më të mira të ofrimit të shërbimeve për qytetarët përmes racionalizimit dhe bashkimit të burimeve.**⁷

Është interesante të theksohet se në të pesë vendet, **pakicat etnike autoktone** janë identifikuar dhe janë paraqitur në mënyrë të qartë në të dhëna. Kjo çështje nuk ka shumë rëndësi në Danimarkë (ku çështjet etnike janë më të përqendruara në politikën e migracionit), përveç në raport me minoritetin gjerman në Schleswig të Veriut, të cilët gëzojnë një shkallë të caktuar të autonomisë.⁸ Shumicat etnike në secilin nga katër vendet që ofruan të dhëna për këtë çështje përbëjnë përafërsisht 80% të popullsisë së përgjithshme. Në Slloveni, përveç pakicave etnike nga Ballkani, grupin etnik më të madh e përbëjnë italianët. Në Serbi, hungarezët përbëjnë pakicën më të madhe etnike, të përqendruar kryesisht në krahinën autonome të Vojvodinës. Në Lituani, polakët janë grupi më i madh etnik, ndërsa popullsia e përzier etnike e minoritetit etnik përfshin grekët, maqedonasit dhe grupet e tjera etnike nga Ballkani. Bashkësia rome është i pranishëm si pakicë në të gjitha vendet e Ballkanit.

5 Ky Shqyrtim Krahasues nuk përfshin Kosovën.

6 Më shumë detaje rreth rajoneve shqiptare në tekstin e mëposhtëm.

7 Për më shumë informacion, shih: <http://www.oecd.org/regional/regional-policy>

8 <http://denmark.dk/en/society/greenland-the-faroes-and-the-german-minority/the-german-minority-in-denmark>.

2.2. Metodologjia e hulumtimit

Kjo analizë bazohet në një studim të gjetjeve që janë sistemuar në një matricë me një shënim kryesorë për secilin tregues. Këtu janë përmbledhur rezultatet e këtij studimi që të bëhet një prezantim më i aksesueshëm dhe për të nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe dallimet midis sistemeve të pushteteve lokale të vendeve, me qëllim të përdorimit të këtyre të dhënave për kontekstin e Maqedonisë. Disa elementeve dhe specifikave kryesore inovative iu është kushtuar vëmendje më e madhe dhe janë analizuar në mënyrë më të detajuar me qëllim të konceptimit të disa prej rekomandimeve që duhet të ndahen me palë të ndryshme të interesuara. Kjo analizë gjithashtu përfshin të dhëna nga hulumtimi të cilat, megjithëse nuk janë të lidhura ngushtë me treguesit, megjithatë janë të vlefshme për të kuptuar më mirë rolet dhe funksionimin e këshillave komunalë. Fusnotat shpesh japin referenca për shpjegime më të detajuara të koncepteve. *Tabelat krahasuese* jepen për siguruar krahasime të shpejta vizuale të të dhënave të ndryshme.

Metodologjia e studimit pas këtij shqyrtimi përfshiu hapat e mëtejshëm:

- a) **Shqyrtimi dokumentues:** Materialet relevante u grumbulluan nga burime të ndryshme, siç janë ligjet, literatura, artikujt dhe faqe të internetit. Shqyrtimi i dokumenteve përfundoi me **intervista me persona të fushës në vendet e ndryshme të studimit**, duke përfshirë përfaqësuesit e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale, ekspertët kryesorë nga qarqet akademike, shoqëria civile dhe praktikuesit.⁹
- b) **Punëtori të politikave me aktorët kryesorë për mbledhjen e të dhënave dhe shkëmbimin e pikëpamjeve me institucionet përkatëse:** Në punëtorinë e politikave u mbledhën rreth 40 pjesëmarrës nga institucionet qeveritare, autoritetet lokale dhe OJO-të. Punëtorja kishte për qëllim të kontribuojë në një kuptim më të thelluar të kuadrit ligjor lokal dhe faktik në Maqedoni dhe për të ndarë me të gjithë cilësinë dhe orientimin e treguesve. Punëtorja u mbajt në Shkup më 14 qershor 2017.
- c) **Vizitat në terren dhe intervistat:** Vizitat në terren në komuna u zhvilluan në periudhën prej 14-16 qershor 2017. Këto vizita dhe intervista mundësuan mbledhjen e të dhënave të vlefshme dhe për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë që aktorët lokalë i shohin sot në fuqizimin e këshillave komunalë. Intervistat u mbajtën me përfaqësuesit e mëposhtëm:
 - Përfaqësues të Ministrisë së Financave
 - Përfaqësues të BNJVL-së
 - Përfaqësues të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shkup
 - Përfaqësues të Ministrisë të Vetëqeverisjes Lokale
 - Përfaqësues të Komunës Gradsko
 - Përfaqësues të Këshillit Komunal të Komunës Kisella Voda
 - Kryetari i Komitetit të Këshillave të BNJVL-së
 - Përfaqësues të UNDP-së Maqedoni

3. GJETJE DHE REKOMANDIME

3.1. Gjetjet e përgjithshme

Studimi për këtë shqyrtim nxori në pah disa ngjashmëri në secilin tregues, por gjithashtu dallime dhe inovacione frymëzuese. Fakti që të gjitha vendet janë shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe kanë ratifikuar Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, ofron një bazë të fortë për krijimin e strukturave të ngjashme të qeverisjes lokale dhe për zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë lokale dhe demokracisë lokale. Megjithatë, dallime të mëdha mund të vërehen në lidhje me kapacitetin e tyre për zbatim.

Në të gjitha vendet e përfshira në këtë shqyrtim, legjislacioni aktual mbi qeverisjen vendore parasheh një rol më të rëndësishëm për këshillat komunalë sesa që këta këshilla luajnë në realitet. Megjithatë, praktikrat nganjëherë mund të kapërcejnë dështimet dhe dobësitë e rregulloreve, dhe madje edhe të arrijnë zgjidhje të shpejta dhe efektive. Vrojtimit dhe rekomandimet tona në këtë shqyrtim synojnë të sigurojnë që **pritet të përputhen me realitetin**.

Ky vështrim thekson praktikrat e mira që u japin këshilltarëve komunalë një rol kyç në planifikimin dhe monitorimin e financave dhe buxheteve në komunën e tyre. Të gjitha vendet e përfshira në këtë shqyrtim ndjekin parimin e angazhimit të këshilltarëve në punën e komisioneve dhe komisioneve që punojnë në hartimin e buxhetit. Nga ana tjetër, roli i organeve ekzekutive dhe i administratës mbetet thelbësor në fushën e çështjeve buxhetore në nivel lokal. Potenciali i këshilltarëve komunalë për të mbikëqyrur mbishpenzimet të mundshme mbetet edhe më të i kufizuar. Ky shqyrtim tregon rëndësinë e të pasurit të një legjislacioni të rreptë për të rregulluar monitorimin dhe kontrollin e shpenzimeve të tepërta duke kombinuar kontrollet e brendshme dhe të jashtme.

Rekomandimet e paraqitura këtu bazohen në analizën tonë të pesë vendeve dhe krahasimin me legjislacionin dhe praktikrat në Maqedoni. Ato gjithashtu rrjedhin nga një synim më i gjerë i forcimit të **forumeve demokratike dhe këshillave të qeverisjes lokale për t'i ndihmuar komunitetet të arrijnë objektivat e tyre të stabilitetit, gjithëpërfshirës dhe zhvillimit socio-ekonomik**.

3.2. Rekomandimet e përgjithshme

Rekomandimet e mëposhtme të sugjeruara nga ky shqyrtim përfshijnë dy nivele veprimi: a) ndryshime në rregulloret dhe legjislacionin; b) zhvillimin e praktikave dhe elementeve kulturore. Për të arritur qëllimet e projektit të Fuqizimit të Këshilltarëve Komunalë duhet të adresohen të dyja këto nivele të veprimit.

- **Të forcohet ndjenja e përgjegjësisë qytetare dhe qasja e orientuar nga vlerat e këshilltarëve komunalë.** Këshilltarët komunalë mundet dhe duhet të mbështeten në zhvillimin e një ndjenje më të madhe të përgjegjësisë qytetare ndaj bashkësive. Kjo mund të arrihet duke shtuar vlerën e rolit të tyre në shoqëri dhe duke balancuar në mënyra të ndryshme rolin e tyre në qeverisjen lokale në raport me kryetarin e komunës dhe administratën. Rekomandimet duhet gjithashtu të rrënjosen në vlerat e demokracisë lokale dhe shërbimit ndaj komunitetit duke ngritur profilin etik të miratuar nga çdo këshilltarë komunalë. Kjo mund të arrihet duke hartuar një skemë motivuese për këshilltarët komunalë, sipas rekomandimeve të theksuara në këtë shqyrtim. Një **skemë e tillë motivuese** duhet të përfshijë bashkëveprimet dhe partneritetet midis këshilltarëve komunalë dhe qytetarëve, në mënyrë që të forcojë **respektin dhe besimin** e ndërsjellë.
- **Të forcohet besimi i publikut në qeverisjen lokale.** Këshillat komunalë të fuqizuar duhet të përpiqen të zhvillojnë një marrëdhënie të re midis qytetarëve dhe qeverisjes lokale, duke forcuar kështu besimin dhe respektin. Instrumentet e propozuara duhet të mbështesin veprimet e orientuara në këtë drejtim.
- **Të zhvillohet një sistem i “kontrollit dhe balancës” në qeverisjen lokale me një rol më të fortë për këshilltarët komunalë.** Përgjegjësitë në nivel lokal nuk janë një matematikë e thjeshtë ku një palë duhet të humbasë pushtetin në kurriz të një tjetri. Çdo nivel i qeverisjes lokale ka një rol global dhe transversal dhe këshilli komunal shërben si homologu strategjik dhe demokratik i një roli më të fortë ekzekutiv për kryetarin e komunës dhe administratën. Vëmendje e veçantë i është kushtuar kësaj pike në rekomandimet lidhur me rolet komunale në financa dhe monitorim.

- **Të zhvillohen praktika të vazhdueshme të pjesëmarrjes qytetare.** Demokracia lokale do të thotë që të angazhohen qytetarët dhe shoqëria civile në të gjitha dimensionet e saj të mundshme. Praktikrat e tilla pjesëmarrëse duhet të jenë të shumta dhe të ndryshme dhe duhet të angazhohen në grupe të ndryshme. Pjesëmarrja e qytetarëve nuk sjell humbje kohe ose burimesh; përkundrazi është ndër investimet më të mira që mund të bëhen në të ardhmen e vendit.
- **Të integrohet perspektiva gjinore** në punën e këshillave komunalë dhe të sigurohet përfaqësim i balancuar. Politikrat e orientuara nga gjinia duhet të ndiqen në punën e këshillave komunalë maksimalisht.
- **Të sigurohet bashkëveprim konstruktiv me bashkësitë etnike** dhe të sigurohet që ato të përfshihen në përbërjen dhe veprimet e këshillave komunalë.
- **Të sigurohet një qasje praktike dhe e bazuar në fushën e ndërtimit të kapaciteteve që duhet të orientohen në parimet pedagogjike të arsimit të të rriturve.** Kjo qasje duhet të përfshijë komponentë të ngritjes së vetëdijes dhe përmbajtjes teknike. Praktikrat duhet të jenë inovative dhe instrumente të pazakonshme, me mundësi të zbatimit të shpejtë, të bëra enkas (pothuajse) për çdo këshilltar komunal. Komponenti i trajnimit duhet të ketë një format optimal të *të mësuarit duke bërë*, duke vlerësuar **orientimin drejt zgjidhjes së problemeve** të qeverisjes lokale. Duhet të miratohen teknologji dhe metoda të ndryshme siç janë **trajnimi i drejtpërdrejtë** dhe identifikimi **i praktikave më të mira** dhe **kampionëve**. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet **Kryetarit të Këshillit Komunal**. Këshilltarët komunalë, **personeli administrativ dhe kryetarët e komunave** duhet të angazhohen në praktikrat e ndërtimit të kapaciteteve, dhe të synojnë fuqizimin e këshilltarëve. Anëtarët e **partive politike** duhet gjithashtu të angazhohen në këto aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve.

Siç u përmend më lart, gjetjet dhe rekomandimet e përgjithshme mbulojnë shkurtimisht të gjithë treguesit.

3.3. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet për secilin tregues

Gjetjet kryesore dhe rekomandimet e studimit tonë janë elaboruar më hollësisht më poshtë në mënyrë që të kuptohen më mirë.

3.3.1. Funksionimi dhe struktura e këshillave komunalë

3.3.1.1. Zgjedhja e këshillave komunalë

Gjetjet:

Zgjedhjet dhe përbërja e listave të kandidatëve për këshilltarët e ardhshëm komunalë janë një mundësi vendimtare për përzgjedhjen e kandidatëve të vlefshëm dhe të përkushtuar. Intervistat me palët e interesuara në Maqedoni dhe në vendet e përfshira në këtë shqyrtim tregojnë një **kuazi-monopol të sistemit politik partiak mbi emërimin e kandidatëve në listat**. Shumica e intervistave të kryera për këtë shqyrtim nxorën në pah kufirin e këtij sistemi, i cili për pasojë nuk është në gjendje të sigurojë këshilltarë të aftë dhe të angazhuar. Përkundër përvojës me kushtet e ngjashme (listat partiake), disa vende kanë arritur të rekrutojnë këshilltarë më të angazhuar (si në Lituani), si rezultat i valorizimit social të rolit të këshilltarëve në qeverisjen lokale në vend që të mbështeten vetëm në dispozitat ligjore. **Në të gjitha vendet e BE-së mund të votohen këshilltarët lokalë dhe secili mund të kandidohet nëse është banor në komunën përkatëse, madje edhe sikur kandidati mos të jetë shtetas i ndonjë vendi të BE-së.** Kjo është e rëndësishme për t'i lidhur qytetarët me komunitetin e tyre dhe për t'i përfshirë në jetën lokale. Megjithatë, kjo nuk pranohet në Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri. **Listat qytetare** janë të mundshme në të gjitha vendet e shqyrtuara, edhe pse ato nuk janë të zakonshme (ndërsa në Lituani ato nuk ekzistojnë).

Rekomandimet e përgjithshme:

- **Të nisët dialog me partitë politike**, të cilat janë aktorë kryesorë në hartimin e listave të kandidatëve në Maqedoni, në mënyrë që ato të bëhen më përfshirëse dhe të balancuara.

- **Të forcohet më tej qasja e qytetarëve dhe e shoqërisë civile** duke fuqizuar orientimin dhe praktikën ligjvënëse, duke përfshirë edhe **listat qytetare**, të cilat janë veçanërisht të vlefshme në komunat e vogla. Në këtë drejtim, sistemi zgjedhor duhet të jetë më i orientuar që të ketë lista të hapura partiake dhe të vlerësoj preferencat e votuesve.
- **Të forcohet “qasja lokale e zgjidhjes së problemeve”** të qeverisjes lokale në përgatitjen e zgjedhjeve, distancimi nga politika në nivel kombëtar, si dhe të nxitet angazhimi i qytetarëve të zakonshëm.
- **Të punohet me grupet e shoqërisë civile dhe autoritetet lokale shumë përpara zgjedhjeve për të rritur ndërgjegjësimin për vlerat dhe rëndësinë e qeverisjes lokale**, në mënyrë që të mobilizohen dhe angazhohen qytetarët (përmes *pushatave të dukshme dhe komunikimit, forumeve dhe debateve që paraqesin sfidat dhe rolet e autoriteteve lokale dhe rëndësia e punës së këshilltarëve komunalë*). Në këtë rast, lagjet e komunës mund të luajnë një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacionit dhe ngritjen e vetëdijes për kapacitetet e nevojshme për t'u bërë këshilltarë të ardhshëm komunalë efektiv.

3.3.1.2. Kompetencat e këshillave komunalë

Gjetjet:

Si shtete anëtare të Këshillit të Evropës, vendet e shqyrtuara kanë nënndarje të ngjashme të kompetencave midis organeve të qeverisjes lokale. Këshillat komunalë kanë detyrat e: a) orientimit strategjik, b) mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit, dhe c) mbajtjen e ndërlidhjes me qytetarët. Disa nga vendet e shqyrtuara kanë prezantuar elemente interesante, p.sh. Danimarka ka shtuar kompetencat e pushtetit lokal përfshirjen e emigrantëve dhe ndihmën e të papunëve. Lituania ka shtuar detyrën që këshilli komunal të duhet të miratojë “mënyrën e sjelljes që do të mbahet me qytetarët”. Një synim i rëndësishëm që qëndron pas këtij shqyrtimi është nevoja për të transformuar në realitet dispozitat ligjore që i atribuojnë rëndësi të madhe këshillave.

Rekomandime:

Nënndarja e detyrave midis organeve të ndryshme të pushtetit lokal në Maqedoni është në rregull në aspektin e legjislacionit, por duhet të përmirësohet duke futur më shumë **praktika** që vlerësojnë rolin e këshilltarëve komunalë.

- Në kontekstin maqedonas të pushtetit lokal, këto përmirësime **nuk mund t'i lihen vetëm vullnetit dhe praktikave të mira**. Ato duhet të mbështeten nga ndryshimet në ligj dhe **rregulloret e brendshme të shpërndara (dhe të diskutuara/përgatitura) nga këshilltarët komunalë** duke përdorur BNJVL-në për të ndihmuar në koordinimin.
- **Të arrihet një ekuilibër më i mirë midis këshilltarëve komunalë dhe kryetarëve të komunave/stafit administrativ** përmes dispozitave të reja dhe vlerësimit të kontributit të këshilltarëve. Një mundësi do të ishte t'u jepnin këshilltarëve komunalë rolin e ndërmarrjes së **kërkimit** dhe formulimit të **rekomandimeve** që do të diskutoheshin gjatë mbledhjeve të këshillave komunalë - duke u dhënë atyre një rol më të rëndësishëm. Është e rëndësishme që përvoja e vlefshme e OJQ-ve të fushës të përfshihet si kontribut në punën dhe seancat e këshillave komunalë.
- Të shtohet rëndësia e **rolit strategjik të këshilltarëve komunalë** duke përfshirë rregullat, praktikën dhe rregulloret e brendshme specifike që duhen ndjekur.
- **Të theksohet nevoja për kontroll dhe balancë në financat publike lokale, me një rol të fuqizuar për këshilltarët komunalë** (siç është nxjerr në pah në rastet e Lituanisë dhe Sllovenisë).
- **Të shtohen më shumë praktika (ligje ose rregullore të brendshme) për vendosjen e dialogut të detyrueshëm midis autoriteteve lokale dhe bashkësive lokale në mënyrë që të lehtësohet dhënia e një kontributi më të madh nga qytetarët**. Ky shqyrtim nxjerrë në pah rezultatet më të mira të arritura në këtë drejtim nga vendet e Evropës Veriore të anketuara, ndërsa vendet nga Ballkani duhet të arrijnë përmirësime të shumta në vendosjen e dialogut më të madh.

3.3.1.3. Komisionet dhe organet e brendshme të këshillave komunalë

Gjetjet:

Komisionet dhe organet e brendshme të këshillave komunalë janë një pjesë e rëndësishme e punës së këshilltarëve komunalë. Përveç në seancë plenare të këshillit, ky është vendi ku këshilltarët kanë **potencial të madh për punë dhe për të dhënë kontributin e tyre**. Është e rëndësishme të shqyrtohet mundësia e **përforcimit të takimeve të komisioneve nëpërmjet pjesëmarrjes së ekspertëve dhe qytetarëve të tjerë** (si në Slloveni dhe Danimarkë). Përveç komisioneve dhe komiteteve të rregullta, Lituania ka **krijuar komisione për etikën dhe anti-korrupsionin**. Danimarka gjithashtu ka vendosur organe ndërmjetëse (komisione më të strukturuar dhe të përhershme) si magistratet për Kopenhagën dhe Aarhusin. Kjo u siguron autoriteteve lokale në Danimarkë një shkallë autonomie në vetorganizimin, siç parasheh ligji. **Vlerësimi i punës së këtyre komisioneve** është çështje e vështirë për të gjitha vendet e përfshira në këtë shqyrtim. Kjo mbetet e lidhur me *pjesëmarrjen* në seanca (dhe gjërat në rast të mospjesëmarrjes). Lituania ka vendosur praktikën e publikimit të **raporteve vjetore** për punën e bërë nga komunat. Punën e komisioneve dhe komiteteve gjithmonë e mbështet administrata.

Ky shqyrtim nxjerrë në pah nevojën e pushtetit lokal për një autonomi të caktuar në krijimin e komisioneve dhe organeve të punës, për të cilat pjesërisht vendosin nga këshillat komunalë me statutet e tyre ose rregulloret e brendshme. Megjithatë, praktika ndryshon nga legjislacioni. Vetëm Danimarka ka komitetin e detyrueshëm të financave, i kryesuar nga kryetari i komunës. Serbia ka një listë të gjatë të komisioneve të detyrueshme. Asnjë nga vendet e shqyrtuara nuk kanë komitete të detyrueshme për çështjet gjinore dhe të minoriteteve përveç Serbisë. Por në praktikë punët qëndrojnë ndryshe. Në Shqipëri shpesh gjejmë një komision financiar dhe një komitet gjinor dhe etnik në Shqipëri.

Rekomandime:

Puna e komisioneve duhet **të jetë një komponent thelbësor e punës së këshillit komunal dhe duhet të vlerësohet më tej**. Komisionet ofrojnë mundësi për diskutim dhe kuptim më të mirë të çështjeve, duke shërbyer si forume për përgatitjen dhe shqyrtimin e çështjeve me interes për këshillin komunal.

- **Pjesëmarrja, puna dhe rezultatet e komisioneve duhet të vlerësohen dhe të mbështeten me burime, bonuse dhe shpërblime (për më të mirët).**
- **Pasiviteti i këshilltarëve në komisionet duhet të evidentohet në dosjet e këshilltarëve dhe të jetë subjekt i sanksioneve.**
- **Duhet të identifikohen Komisione të reja** që duket se demonstrojnë praktika të mira, **siç janë Komisioni i transparencës dhe Komisioni i etikës së Shqipërisë.**
- **Stafi i administratës duhet të trajnohet dhe të përgatitet për të ndihmuar aktivisht** në punën e komisioneve dhe për të kuptuar rolet e tyre.
- **Theksi i veçantë duhet t'u jepet komisioneve për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë.** Komisionet e tilla duhet të kenë rolin kryesor në ndërthurjen e politikave të pushtetit lokal. Roli i komisioneve për mundësi të barabarta është veçanërisht i rëndësishëm në aplikimin e perspektivës gjinore në parimet e buxhetimit.
- **Duhet të sigurohet përkrahja për Kryetarin e Këshillit** në mënyrë që të mund ta valorizojë punën e komisioneve të ndryshme komunale.
- **Rekomandohet që komisionet të jenë të hapura për qytetarët, praktikë kjo që tashmë zbatohet në shumë prej vendeve të shqyrtuara.**
- Komisionet kanë **rol këshillëdhënës** në politikat dhe vendimet e propozuara për votim në këshillat komunalë dhe ato përfaqësojnë strukturën e punës në periudhat ndërmjet sesioneve të këshillit. **Ky rol këshillëdhënës duhet të vlerësohet fuqimisht** që të trajtohet si politikisht relevant.
- Për të vlerësuar rolin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së anëtarëve të këshillit në komisione, vendimet duhet të merren nga **shumica e anëtarëve të komisionit** dhe jo vetëm nga ata që marrin pjesë. Kjo do të nxiste pjesëmarrje më të madhe.
- **Në mënyrë që të vlerësohen mbledhjet e komisioneve, hapësirat e parapara për to dhe pajisjet e tjera** duhet të ofrohen në ambientet e komunës.

3.3.1.4. Rregullorja e punës e këshillit komunal, përgatitja dhe shpërndarja e materialit për vendimet e këshillit

Gjetjet:

Dokumentet përgatiten nga administrata dhe u dërgohen këshilltarëve para mbledhjeve të këshillit komunal. Në shumicën e rasteve, sidomos në Shqipëri dhe Serbi, të intervistuarit theksuan kapacitetin e kufizuar të këshilltarëve komunalë për të shqyrtuar mirë këtë dokumentacion paraprakisht në mënyrë që të përgatiten për ndryshime. Dokumentet shpesh zbulohen vetëm në mbledhjet e këshillit, duke përforcuar kështu konceptin se takimet në thelb nuk janë më shumë se një mekanizëm për votim në përputhje me direktivat e partive politike. Departamentet e ndryshme përgatisin materialin dhe dokumentet. Në Serbi, Sekretariati për Çështje të Përgjithshme Administrative dhe të Përbashkëta është duke centralizuar mbështetjen për këshillin dhe kryetarin e komunës. Në Slloveni, disa kompani ofrojnë ndihmë në përgatitjen e akteve ligjore. Praktika e përdorimit të mbështetjes së jashtme teknike për çështje të caktuara praktikohet edhe në Shqipëri.

Rekomandime:

Në Maqedoni, materiali për mbledhjet e këshillit përgatiten gjithashtu nga administrata. Këto dokumente pastaj diskutohen në komisione përpara se të dorëzohen në mbledhjet e këshillit. Sidoqoftë, ka këshilltarë komunalë që kanë nevojë për vëmendje të veçantë në mënyrë që të jenë në gjendje të bashkëveprojnë më efektivisht me informacionin që kanë në dispozicion.

Duke qenë se këshilltarët komunalë nuk janë në gjendje të kuptojnë të gjitha detajet e politikave komplekse, ata do të kenë nevojë për stërvitje dhe instrumente të veçanta që të mund të sjellin dhe të shprehin vendime konstruktive dhe mirë të informuara. Mos sigurimi i këshilltarëve me mjetet për të kuptuar politikën tregon mungesën e besimit dhe respektit që do të çojë në demotivim dhe erozion të ndjenjës së përgjegjësisë qytetare të nënkuptuar në mandatin e tyre. Dokumentet e përgatitura nga administrata për këshillin mund të përfshijnë **disa pika lehtësuese** (disa nga këto pika mund të përfshijnë **ndërtimin e kapaciteteve për stafin administrativ**). Dokumentet dhe materiali shoqëruar duhet të dorëzohen **në kohë** dhe duhet të **sigurohet që ato të jenë pranuar**.

Propozojmë përmirësimet në vijim:

- **Përmbledhje me pika** ku do shmanget një gjuhë tepër-teknike dhe burokratike.
- **Prezantim dhe vizualizim të përmbledhjes së çështjeve** (foto, grafikë, përmbledhje me gojë dhe pika të shkurta në vend të teksteve të gjata narrative). Shumica e këtyre praktikave zbatohen shpesh në komunat daneze.
- **Seanca specifike të trajnimit**, përmes vizitave individuale ose përmes brifingjeve përgatitore nga stafi administrativ për këshilltarët komunalë. (Këto rekomandohen edhe pse nuk praktikohen në vendet e shqyrtuara).
- **Drejtimi i komiteteve dhe këshillave komunalë** me një qëndrim më profesional ndaj përfshirjes (tabela, prezantime vizuale etj.).
- **Trajnim i veçantë për këshilltarët për disa çështje veçanërisht të vështira** (në buxhetin e komunës mund të merren parasysh trajnime specifike për këshilltarët komunalë - shih pikat në vijim).

3.3.1.5. Kompensimi i këshilltarëve komunalë

Gjetjet:

Ky shqyrtim tregon se përdoren metoda të ndryshme për kompensimin e këshilltarëve komunalë. Kompensimi është i rëndësishëm, por nuk duhet të bëhet motivimi kryesor për angazhimin qytetar të këshilltarëve. Qasja ndahet nga të gjitha vendet e shqyrtuara, të cilat nuk i konsiderojnë këshilltarët thjesht si "ata që punojnë për komunat", por si **vullnetarë** (me rimbursime të veçanta).

Rekomandime:

Një hap i rëndësishme për Maqedoninë do të jetë të ndërlidhë **angazhimin dhe rëndësinë e pozitës me kompensimin**, me qëllim që të shmanget që roli i këshilltarëve të shihet si post i paguar me punë të kufizuar dhe pa përgjegjësi. Propozohen përmirësimet në vijim:

- **Të ndërlidhet kompensimi me pjesëmarrjen në këshillat dhe komisionet** (në këtë rast me një inovacion në Maqedoni), siç praktikohet tashmë në Danimarkë dhe Serbi.
- **Të ndërlidhen shpërblimet me planet e veprimit dhe iniciativat e këshilltarëve që kontribuojnë në diskutime specifike dhe në kërkime/procese** (siç janë raportet e detajuar ose angazhimi me qytetarët).
- **Të mbështeten dhe shpërblehen këshilltarët** për angazhime të veçanta që mund të shërben si motiv për anëtarët e tjerë të këshillit.
- **Të sanksionohet pasiviteti, mungesa e interesit dhe qëndrimet joproductive.**
- Mirënjohja financiare e punës së këshilltarëve është e rëndësishme, sepse kuptimi i përgjithshëm është se ata ofrojnë një shërbim qytetar. Njohja e tillë financiare duhet gjithashtu të **lidhet me një vlerësim të punës së tyre efektive.**

3.3.2. Këshillat komunalë dhe roli i tyre në financa dhe buxhetim

Studimi krahasues vuri në pah përfitimet e një **sistemi rregullator të rreptë, duke përfshirë edhe organet e brendshme dhe të jashtme**, të cilat mund të monitorojnë shpenzimet publike dhe mbishpenzimet. Ky shqyrtim paraqet suksesin e vendeve me **shtresa të shumëfishta kontrolli** (si Sllovenia dhe Lituania) dhe **aktorët e brendshëm dhe të jashtëm**. Kjo është gjithashtu një qasje e parashikuar për Maqedoninë. Mungesa e kontrollit nuk mund të kompensohet nga vullnetarizmi dhe vullneti i mirë i këshilltarëve veçanërisht ata profesionistë dhe të përkushtuar. Monitorimi dhe kontrolli financiar janë dimensione shumë të rëndësishme të kontroleve dhe balancave. Më poshtë janë theksuar disa nga elementët kryesorë që mund të kontribuojnë në rastin e Maqedonisë.

3.3.2.1. Roli i këshillave komunalë në procesin buxhetor

Gjetjet:

Përgatitja e buxhetit komunal përfshin **konsultime në nivel të komisionit dhe pastaj diskutime dhe vendime në nivel të këshillit**. Buxheti përgatitet nga **administrata** dhe propozohet nga kryetari i komunës. Input i rëndësishme merret në konsultimet me **bashkësitë lokale dhe koordinatorët** e tyre, si në Lituani. Komunitat daneze, të cilat gëzojnë autonomi të konsiderueshme, përdorin gjithashtu instrumente të tjera të konsultimit me qytetarët gjatë përcaktimit të buxheteve (siç janë samitet e qytetarëve për plane më vizionare dhe afatgjate). **Buxhetimi me pjesëmarrje** është testuar dhe ka treguar sukses në Shqipëri dhe Serbi.

Rekomandime:

Roli i madh në planifikimin e buxhetit shpesh luan edhe administrata komunale, (teknikët dhe drejtuesit) të cilët përgatisin shifrat dhe të dhënat për këshillin dhe komisionet.

- **Roli i këshilltarëve komunalë mund të rritet me takime më të rregullta dhe efektive të hapura për kontributin e tyre** (të përgatitur mirë për të nxitur kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre).
- Duhet të forcohet angazhimi i qytetarëve përmes **bashkësive lokale**.
- Duhet të trajnohet **një person përgjegjës** për të mbështetur këto procese konsultimi. **Duhet të futen instrumente pjesëmarrëse, siç janë metodologjia open-space, seancat e kafeneve botërore etj.**
- Praktikant e **Buxhetimit me pjesëmarrje**, siç janë Forumet në bashkësi ose forma të tjera inovative, mund të futen si të tilla në rregullore ose të promovohen dhe vlerësohen gjerësisht si praktika të mira (dhe të mbështeten gjithashtu me një **bonus** në buxhetet).

3.3.2.2. Këshillat komunalë kontrollojnë mbishpenzimet

Gjetjet:

Në të gjitha vendet e shqyrtuara, këshilli komunal ka rolin e mbikëqyrjes dhe vendosjes për buxhetin komunal dhe shpenzimet e ardhshme për komunën. Megjithatë, mungesa e ndonjë përgjegjësie personale nga ana e këshilltarëve komunalë për vendime të tilla mund të dëmtojë përfshirjen e tyre në këtë proces. Kontrollat e mbishpenzimeve mund të zbatohen përmes auditimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm, ku këshillat komunalë do kishin role të ndryshme në këto procedura. Disa vende kërkojnë auditime edhe të brendshme dhe të jashtme. Dy nga vendet e shqyrtuara kanë krijuar organe gjysmë të jashtme: kontrolluesit në Lituani dhe organet mbikëqyrëse në Slloveni. Në përgjithësi, asnjë nga vendet e shqyrtuara nuk ka vendosur përgjegjësi të drejtpërdrejtë nga ana e këshilltarëve komunalë për tejkalimin e shpenzimeve në nivel komunal. (Kontroli është gjithashtu i lidhur shpesh me borxhet dhe kreditë, të cilat do të mbulohen më poshtë).

Në Maqedoni, mbikëqyrja e buxhetit ushtrohet nëpërmjet një kombinimi të auditimit të brendshëm nga një komisioni të financave dhe kontrollit tremujor të buxhetit, si dhe një auditimi të jashtëm nga ministritë dhe institucionet e tjera qeveritare. Megjithatë, qasja e dobët e vendit në monitorimin e buxheteve komunale ka shërbyer për rritjen e borxheve publike të autoriteteve lokale dhe kështu kërkon kontrole më të rrepta.

Rekomandime:

- Këshilltarëve komunalë duhet t'u ofrohen kompetenca të përgjithshme për të kuptuar parimet themelore të kontrollit buxhetor. Ndërtimi i kapaciteteve duhet të jetë efektiv dhe i bazuar në raste reale. Aty ku është e mundur, trajnimi duhet të sigurohet brenda vetë komunës.
- Auditimet e jashtme ose pjesërisht të jashtme duhet të vendosen për të mbështetur këshilltarët komunalë, për shembull duke forcuar komisionet e financave nëpërmjet përfshirjes së ekspertëve dhe qytetarëve të tjerë (siç është rasti në disa nga vendet e shqyrtuara) ose duke shtuar elemente specifike, si komitetet mbikëqyrëse që funksionojnë në Slloveni.
- Të futen forma të reja të kontrollit të qytetarëve, me përzgjedhje të rastësishme të qytetarëve (dhe më tej të trajnohen) për të mbikëqyruar punën e komunës, së bashku me këshillat komunalë.¹⁰
- Të vendoset një kontroll më i rregullt dhe substancial i shpenzimeve kundrejt të ardhurave, për shembull duke ndjekur shembullin e buxhetit gjashtëmujor në Shqipëri.
- Për qytetarët duhet të publikohen raporte të rregullta të hapura për shpenzimet buxhetore, duke përdorur metodologji inovative që rrisin përfshirjen në vend që të rrisin hendekun mes institucioneve dhe publikut.
- Auditimet e jashtme duhet të bëhen rregull / praktikë (si në Danimarkë), të koordinuara dhe të paguara nga Ministria e Financave.
- Duhet të organizohen trajnimi për mjetet efektive të veçanta buxhetore, siç është buxheti i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore.
- Këshilltarët komunalë duhet të mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë personale për tejkalimin e shpenzimeve dhe është e rëndësishme etika e këtij procesi të ngrihet. (Asnjë nga vendet e shqyrtuara nuk ka krijuar përgjegjësi të tillë të drejtpërdrejtë).
- Është e rëndësishme të valorizohet menaxhimi i përgjegjshëm i këshilltarëve komunalë dhe fakti se ata po ruajnë balancën e komunitetit së bashku me përpjekjet e kryetarëve të komunave.
- Të vendoset një rol më i qartë dhe më i rreptë për këshillat komunalë në aprovimin e borxheve (siç janë faturat dhe shpenzimet e papaguara), sidomos kur bëhet fjalë për skemat e mundshme të llogaridhënies që kanë ndikim në të ardhmen e komunës.

¹⁰ Ky shembull ka rezultuar efektiv në qytetin e Strasburgut, Francë.

3.3.2.3. Roli i këshillave komunalë në përcaktimin e taksave komunale

Gjetjet:

Këshillat komunalë janë përgjegjës për përcaktimin e shkallës së taksave. Disa vende, si p.sh. Danimarka, janë autonome në rritjen e shkallës së taksave, dmth ato mund t'i përcaktojnë vetë. Në vende të tjera ato kufizohen brenda një pragu të caktuar nga qeveria nacionale, si në Maqedoni. Shuma e të ardhurave të realizuara nga taksat shpesh është margjinale në vendet ku procesi i decentralizimit ende nuk është vendosur mirë dhe ku shumica e burimeve vijnë nga shteti.

Rekomandime:

- Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve për të ndihmuar **këshilltarët komunalë të kuptojnë dhe të punojnë me taksat lokale**. Taksat komunale duhet të paraqiten si mundësi për të pasur më tepër shërbime lokale dhe më të mira.
- **Duhet të krijohen më shumë aktivitete që lidhin grupet e shoqërisë civile dhe këshilltarët komunalë** për të vlerësuar lidhjen midis taksave vendore dhe shërbimeve të ofruara.

3.3.2.4. Planet e prokurimit, borxhet dhe asetet e autoriteteve lokale

Gjetjet:

Këshillat komunalë janë përgjegjës për planifikimin e buxhetit të përgjithshëm vjetor dhe për planifikimin afatgjatë të buxhetit. Kështu, këshillat komunalë gjithashtu kanë rol edhe në huamarrjen. Në të gjitha vendet e shqyrtuara, këshillat komunalë kanë rol në blerjen dhe shitjen e pronave. Këshillat komunalë janë më pak të përfshirë në planet e prokurimit, pasi që këto zakonisht u lihen procedurave burokratike brenda kostove të vlerësuar dhe të aprovuara në buxhetet komunale. Danimarka ka prezantuar praktikën **e sanksionimit të komunave për borxhet dhe mbishpenzimet**. Megjithatë, një alternativë më produktive do të ishte futja e një praktike të dhënies së shpërblimeve për këshillat komunalë që demonstrojnë praktika të mira të jashtëzakonshme në menaxhimin e financave publike. Në Serbi, shumica e komunave kanë njësi të prokurimit publik (departamentet) përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në përputhje me ligjin dhe për të cilat fondet sigurohen në buxhet ose në planin financiar.

Rekomandime:

- **Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës se si këshillat komunalë i kuptojnë planet e prokurimit dhe borxhet**. Duhet të vendoset procedurë përkatëse për të mundësuar monitorim të vazhdueshëm, si dhe komisione përkatëse.

3.3.2.5. Kontrollat e brendshme dhe të jashtme

Gjetjet:

Kontrollet e brendshme dhe të jashtme janë parashikuar në të gjitha pushtetet lokale të shqyrtuara. Në disa vende, si Danimarka, auditimet e jashtme janë të detyrueshme. Në disa vende, auditimet e brendshme dhe të jashtme janë të rekomanduara nëse ka burime përkatëse në dispozicion. Kontrollet strikte në nivele të shumëfishta duket të jenë një garanci për menaxhimin e shëndoshë të burimeve publike. Sllovenia dhe Lituania kanë miratuar organe të jashtme të veçanta për të monitoruar buxhetet komunale dhe për të plotësuar punën e këshillit komunal.

Recommendations:

- **Duhet të forcohet kapaciteti i brendshëm i kontrollit të buxhetit** (p.sh. kapacitetet e komisioneve të financave) dhe duhet të rritet ndërgjegjësimi i këshilltarëve komunalë.
- Rekomandohen **auditime të jashtme** për të **plotësuar auditimet e brendshme** në mënyrë që të monitorohen më rreptësisht buxhetet publike.

3.3.3. Roli i këshillave komunalë në qeverisjen e mirë dhe demokracinë në nivel lokal

3.3.3.1. Marrëdhëniet ndërmjet këshillave komunalë, kryetarëve të komunave dhe administratës komunale

Gjetjet:

Shqipëria, Sllovenia dhe Lituania kanë modelin e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave, ndërsa në Serbi dhe Danimarkë kryetarët e komunave zgjidhen nga këshilltarët komunalë. Në rastin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta të kryetarit të komunës, si në Slloveni dhe Lituani, kryetari gjithashtu kryeson këshillin komunal, ndërsa në Shqipëri këshilli kryesohet nga kryetari i këshillit dhe jo nga kryetari i bashkisë. Në Danimarkë, kryetarët e komunave zgjidhen nga anëtarët e këshillit dhe këshilli drejtohet nga kryetari i komunës. Në Serbi, kryetarët e komunave zgjidhen nga kuvendet komunale, dhe këto kuvende drejtohen nga kryetari i kuvendit.

Në rastin e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës, përbërja partiake-politike e votave për kryetarin mund të ndryshojë nga përbërja e votave për këshilltarët. Zgjedhjet për kryetar prirën të jenë më të përqendruar në udhëheqjen dhe personalitetin se zgjedhjet e bazuara në listat e partive. Sfonde të tilla të ndryshme politike mund të çojnë në bllokime institucionale brenda komunës.

Roli i kryetarit të komunës (sidomos në vendet e Ballkanit Perëndimor) është më i theksuar se në vetë legjislacionin. Intervistat dhe studimet e kryera për këtë shqyrtim konfirmuan se këshilltarët kanë më pak ndikim në qeverisjen lokale sesa kryetarët e komunave. Kjo është për shkak të përgjegjësisë së kryetarit të komunës për menaxhimin e burimeve publike. Kjo marrëdhënie mbetet shumë e pabalancuar dhe pabarazia është edhe më e madhe kur kryetarët e komunave zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët.

Rekomandime:

Marrëdhënia midis këshilltarëve komunalë dhe kryetarëve të komunave duket të jetë një element thelbësor dhe i ndjeshëm i qeverisjes lokale në Maqedoni. Dialogu i vazhdueshëm ndërmjet këtyre dy aktorëve duhet të futet me anë të rregulloreve të brendshme. Në shumë raste, kryetari i komunës ka një pozitë të përhershme dhe të punës si shef i komunës, ndërsa këshilltarët komunalë shpenzojnë vetëm një pjesë të kohës së tyre dhe nuk konsiderohen se "punojnë" për komunën. Rekomandohen hapat e mëposhtëm për të adresuar këtë çekuilibër:

- a) **Të valorizohet cilësia dhe rëndësia e inputeve të këshilltarëve komunalë** (për shembull, duke shmangur kritikën se ata nuk janë "profesionistë").
- b) **Të mbështeten kryetarët e komunave dhe ekipet e tyre administrative për të siguruar reagime më sistematike nga këshilltarët komunalë.**
 - **Të rriten kompetencat dhe roli koordinues të i Kryetarit të këshillit.**
 - **Të promovohen dhe valorizohen veprimet që rrisin bashkëpunimin midis kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve komunalë, duke vënë në pah shembuj të praktikës së mirë,** siç është paraqitja e planeve të veprimit për rritjen e bashkëpunimit dhe takimeve.
 - **Të prezantohen mënyra të ndryshme për përfshirjen e këshilltarëve komunalë sa më shumë që të jetë e mundur në përgatitjen dhe në seancat e këshillit.** Për shembull, mund të përdoren thirrjet në Skype kur këshilltarët komunalë nuk janë menjëherë të disponueshëm. Mjetet e tilla do të shërbenin për të valorizuar rëndësinë e kontributit të këshilltarit. Koha dhe rendi i ditës i takimit duhet të jenë objekt i diskutimit dhe planifikimit me qëllim që këshilltarët të mund të planifikojnë pjesëmarrjen e tyre dhe të përgatiten përkatësisht.
 - **Të sigurohet mbajtja e procesverbaleve nga diskutimet dhe takimet** dhe të sigurohet që vendimet dhe diskutimet ndërmjet kryetarit të komunës dhe këshilltarëve të jenë **transparente dhe të evidentuara.**
 - **Kryetari i komunës dhe këshilli komunal duhet të promovojnë takime të rregullta strategjike,** duke përdorur instrumente të përshtatshme si metodologjia e **hapësirës së hapur dhe proceset e ndërmjetësimit të ndihmuar me trajnim.**
 - **Sa është e mundur,** kryetarët e këshillave komunalë dhe anëtarët e këshillave komunalë duhet të kenë "**hapësirën**" e tyre dhe "**ambiente/zyra**" në komunën që të mund të punojnë në mënyrë të parvarur dhe të takojnë qytetarët dhe OSHC-të.

3.3.3.2. Roli i këshillave komunalë në forma të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare (referendume lokale, iniciativa qytetare, dëgjime publike dhe forma të tjera)

Gjetjet:

Praktikat e demokracisë pjesëmarrëse janë të pranishme në të gjitha vendet e shqyrtuara. Disa nga këto praktika janë të përfshira në legjislacion, duke përfshirë **referendumet lokale** (përveç Lituaniës), **iniciativat e qytetarëve dhe dëgjimet publike**. Ky shqyrtim paraqet zbatimin e shumë risive me përfshirjen e këshilltarëve komunalë. **Buxhetimi me pjesëmarrje** zbatohet në Serbi dhe Shqipëri me mbështetjen e programeve ndërkombëtare. Disa vende kanë futur forma më të gjera konsultimi, siç janë **samitet e qytetarëve** në Danimarkë, të cilat përdoren kur bëhet fjalë për vizionimin dhe strategjitë hapësinore për komunitetet lokale. Një shembull interesant është ai i **këshillave të qytetarëve të moshuar** në Danimarkë, të cilat rrisin kontributin e gjitha brezave në politikbërjen në nivel lokal. Planifikimi strategjik dhe planifikimi urban janë gjithashtu fusha në të cilat këshillat angazhohen me qytetarët, si në Maqedoni. Këshilltarët komunalë, megjithatë, shpesh nuk janë të përfshirë drejtpërdrejtë në këto procese, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me autoritetin lokal në tërësi. Shqipëria kohët e fundit ka krijuar bazën ligjore për zhvillime interesante duke theksuar rëndësinë e **koordinimit (duke angazhuar koordinatorët e transparencës dhe koordinatorët e shpalljes dhe konsultimit publik)**. **Grupet Lokale të Veprimit** meritojnë të përmenden në veçanti, para së gjithash ato grupe që u përkasin **zonave rurale** (si në Lituani). Në Lituani, **raportet publike** përgatiten nga **Komisioni i Etikës dhe komisionet kundër korrupsionit**. Në Shqipëri ekziston detyrimi për të caktuar një **koordinator të transparencës**, për të miratuar një **program të transparencës** dhe për të caktuar një koordinator **për njoftimet dhe konsultimet publike**.

Rekomandime:

Shqyrtimi rekomandon një qasje të demokracisë pjesëmarrëse të mbështetur gjerësisht. Dialogu me qytetarët duhet të jetë në qendër të qeverisjes lokale.

Ngritja e vetëdijes për demokracinë pjesëmarrëse dhe ngritja e kapaciteteve për të ushtruar një demokraci të tillë duhet të zbatohet gjerësisht dhe sistematikisht në menaxhimin e çështjeve publike. Përpjekje të tilla duhet t'i përfshijnë këshilltarët komunalë, kryetarët e komunave dhe administratën, duhet t'u jepet prioritet trajnimit të trajnerëve dhe përfshirjes së praktikuesve.

- **Në ndërtimin e besueshëm të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e qasjeve pjesëmarrëse duhet të përfshihet edhe kryetari i këshillit.**
- **Praktikat që përfshijnë qytetarët**, siç janë debatet publike mbi çështje të ndryshme, iniciativave qytetare dhe referendumet lokale, **duhet të valorizohen** dhe komunat që zbatojnë praktika të tilla duhet të paraqiten si model i praktikës së mirë.
- **Nga këshillat komunalë duhet të kërkohet që të paraqesin plane veprimi për përfshirjen e qytetarëve dhe krijimin e një demokracie efektive pjesëmarrëse** (si në Slloveni, ku këshilli komunal identifikon praktikatat që përfshijnë qytetarët).
- **Duhet të merren parasysh forma të reja të pjesëmarrjes që valorizojnë kontributet e qytetarëve**, duke përfshirë pjesëmarrjen onlajn, metodologjinë "hapësira e hapur" (open space), metodologjinë "kafe botërore" (world café), takime dhe seanca në vend (jo gjithmonë takime në komunë), të orientuar drejt rezultateve të trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve, zgjidhjes së problemeve, sondazhet e rregullta dhe përdorimit të teknologjive të ndryshme.
- **Të rritet dhe të vlerësohet më tej praktika e përfshirjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në punën e komisioneve.**
- Të vendoset dhe të përmirësohet **dialogu konstruktiv me grupet e specializuara të shoqërisë civile** për të rritur kontributin e qytetarëve në vendimmarrjen dhe hartimin e politikave lokale për ndërhyrje specifike.
- **Të vendoset fokusi në forcimin e qasjes së ndryshme gjinore, jo vetëm në fazën e zgjedhjeve, por edhe në hartimin e politikave komunale dhe zbatimin e tyre.** Orientimi nuk duhet të fokusohet vetëm në drejtim të rritjes së numrit të grave në këshillat komunalë, por edhe për të siguruar që politikat dhe vendimet të mbështeten nga burrat dhe gratë dhe të jenë të orientuara drejt valorizimit dhe nxitjes së fuqizimit të grave në të gjithë shoqërinë.
- **Praktikat që përfshijnë grupe të ndryshme etnike, siç janë komisionet për dialog ndëretnik, duhet të forcohet edhe më tej, duke rritur numrin e përfaqësuesve etnikë në këshillat komunalë dhe duke promovuar politik-bërjen integrale.**
- Një "**raport social**" vjetor mund t'i shtohet raporteve të zbatimit dhe raporteve buxhetore të komunave.

3.3.3.3. Këshillat komunalë dhe përfshirja ndëretnike

Gjetjet:

Vendet e shqyrtuara kanë mekanizma të kufizuar për të siguruar përfaqësim më të madh të bashkësive etnike në këshillat komunalë. Mekanizmat ekzistues kryesisht përqendrohen në rregullimin e listave zgjedhore (ndonëse jo në çdo vend të shqyrtuar). Me fjalë të tjera, vendet kanë strategji shumë të dobëta për të siguruar përfshirjen e vazhdueshme të minoriteteve në hartimin e politikave dhe punët tjera të këshillave komunalë.

Sllovenia dhe Serbia kanë mekanizma për përfshirjen e një numri më të madh të përfaqësuesve të minoriteteve në listat e kandidatëve në komunitetet ku grupet minoritare janë në numër të konsiderueshëm (si bashkësia hungareze në Vojvodinë.) Në këtë rast, partia që përfaqëson minoritetin mund të fitojë mandate këshilltarësh, madje edhe në qoftë se nuk e arrin pragun minimal që aplikohet për listat e partive të tjera (që nuk përfaqësojnë grupet minoritare), me çka sigurohet përfaqësimi i tyre në këshillat komunalë. Lituani ofron një shembull tjetër, ku ekziston një listë e partive të lidhura me grupet etnike.

Rekomandime:

- **Forcimi i mëtejshëm i përfaqësimit të bashkësive etnike** duke forcuar elementet rregullatorë (si ato të dhëna më sipër), por edhe praktikatat.¹¹
- **Të rritet ndërgjegjësimi** i bashkësive etnike për mënyrat në të cilat ata mund të kontribuojnë aktivisht në të gjithë komunitetin. Aktivitetet ndërgjegjësuese gjithashtu mund të kryhen në mesin e grupit etnik shumicë për të theksuar rëndësinë e përfshirjes së të gjitha bashkësive.
- **Të lehtësohet përfshirja e minoriteteve** duke zvogëluar nivelin e kushteve formale për të fituar të drejtën për t'u kandiduar në zgjedhjet e këshillit komunalë.
- **Të forcohen prania dhe aktivitetet e komisioneve që përfaqësojnë bashkësitë etnike, me një plan veprimi përkatës të përkrahur nga këshilli komunal** dhe me përgjegjësi raportimi në fund të mandatit.

3.3.3.4. Dispozitat ligjore dhe politikat e orientuara drejt barazisë gjinore në nivel lokal

Parimi i aplikimit të kuotave për gratë në zgjedhjet komunale zbatohet me sukses në Slloveni, me synim të arrijë deri në 40%. **Ndryshe nga kjo, vendet që nuk kanë aplikuar politikat e kuotave, si Danimarka, kanë pasur një rënie të ndjeshme në pjesëmarrjen** e grave në zgjedhje. Praktika në Serbi që përcakton se duhet të ketë së paku **një grua në çdo tre kandidatë** ka rezultuar efektive, duke marrë parasysh sistemin e përfaqësimit proporcional. Megjithatë, synimi tepër ambicioz prej 50%, i vendosur në Shqipëri, rrezikon të mos jetë menjëherë i zbatueshëm, dhe rregullat për të cilat nuk ekzistojnë ndëshkime në rast të moszbatimit shpesh merren si të parëndësishme dhe cenojnë rëndësinë e çështjeve të cilat u janë adresuar.

Ky shqyrtim thekson se sistemet e kuotave përmirësojnë ndjeshëm gjasat e grave për të dalë në zgjedhje në numër më të madh, duke përmirësuar kështu gjasat e zgjedhjes së tyre.

Rekomandime:

- **Të forcohet edhe më tej kuota progresive sasiore e grave** në listat e kandidatëve dhe të ngrihet vetëdija për rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore mes burrave dhe grave kandidatë të ardhshëm, para përpilimit të listave të kandidatëve. **Gjithashtu mund të merret parasysh parimi i pozitës së balancuar të grave në listat.**
- **Të identifikohen pasojat juridike nga mosrespektimi i rregullit të barazisë gjinore.**
- **Të rriten përpjekjet e ndërgjegjësimit më të madh dhe ngritjes së kapaciteteve** të grave, bashkësive dhe partive për nevojën e një përfaqësimi më të balancuar gjinor në listat e kandidatëve. (Në Shqipëri është zbatuar me sukses një trajnim mbi legjislacionin kombëtar, qeverisjen vendore, si dhe aftësitë personale, programet e shkëmbimit dhe zhvillimin e programeve të mentorimit).

11 Këtu gjithashtu i referohet Rekomandimeve të Lundit për pjesëmarrjen efektive të pakicave kombëtare në jetën publike, në veçanti Pjesa III, Vetëqeverisja (<http://www.osce.org/hcnm/32240?download=true>) dhe Udhëzimet e Lubjanës për integrimin e shoqërive të ndryshme.

- **Të forcohen komisionet për barazinë gjinore** që mbështesin këshillat komunalë në miratimin e politikave gjinore, me një plan veprimi të dedikuar dhe llogaridhënie në fund të mandatit.
- **Të rritet angazhimi i OSHC-ve** për të mbështetur angazhimin e grave në hartimin e politikave në nivel lokal.
- **Të identifikohen rrjetet rajonale dhe në nivel të BE-së që të lehtësohet shkëmbimi i praktikave** më të mira në lidhje me angazhimin e këshilltareve gra, duke e vlerësuar atë dhe duke u dhënë atyre një rol më të fuqishëm në hartimin e politikave.
- **Të përmirësohen politikat e përfshirjes gjinore dhe mirëkuptimit midis** nëpunësve publik në nivel lokal (dështim gjithashtu i evidentuar në Danimarkë).
- **Të krijohet një shoqatë/këshill që do të mbështesë gratë e zgjedhura në këshillat komunalë** (siç janë Këshillat e Grave në Danimarkë).

3.3.4. Tregues të tjerë relevantë (bashkëpunimi ndër-komunal, zhvillimi i kapaciteteve dhe rrjetëzimi)

3.3.4.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe përzgjedhja e kreut të administratës, planet e ndërtimit të karrierës për stafin dhe nëpunësit shtetëror

Gjetjet:

Ekziston një lidhje midis vendimeve të këshillit komunal dhe organizimit të autoriteteve lokale në aspektin e stafit. Mund të e detajuar si në Shqipëri, ku komuna vendos për pagën dhe bonuset për punonjësit, ose mund të jetë më e përgjithshme, ashtu si në Serbi, ku kuvendi komunal "sjell vendimet për organizimin e administratës komunale". Në Danimarkë, nuk janë sjellë shumë vendime në lidhje me këtë pasi që secilës komunë i është dhënë liria për të administruar strukturën e saj. Kreu i administratës mund të caktohet nga këshilli komunal, si në Shqipëri dhe Serbi, ose të emërohet drejtpërdrejt nga kryetari i komunës, si në Slloveni. Sidoqoftë, në të dyja rastet, marrëdhënia mes kryetarit të komunës dhe kreut të administratës është më e afërt sesa me këshillin. Monitorimi dhe vlerësimi i nëpunësve publikë dhe administratës rregullohet me ligjin për shërbimin civil.

Praktika e **planit të sistematizimit** që përdoret në Maqedoni, në përgjithësi ndiqet edhe në vende të tjera, megjithëse detajet rreth vendimeve të këshillit ndryshojnë në aspektin e nivelit të pagës dhe numrit të punonjësve.

Rekomandime:

Në shumë nga vendet e shqyrtuara, sekretari i komunës ose kreu i administratës zgjidhet nëpërmjet negociatave ndërmjet kryetarit të komunës dhe këshillit komunal. Në Maqedoni kjo përzgjedhje bëhet vetëm nga kryetari i komunës. **Rekomandohet një rol më përfshirës për këshillin komunal në përzgjedhjen e sekretarit të komunës.**

3.3.4.2. Roli i këshillave komunalë në bashkëpunimin ndër-komunal

Gjetjet:

a) **Bashkëpunimi ndër-komunal** ekziston në të gjitha vendet e shqyrtuara. Është kryesisht në baza vullnetare, por mund të jetë edhe i detyrueshëm, p.sh. në Danimarkë bashkëpunimi i tillë është i detyrueshëm në luftën kundër zjarrit dhe në parandalimin e aksidenteve. Një bashkëpunim i tillë është i përpunuar mirë në Ligjin e Vetëqeverisjes, i cili u soll rishtazi në Shqipëri, ku thuhet se një **bashkëpunim i tillë duhet të jetë në dobinë e përbashkët të njësive të vetëqeverisjes vendore. Këshilli bashkiak miraton shërbimet e përbashkëta dhe implikimet buxhetore të bashkëpunimit ndër-bashkiak.** Në Serbi, bashkëpunimi ndërmjet agjencive të zhvillimit rajonal kombinon përpjekjet e komunave të ndryshme. Ky bashkëpunim theksohet në këtë shqyrtim si praktikë për të **racionalizuar ofrimin e shërbimeve** për komunitetet më të vogla.

Iniciativat për bashkëpunim ndër-komunal bazohen në nevojat ekonomike dhe të efiçencës. Bashkëpunimi i tillë mund të marrë formën e marrëveshjeve ndërmjet komunave (ku një komunë është ofruesi dhe tjetri është shfrytëzues i shërbimeve) ose ata mund të bashkohen në një partneritet (për shembull brenda një kompanie publike) për të ofruar shërbime bashkërisht (të tilla si energji ose shërbime të transportit publik). Në Slloveni, iniciativat e bashkëpunimit ndër-komunal kanë të drejtë për fonde shtetërore deri në 50% të shpenzimeve të tyre.

- b) **Bashkëpunimi ndër-komunal në nivel ndërkombëtar** pranohet gjithashtu nga legjislacioni. Shqyrtimi më tej thekson potencialin e madh për një bashkëpunim të tillë për ngritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e përgjegjësive komunale, veçanërisht në Lituani dhe Danimarkë, si dhe për gjenerimin e **solidaritetit rajonal**. Megjithatë, më së shpeshti janë kryetarët e komunave dhe nëpunësit civilë ata të cilët angazhohen në ndërtimin e kapaciteteve, ndërsa këshilltarët komunalë paraqesin një pjesë të dobët të këtij programi. Ligji i fundit për vetëqeverisje në Shqipëri ka një seksion të përkushtuar të drejtave dhe detyrave të bashkëpunimit midis bashkësive, duke përfshirë **të drejtën për të bashkëpunuar në nivel ndërkombëtar**.

Rekomandime:

a) Bashkëpunimi ndër-komunal

Këshillat komunalë janë aktivisht të përfshirë në miratimin e skemave dhe mbështetjes ndër-komunale. Ajo që është më pak e qartë është se si financohen shërbimet ndër-komunale. Propozohen rekomandimet në vijim:

- **Të rritet ndërgjegjësimi dhe njohuritë për mundësitë në dispozicion** (si burim alternativ i financimit ose zgjidhjeve) **midis këshillave komunalë dhe të shqyrtohet mundësia e vendosjes së bashkëpunimit të detyrueshëm ndër-komunal**.
- **Të mbështetet dhe të forcohet roli i këshillave komunalë në monitorimin e bashkëpunimit ndër-komunal**.
- **Të identifikohen mënyrat e reja të financimit të bashkëpunimit ndër-komunal, duke rritur ndërgjegjësimin e këshilltarëve komunalë**.

b) Bashkëpunimi ndër-komunal në nivel ndërkombëtar

Meqë bashkëpunimi ndërkombëtar ndër-komunal ose bashkëpunimi i decentralizuar mund të jetë në dobi të madhe për përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe kompetencat e këshilltarëve komunalë duke i angazhuar ata në shkëmbim të praktikave më të mira, rekomandohet që një bashkëpunim i tillë të lehtësohet dhe të valorizohet më tej.

- **Këshilltarët komunalë duhet të marrin pjesë aktive** në projektet e bashkëpunimit të decentralizuar dhe bashkëpunimit ndër-komunal ndërkombëtar.
- Mund të përcaktohet **një anëtar i stafit të komunës** dhe të trajnohet për këtë qëllim.

3.3.4.3. Instrumentet për ngritjen e kapaciteteve dhe skemat e motivimit për këshilltarët komunalë

Gjetjet:

Studimi konstatoi **dobësi në programet e trajnimit për këshilltarët komunalë**. Programet më efikase dhe të qëndrueshme duket të jenë ato në Lituani dhe Danimarkë, ku këshilltarët ndjekin një program trajnimi nga ditët e para të zgjedhjes së tyre dhe më pas regjistrohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitete të përditësimit. **Shoqatat e autoriteteve lokale** luajnë një rol kyç në këtë trajnim. Në Slloveni, Shqipëri dhe Serbi është konstatuar se programet e trajnimit janë të dobëta dhe ngandonjëherë të organizuara *as hoc*. Shumica e programeve të trajnimit janë - në nivel kombëtar - të dizajnuara për stafin administrativ, nëpunësit civil (për çështjet teknike) dhe udhëheqësin lokale. Shqipëria njih nevojën për trajnim: "**Një këshilltar ka të drejtën e trajnimit profesional sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak**". Ky shqyrtim ka identifikuar mungesën e skemave të motivimit dhe trajnimit në aftësitë e buta për këshilltarët komunalë, ndërsa trajnimi aktual është më i fokusuar në legjislacionin dhe funksionimin e qeverisjes lokale.

Rekomandime:

Rekomandimet në vijim propozohen për të konsoliduar kapacitetet e këshilltarëve komunalë:

- **Këshilltarët komunalë duhet të trajnohen në mënyrë sistematike, duk filluar sa më shpejt mbas zgjedhjes së tyre**, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të tyre për të kontribuar në qeverisjen lokale që nga fillimi i mandatit të tyre. Një rol të veçantë në një trajnim të tillë mund të luaj Asociacioni i Autoriteteve Lokale, siç është rasti në Lituani dhe Danimarkë.
- **E shumta e trajnimeve për komunat duhet të ofrohen falas** (ndoshta në bashkëpunim me qendrat e akredituara të trajnimit) dhe duhet të fokusohen në ngritjen e kapaciteteve dhe veprimeve që janë shpejt të zbatueshme.
- **Programet e trajnimit duhet të jenë si teknike** (njoftimi i këshilltarëve me konceptin e funksionit të postit të tyre dhe qeverisjen lokale) ashtu edhe **të orientuara ndaj vlerave, qëndrimeve dhe sjelljes të përgjegjshme**. Në veçanti, trajnimi duhet të mbështes procesin e ndërtimit të kapaciteteve të orientuar në **forcimin e motivimit përmes një skeme përkatëse** (të identifikohet) e bazuar në njohjen shoqërore të punës (shpërblime dhe ndëshkime) dhe angazhimin e këshilltarëve komunalë në zgjidhjen e problemeve në nivel lokal. **Përgjegjësia dhe vetëvlerësimi vijnë nga një kontekst shoqëror që i referohen komunitetit dhe reagojnë ndaj fakteve të thjeshta**. ('Unë jam i përgjegjshëm dhe i vlerësuar sepse: i.) Është **detyra** ime të jem kështu; ii. Është e **rëndësishme** që jam i tillë; iii.) Mund **t'ia arrijë**; iv. **Kërkohet të jem i tillë dhe të vlerësohem** që jam i tillë; v.) Po **bëj një ndryshim**.
- **Trajnimi për fuqizimin e këshilltarëve komunalë duhet të shtrihet tek stafi komunal, kryetari i komunës dhe zyra e kryetarit të komunës**.
- Duke ndjekur shembullin e disa prej vendeve të shqyrtuara, trajnimi **mund të sigurohet nga agjenci të ndryshme**: a) shteti, b) asociacionet e autoriteteve lokale, c) qendrat e certifikuara të trajnimit. Rekomandohet që të gjitha aspektet e qeverisjes vendore të përfshihen dhe të plotësohen, duke njohur "**llojin e trajnimit dhe programin**" për secilin këshilltar.
- Trajnimi duhet të ndjekë parimet e **arsimit të të rriturve, dmth.** parimi i "**të mësuarit duke bërë**". Trajnimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe interaktiv.
- Këshilltarët komunalë duhet të marrin **trajnim për ndërmjetësim, negociim, zbatim të qasjes gjithëpërfshirëse dhe menaxhim të zgjidhjes së konflikteve për qytetarët dhe udhëheqësit**.
- Kurset e trajnimit duhet të ofrojnë njohuri dhe ekspertizë nga grupet e specializuara të **shoqërisë civile në komunitete**, veçanërisht në fushat e **barazisë gjinore dhe marrëdhënieve ndëretnike**.

3.3.4.4. Skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të rrjetëzimit për këshilltarët komunalë

Gjetjet:

Programet e rrjetëzimit për autoritetet lokale janë të pranishme në të gjitha vendet e shqyrtuara përmes programeve të Këshillit të Evropës dhe Komitetit të Rajoneve. Megjithatë, këshilltarët janë më pak të përfshirë në këto programe të rrjetëzimit dhe pozita e tyre duhet të përmirësohet. **Rrjetet tematike** për këshilltarët komunalë janë të pranishme në Danimarkë, dhe japin rezultate pozitive. Shumë programe nxisin nismat për këmbimin e praktikave, siç është bashkëpunimi ndërmjet ALDA dhe Qytetet e Energjisë.

Rekomandime:

Siç është përkrahur në disa nga shembujt e shqyrtimit, është e nevojshme të zhvillohet **ndjenja e përkatësisë midis këshilltarëve komunalë:**

- Mund të organizohen **rrjete të këshilltarëve komunalë të grupuar sipas komisioneve dhe temave specifike**. Ato mund të mbajnë takime të rregullta për krijimin e politikave dhe ngritjen e kapaciteteve (p.sh. për planifikimin urban, financat, parandalimin dhe sigurinë, etj.).
- Duke u bazuar në përvojat e disa prej vendeve të shqyrtuara, si Danimarka dhe Lituania, **një rrjet rajonal mund të jetë i vlefshëm**, pasi këshilltarët komunalë janë tashmë e përdorin këtë kontekst gjeografik për t'u takuar dhe për të diskutuar tema të përbashkëta të rëndësishme për mandatet e tyre të qeverisjes lokale (në këtë mënyrë duke ndërtuar ndjenjën e solidaritetit rajonal).
- Duhet të merret parasysh mundësia për të krijuar një rrjet **të këshilltarëve komunalë në rajonin e Ballkanit** duke përdorur rrjetin ekzistues të autoriteteve lokale, në mënyrë që këshilltarëve t'u ofrohet një **platformë për shkëmbimin e praktikave të mira dhe transferimin e njohurive në fusha të ndryshme specifike**.
- Mund të forcohet **prania e këshilltarëve komunalë në delegacionet e rrjeteve të ndryshme të Këshillit të Evropës dhe në nivel të BE-së** ose në rrjete të veçanta.
- **Rekomandohet që theks i veçantë t'i vihet angazhimit të asociacioneve të autoriteteve lokale në Ballkan për të zhvilluar një rrjet të praktikave të mira të këshilltarëve komunalë.**

4. SHQYRTIM KRAHASUES

4.1. Këshillat komunalë në Maqedoni, pika jonë fillestare dhe përfundimtare

Konteksti maqedonas është pika fillestare dhe përfundimtare e këtij shqyrtimi krahasues. Më poshtë janë prezantuar disa nga pikat kyçe të bazuara në hulumtime dhe takime ndërmjet palëve të interesuara.

Përkundër legjislacionit pozitiv dhe të balancuar, këshillat komunalë maqedonas ende identifikohen si një **element i dobët në nivelin lokal të pushtetit**. Marrëdhënia e pabalancuar midis pushtetit ekzekutiv të kryetarëve të komunave dhe rolit të këshilltarëve komunalë mbetet një pikë e dobët. Në kohë vështirësish ekonomike (sidomos për komunat më të vogla), roli i këshillave komunalë është thelbësor por kryesisht i nënvlerësuar.

Këshilltarët komunalë rrallë japin kontribut cilësor të mjaftueshëm në hartimin e politikave ose nuk i perceptojnë të gjitha aspektet e çështjeve të paraqitura dhe të përpunuara në pjesë të madhe vetëm nga administrata. Kjo dobësi është pjesërisht për shkak të mungesës së kompetencave, por është gjithashtu rezultat i një kuadri joadekuat social dhe motivues që nuk i nxit këshilltarët për të marrë më shumë aftësi dhe informacione. **Perceptimi i përgjithshëm se roli i këshilltarëve është i dobët**, pasi ata janë zgjedhur në bazë të një skeme të votimit partiak-politik, imponon kufizimin e zhvillimit të kapaciteteve vendimmarrëse përkatëse mes këshilltarëve, duke rezultuar me një mungesë të motivimit për vetëpërmirësim dhe marrjen e përgjegjësive. Të gjitha këto aspekte kufizojnë rolin strategjik dhe drejtimet që këshilltarët duhet t'i ofrojnë.

Ashtu si në shumë vende të tjera që dalin nga një periudhë tranzicioni, këshilltarët komunalë në Maqedoni perceptohen më shumë si organe *formale sesa substanciale* demokratike. Disa shembuj të mirë të planifikimit pjesëmarrës (siç janë Forumet në bashkësi dhe procesi i konsultimit të qytetarëve dhe bashkësive lokale gjatë hartimit të buxhetit dhe programit vjetor) kanë për qëllim të stimulojnë zhbllokimin e potencialit në angazhimin e qytetarëve me komunat dhe ende më shumë me këshilltarë. Kapaciteti për të angazhuar qytetarët me një qasje pjesëmarrëse dhe perspektiva strategjike afatgjate mbeten të dobëta, pjesërisht për shkak të dobësive të këshilltarëve komunalë.

Maqedonia ka dy nivele të qeverisjes (qendrore dhe lokale) dhe rajone të planifikimit. Është një vend i vogël në rajonin e Ballkanit Perëndimor në qendër të miqësive historike rajonale, por edhe vështirësive. Vendi është anëtar i Këshillit të Evropës dhe ka ratifikuar Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. **Zhvillon procesin e decentralizimit**, demokratizimit lokal dhe fuqizimit të njësive lokale me këshillat e zgjedhur dhe organet ekzekutive. Maqedonia është vend kandidat për anëtarësim në BE që nga viti 2005 dhe për këtë arsye udhëhiqet nga standardet e qeverisjes të dhëna në Kapitujt e negociatave. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes, dmth. 80 komuna plus Qyteti i Shkupit, janë mbledhur në një asociacion kombëtar të quajtur BNJVL.¹² Viteve të fundit, spektri politik, i cili drejtpërsëdrejti ndikon në mundësitë që këshillat komunalë të bashkëveprojnë me aktorë të ndryshëm në qeverisjen lokale, janë **polarizuar në mënyrë dramatike me logjikën binare "me ose kundër"**. Ky mosfunksionim gjithashtu ndikon në këshillat komunalë, të cilët duhet të jenë më të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve brenda kompetencave të pushtetit lokal. Partitë politike shpesh janë pika e vetme e referencës (në të mirën dhe në të keqen) për marrjen e informacionit, e cila kufizon procesin kolektiv dhe demokratik që duhet të ndodh në seancat e këshillit komunal dhe të komisioneve.

Sa i përket **financave**, këshilltarët komunalë shpesh luajnë një rol, por nuk kanë kompetencën e nevojshme për të kuptuar të gjitha informacionet e nevojshme për të marrë vendime të shëndosha dhe koherente. Puna financiare ndryshon nga komuna në komunë, por në përgjithësi vendimet e marra nga këshilltarët për çështjet financiare shpesh janë tepër optimiste dhe joreale (që çon drejt mbështetjes së mbishpenzimeve). Këshilltarëve shpesh iu mungojnë kompetencat dhe përgatitjet për të kuptuar kompleksitetin e shpenzimeve publike (llogaritë rrjedhëse vjetore, borxhet dhe detyrimet, kostot e investimeve, të ardhurat lokale, vizionimi etj.). Disa komuna kanë llogaritë e tyre të bllokuara për shpenzime të tepërta dhe për shkak të borxhit të tepruar, duke i pamundësuar kështu që të ofrojnë të gjitha shërbimet për qytetarët. Edhe pse një praktikë e shëndoshë dhe sistematike e **auditimit të brendshëm ose mekanizëm i kontrollit** ekziston, ai nuk jep rezultatin e pritur për të siguruar buxhete të shëndosha afatgjate për shkak të mungesës së ndjenjës së përgjegjësive nga ana e këshillave komunalë.

12 BNJVL është Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë: <http://zels.org.mk>

Në lidhje me arritjen e një përfaqësimi të balancuar të grave midis vendimmarrësve dhe këshilltarëve në nivel lokal, që paraqet **elementin kyç të qeverisjes së mirë,** pushteti lokal maqedonas ende nuk shënon rezultatet e pritura. Përfaqësimi i grave në këshilla dhe lista të kandidatëve për parti të është përmirësuar falë një sistemi të kuotave, por kjo nuk është përkthyer në një rrjedhë të vërtetë të orientimit gjinor të qeverisjes. Në vitin 2015, Parlamenti miratoi një ligj të ri zgjedhor që kërkon që listat zgjedhore të përfshijnë një minimum prej 40% të kandidatëve femra. Megjithatë, kjo është një sfidë që duhet të trajtohet në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Ngritja e vetëdijes gjinore midis udhëheqësve dhe partive politike është vendimtare për të arritur një zbatim të vërtetë të sistemit të kuotave.

Në një vend që ka arritur në masë të madhe të kapërcejë tensionet ndër-etnike në mënyrë paqësore, ndryshe nga disa vende të tjera në këtë rajon të trazuar, mbase befason fakti që mundësia për një valorizim inovativ dhe funksional i përfaqësimit të minoriteteve në këshillat komunalë nuk është as i dukshëm as funksional. Edhe pse komunat në të cilat më shumë se 20% e popullsisë i përkasin bashkësive jo-shumicë janë të detyruara të formojnë komisione ndër-etnike për të nxitur dialogun midis bashkësive të ndryshme (12 e kanë bërë këtë vullnetarisht), këto komisione shpesh ekzistojnë vetëm me emër, kryesisht për shkak të mungesës së fondeve për aktivitetet e tyre.

Përveç kryetarit të këshillit komunal, këshilltarët e tjerë komunalë rrallë e shohin veten si aktorë përgjegjës për ruajtjen e ekuilibrit demokratik në pushtetin lokal. **Ata shpesh nuk e konsiderojnë veten si agjentë të pavarur** të cilët mund të bashkëveprojnë me këshillat e tjerë komunalë nga qytete të ndryshme. Ekziston një mungesë e *esprit de corps*.¹³ Komiteti i Këshillave të BNJVL-së ka adresuar këtë çështje me pak sukses. Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve janë përqendruar në forcimin e stafit administrativ, kryetarëve të komunave dhe personelit tjetër udhëheqës.

Ky rreth vicioz i dukshmërisë së ulët dhe rëndësisë së zvogëluar të këshillave komunalë e bëjnë rolin e këshilltarëve më pak interesantë. Gjendja me këshillat komunalë në Maqedoni ka penguar eksplotimin e plotë të potencialit për angazhimin e qytetarëve.

Janë identifikuar tre shtysa kryesore për ndryshim si të rëndësishme dhe të pranishme në kontekstin e Maqedonisë. Këto përpjekje mund të shfrytëzohen në mbështetje të fuqizimit të ardhshëm të këshillave komunalë:

1. Harmonizimi i vazhdueshëm i vendit me normat e BE-së ka sjellë një transparencë më të madhe në shpenzimet publike, qeverisjen, shoqërinë civile dhe inkurajon angazhimin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.
2. Ekziston një kërkesë e dukshme publike nga qytetarët për qeverisje më të mirë lokale dhe forma më pjesëmarrëse të qeverisjes lokale, siç shihet, për shembull, në veprimet kolektive për çështjet mjedisore dhe të tjera.
3. Mjetet e reja dhe alternative të financimit lokal, me opsione të ndryshme që u jepen fondeve të pakta (kronike), mund të motivojnë dhe mundësojnë këshilltarët që të marrin rol më të rëndësishëm.

Disa sfida kryesore duhet të shndërrohen në elemente pozitive kyçe:

1. Politizimi dhe mbizotërimi i përkatësisë partiake-politike duke përjashtuar gjitha të tjerat nuk janë të favorshme për zhvillimin e një vlerësimi të pavarur kritik të punëve komunale, veçanërisht në lidhje me çështjet buxhetore.
2. Këshillat komunalë mbeten jashtëzakonisht të marginalizuar në punën e përgjithshme të qeverisjes lokale dhe nuk perceptohen si qendra të demokracisë lokale, siç thotë ligji.
3. Financimi mbetet shumë i centralizuar, duke i lënë këshillat komunalë me pak ndikim në shpenzimet dhe zgjidhjet lokale.
4. Niveli i shkathtësisë dhe motivimit midis anëtarëve të këshillave komunalë është i ulët, gjë që ka kontribuar në një dobësim të përhershëm të pozitave, në një rreth vicioz.
5. Çështjet si përfshirja sociale, barazia gjinore dhe bashkëpunimi ndëretnik nuk njihen si kompetenca të këshilltarit komunal. Këto çështje nuk diskutohen ose trajtohen rrallë dhe në mënyrë sporadike. Procesi i vendimmarrjes në nivel lokal gjithashtu tenton të përjashtojë pjesëmarrjen e organizatave të specializuara të shoqërisë civile.

¹³ *Esprit de corps*, Shprehje franceze që mund të përkthehet si "ndjesia e të qenurit grup"

4.2. Funksionimi i këshillave komunalë dhe struktura e tyre

Pjesa e parë substanciale e këtij shqyrtimi krahason treguesit lidhur me metodat për zgjedhjen e këshilltarëve komunalë. Aty paraqiten gjetjet mbi mandatin dhe fokusin e këshilltarëve komunalë, me një vështrim të veçantë mbi marrëdhëniet e tyre me kryetarin dhe me ekzekutivin. Gjithashtu do të merren parasysh mënyrat se si këshilltarët përgatiten për vendimin e tyre dhe si ata votojnë, si dhe struktura dhe organizimi i komisioneve. Një seksion i veçantë do të shqyrtojë mënyrat në të cilat këshilltarët paguhën për angazhimin e tyre, duke adresuar kështu çështjen e përgjithshme të motivimit.

4.2.1. Zgjedhja e këshillave komunalë

Kjo pjesë për zgjedhjet komunale përfshin aspekte relevante të qeverisjes. Pavarësisht nga dëshira dhe pritjet për të pasur *këshilltarë kompetentë dhe të aftë*, nuk ekzistojnë mekanizma në vendet e shqyrtuara për të vlerësuar ose specifikuar nivelin e arsimit apo kushtet e tjera sociale që kërkohen nga kandidatët që konkurrojnë në zgjedhjet komunale.

Maqedonia:

Të drejtën për t'u zgjedhur si anëtar i këshillit komunal e kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të moshës 18 vjeç e lart me vendbanim të përhershëm në komunë. Në zgjedhje, kandidatët mund të paraqiten në listat e **partive politike** ose në **listat e qytetarëve**. Listat e qytetarëve përbëhen nga një grup i qytetarëve të paraqitur nga një "bartës liste". Për të paraqitur listën e qytetarëve në zgjedhje, "bartësi i listës" duhet të mbledhë nënshkrime për mbështetje. Numri i nënshkrimeve të kërkuara varet nga numri i banorëve në komunë. Për shembull, për një komunë me më pak se 10,000 banorë, kërkohet minimum 100 nënshkrime nga persona me të drejtë vote në atë komunë, ndërsa në komunat me më shumë se 100,001 banorë kërkohen të paktën 450 nënshkrime.

Numri i anëtarëve të këshillit komunal varion nga 9 deri në 33, varësisht nga numri i banorëve në komunë. Anëtarët e këshillave komunalë zgjidhen në përputhje me parimin e **përfaqësimit proporcional**.

Vendet në shqyrtim:

Sa i përket **votimit të këshilltarëve komunalë në një votim të përgjithshëm**, në të gjitha vendet e analizuara, mosha minimale është 18 vjeç (si për të drejtën pasive ashtu edhe atë aktive të votimit). Në vendet e BE-së, një kandidat duhet të ketë një qëndrim të përhershëm në vend dhe në komunë që të **mund të votojë në nivel lokal madje edhe nëse është shtetas i një vendi tjetër**. Në **Danimarkë, një klauzolë e posaçme përcakton një periudhë më të gjatë qëndrimi** (më shumë se 3 vjet) si kusht për ata që nuk janë shtetas nga një shtet anëtar i BE-së ose nga Islanda ose Norvegjia.¹⁴ Kushti minimal i moshës për kandidatët është gjithashtu **18 vjet, përveç Lituanisë, ku një kandidat duhet të jetë 20 vjeç në ditën e zgjedhjeve**.

Parimi kryesor për identifikimin e këshilltarëve komunalë është përmes **listave me emra të shumëfishta** të hartuara nga palët. Mandatet e këshilltarit shpërndahen në listat zgjedhore në përpjesëtim me numrin e votave të fituara nga secila listë zgjedhore. Serbia i referohet partive ose koalicionit të partive. Nuk ka përjashtim nga ky model në vendet e shqyrtuara. Megjithatë, disa legjislacione mundësojnë **listat qytetare ose emërime nga grupet e qytetarëve**, ndonëse me nivele të ndryshme të zbatimit efektiv. Në **Lituani**, për shembull, nuk ka lista qytetare në nivel lokal dhe këto lista nuk përmenden në legjislacion. Në **Slloveni** ekziston kushti që një **numër përkatës i njerëzve të shprehin besimin e tyre në listën qytetare** (të paktën 1% e votuesve që kanë votuar në zgjedhjet paraprake lokale, por të paktën 15 votues ose më shumë se 1,000 duhet të nënshkruajnë/mbështesin kandidimet). Koncepti i një **"grupi qytetarësh"** zbatohet në **Serbi**.¹⁵ Në **Danimarkë** nuk ka lista qytetare, por nuk është e detyrueshme që personi të jetë anëtar i një partie politike për t'u kandiduar për zgjedhje.

14 Njerëzit që nuk janë shtetas të Danimarkës, të një shteti tjetër anëtarë të BE-së, Islandës ose Norvegjisë, nuk mund të votojnë nëse kanë banuar në Mbretërinë për një periudhë prej tre vjetësh para zgjedhjeve.

15 Republika e Serbisë, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 67.

Në të gjitha vendet e vëzhguara, votat e bazuara në listat ndjekin **sistemin e përfaqësimit proporcional**: zgjidhen ata që bien në përqindjen e votave të marra, duke filluar nga fillimi i listës.¹⁶ **Parimi i shumicës** ndiqet në rrethana shumë të rralla, si në rastin e përfaqësimit të minoriteteve në Slloveni. Në të gjitha vendet e shqyrtuara, mandati **zgjat katër vjet dhe këshilli mund të rizgjidhet në mënyrë të vazhdueshme**. Numri i këshilltarëve ndryshon sipas vendit, por është proporcional me **numrin e banorëve të komunës**¹⁷ (kryesisht duke iu referuar Statutit të Komunës).¹⁸ Serbia ka numrin më të madh të këshilltarëve në një komunë, me 75 këshilltarë për qytetet më të mëdha. Sllovenia ka numrin më të ulët, me 7 këshilltarë për komunat e vogla.¹⁹ Këshilli më i madh komunal në Maqedoni është në Kumanovë, me 33 këshilltarë (Shkupi është i ndarë në komuna më të vogla).

4.2.2. Kompetencat e këshillave komunalë

Mandati dhe fushëveprimi i kompetencave të këshillave komunalë dallojnë midis vendeve të shqyrtuara. Megjithatë, këshillat konsiderohen **si organi kryesor i qeverisjes lokale** në të gjitha vendet, dhe të cilëve u besohen "të gjitha vendimet në shkallë të fundit". Edhe në kontekstet ku pushteti ekzekutiv (dmth. Kryetari i komunës) zgjidhet nga qytetarët dhe jo brenda këshillit komunal, legjislacioni përcakton një rol vendimtar strategjik dhe planifikues për këshillin, ndërsa zbatimi i është besuar organeve ekzekutive (më tepër detaje mbi marrëdhëniet midis kryetarëve të komunave dhe këshillave jepen më poshtë në tekst).

Shembuj të formulimeve që shprehin rolin e këshilltarëve

- **Formulimi i përdorur në Slloveni:** Këshilli komunal është **organi më i lartë vendimmarrës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e komunës**.
- **Formulimi i përdorur në Danimarkë:** *Kommunalbestyrelsen* (këshilli komunal) është përgjegjës për vendimmarrjen e *përgjithshme*.

Ngjashmëritë:

Këto janë kompetencat të cilat u gjetën në të gjitha vendet e shqyrtuara:

1. **Këshilli komunal miraton llogaritë dhe buxhetin e përkohshëm të komunës.**
2. **Këshilli komunal miraton strategjitë dhe planet zhvillimore** që ka të ngjarë të kenë efekt në afat të mesëm dhe të gjatë, duke përfshirë investimet potenciale të ardhshme dhe angazhimet financiare. Për shembull, Danimarka përcakton Këshillin si organ "përgjegjës për buxhetin komunal, drejtimin e institucioneve lokale dhe miratimin e politikave lokale", ndërsa Lituania përfshin juridiksionin e këshillit për "miratimin e dokumenteve të veçanta të planifikimit hapësinor të nivelit komunal apo të lokalitetit".
3. **Këshillat komunalë miratojnë organizimin e tyre në komisione**, disa prej të cilave propozohen nga vetë Këshilli.²⁰
4. **Këshilli komunal gjithashtu "mbikëqyr" rolin e kryetarit dhe administratës** në zbatimin e vendimeve të këshillit.
5. **Këshilli komunal vendos për blerjen dhe shitjen e pronës komunale.**

16 Në Danimarkë, parimi i votimit u miratua nga D'Hondt.

17 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale: <http://www.parliament.am/library/Tim/slovenia.pdf>

18 Në Danimarkë ka gjithsej 2,444 këshilltarë komunalë dhe secila komunë duhet të vendosë se sa vende duhet të kërkojnë në këshillin e saj.

19 Prefektët përcaktojnë numrin e këshilltarëve bashkiak për çdo bashki nën juridiksionin e tyre, varësisht nga numri i popullsisë sipas Zyrës së Gjendjes Civile me 1 janar të vitit kur janë mbajtur zgjedhjet.

20 Kompetencat shpesh lidhen me shkollat (fillore dhe të mesme) dhe kujdesin për fëmijët, transportin lokal, mjedisin lokal, kulturën dhe sportin.

Specifikat sipas vendit në kompetencat e këshillave komunalë:

Shqipëria	Reforma territoriale dhe administrative e kohëve të fundit ka krijuar një lidhje midis kryetarëve të bashkive dhe këshilltarëve bashkiakë nga njëra anë dhe këshillave të qarkut nga ana tjetër. Të gjithë kryebashkiakët marrin pjesë në këshillat e qarkut dhe këshilltarët e bashkive janë gjithashtu të përfaqësuar.
Serbia	Këshilli komunal rregullisht miraton buxhetin dhe llogaritë dhe strategjinë për komunën.
Sllovenia	Këshillat komunalë caktojnë një përfaqësues në Njësinë e Administratës Shtetërore, si dhe japin mendim për të deleguarit e njësive të përfaqësuesve të shtetit. Këshilli komunal mund të krijojë, me dekret, komisione lokale, fshatare ose të lagjeve për të shërbyer si organe këshillëdhënëse.
Lituania	Teksti iu referohet kompetencave të thjeshta dhe ekskluzive (p.sh. kompetencat që nuk mund t'i delegohen ndonjë organi tjetër). Këshillat komunalë vendosin për "vijën e sjelljes që do të mbahet me qytetarët" .
Danimarka	Autoritetet lokale janë gjithashtu përgjegjëse për ofrimin e ndihmës për të papunët dhe për integrimin e migrantëve, me implikime për organizimin e brendshëm komunal dhe komisionet.

Vlerësimi i punës së këshilltarëve dhe komisioneve komunale

Shqipëria	Dispozitat ligjore për monitorimin dhe vlerësimin e këshillave komunalë. Me sjelljen e ligjit të ri në vitin 2015, kryetari i komunës i vetëm mban përgjegjësinë për komunën. Ekzistojnë rregullore që përcaktojnë arsyet për tërheqjen e mandatit të këshilltarëve komunalë dhe për shpërndarjen e këshillit komunal.
Serbia	Kuadri ligjor ekzistues nuk rregullon monitorimin dhe vlerësimin e kuvendit.
Sllovenia	Nuk ka rregullore për punën e këshilltarëve komunalë. Bordi mbikëqyrës luan rol në financat e të gjithë këshillit komunal.
Lituania	Lituania nuk ka asnjë sistem vlerësimi. Sipas ligjit, këshillat komunalë duhet të komunikojnë me votuesit në vazhdimësi dhe t'u raportojnë qytetarëve së paku një herë në vit në përputhje me procedurat e përfshira në rregullat e sjelljes.
Danimarka	Nuk ka rregullore për vlerësimin e punës së këshilltarëve komunalë.

4.2.3. Komisionet dhe organet e brendshme të këshillave komunalë

Ngjashmëritë:

Statutet e komunave në çdo vend, duke përfshirë Maqedoninë, u japin këshillave autoritetin për të ngritur **komisione** dhe për të organizuar punën e tyre të brendshme:

- Disa komisione janë të **detyrueshme (rrallë)** dhe disa janë themeluar nga këshillat komunalë në bazë të **kërkesave dhe kushteve specifike.**
- Të gjitha komisionet komunale përbëhen nga **këshilltarë** (ndërsa në Slloveni dhe Danimarkë ato mund të përfshijnë edhe qytetarë - shih më poshtë).
- Të gjitha komisionet komunale kanë një **rol këshillues** që është i hapur për votim nga këshilli, edhe pse ata përfaqësojnë strukturën e punës në kuadër të seancave të Këshillit.
- Komisionet ngrihen me **propozim të anëtarëve të këshillit** sipas kritereve të ndryshme dhe me votën e **shumicës nga këshilltarët e pranishëm** (me përjashtim të rregullave të ndryshme të përmendura më poshtë).

Vlerësimi i angazhimit të këshilltarëve komunalë është një çështje komplekse, veçanërisht sa i përket punës së tyre në komisione. Në parim, suksesi i tyre bazohet në *pjesëmarrjen* në takime.

Detajet mbi komisionet

<p>Shqipëria</p>	<p>Emërimi i komisioneve: Këshilli bashkiak zgjedh komisionet e përbëra nga anëtarë të këshillit dhe miraton rregullat e tyre të brendshme të punës. Komisionet duhet të krijohen në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.</p> <p>Komisionet e detyrueshme: Ligji nuk parasheh komisione të detyrueshme me përjashtim të Komisionit për mandate. Komisionet janë themeluar për funksione të veçanta ose për grupe funksionesh. Ndërkohë që ka gjithmonë një komision për financa, çështje gjinore dhe ndëretnike mund të adresohen brenda punës së një Komisioni të Çështjeve Sociale.²¹</p>
<p>Serbia</p>	<p>Emërimi: Kuvendi Komunal sjell vendimin për krijimin e organeve këshillëdhënëse për aktualizimin e politikave sektoriale, të përbëra nga anëtarët e kuvendit komunal nga institucionet publike përkatëse, të quajtura Këshilla (Savet) të dedikuara për tema të caktuara.</p> <p>Komisionet e detyrueshme: Shumë komisione të detyrueshme janë të përcaktuara me ligj, duke përfshirë këtu edhe komisionin për çështje gjinore dhe etnike. Megjithatë, zbatimi i plotë varet nga mundësitë financiare.²²</p> <p>Çështje të tjera: Nuk ka mjete për vlerësimin e performancës të anëtarëve të Kuvendit, përveç kriterit të pranisë ose mungesës në seancat e kuvendit komunal dhe komisioneve.</p> <p>Çështja e vlerësimit të anëtarëve të kuvendeve komunale kryesisht rregullohet me Kodin e Mirësjelljes i miratuar nga kuvendet komunale, i cili përcakton standardet etike të sjelljes së autoriteteve lokale dhe rolin e tyre në interesin publik.</p>
<p>Sllovenia</p>	<p>Emërimi: Anëtarët e komisioneve dhe komiteteve emërohen nga radhët e këshilltarëve komunal dhe banorë të tjerë të komunës, por jo më shumë se gjysma e anëtarëve. Kryetari i trupit punues të këshillit komunal është anëtar i këshillit komunal. Anëtarësia në një komision ose komitet të këshillit nuk është në kundërshtim me anëtarësinë në komitetin mbikëqyrës komunal ose punësimin në administratën komunale.</p> <p>Komisionet e detyrueshme: Nuk parashihen komisione të detyrueshme përveç Komisionit për Mandate, Zgjedhje dhe Emërimet.</p>
<p>Lituania</p>	<p>Emërimi: Komisionet e këshillit komunal janë formuar për të siguruar shqyrtimin paraprak të çështjeve të paraqitura në këshillin komunal dhe për të paraqitur konkluzione dhe propozime, për të kontrolluar respektimin e ligjeve dhe zbatimin e vendimeve të këshillit komunal dhe kryetarit të komunës.</p> <p>Sa i përket komisioneve të tjera, secila komunë merr vendimin e vet. Sipas ligjit, këshilli komunal përcakton numrin, përbërjen dhe kompetencat e komisioneve. Gjatë krijimit të komisioneve të tjera, duhet të respektohet parimi i përfaqësimit proporcional.²³</p> <p>Komisionet e detyrueshme: Secila komunë është e detyruar ligjërisht të ngrejë një komitet kontrolli. Për kohëzgjatjen e mandatit të tij, këshilli komunal është ligjërisht i detyruar të krijojë Komisionin e Etikës dhe Komisionin kundër Korrupsionit.</p>

21 Me Ligjin 139/2015 'Për Organizimin dhe Funkcionimin e Vetëqeverisjes Lokale'.

22 Sipas nenit 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

23 Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 14. Komisionet e Këshillit Komunal.

Danimarka


Emërimi: Komisionet ekzekutive janë përgjegjëse për administratën lokale. Anëtarët e tyre emërohen nga këshillat komunalë për një periudhë katërvjeçare. Komisionet e përhershme asistojnë këshillin komunal në përgatitjen e vendimeve.

Komisionet e detyrueshme: Këshillat komunalë janë të detyruar ligjërisht të ngrenë një komision financiar të kryesuar nga kryetari i komunës. Ky komision duhet të ketë kompetencë në çështjet e punësimit nëse nuk është themeluar komision tjetër për këtë qëllim. Struktura e komisionit ndryshon shumë nga komuna në komunë. Secila komunë ka një administratë që i shërben këshillit komunal dhe komisioneve. Këshilli gjithashtu mund të krijojë komisione të posaçme, siç janë komisioni për arsim, komisioni për punësim dhe komisioni për shëndetësi dhe çështje sociale.


Çështje të tjera: Komisionet mund të përfshijnë qytetarë që nuk janë anëtarë të këshillit lokal.

Më tepër rreth Danimarkës dhe Magjistratit: Komunat më të mëdha në Danimarkë mund të vendosin sistem ku administrata menaxhohet nga një **organ korporativ (magjistrat)**, i zgjedhur nga **këshilli lokal dhe i përbërë nga kryetari i komunës dhe këshilltarë, që i përfaqësojnë partitë politike**. Magjistrati kryen funksionin e njëjtë si komisionet në pushtetin lokal.²⁴

1. Në komunat më të mëdha



2. Në komunat më të vogla



²⁴ Organizimi i këshillave të qarkut është mjaft i ngjashëm me atë të këshillave lokalë. Numri i anëtarëve të këtyre këshillave mund të shkojnë nga 7 në 31, edhe pse secili qark mund të vendosë për numrin e anëtarëve të vet. Numri duhet të jetë tek dhe vendoset nga këshillat e qarkut, të kryesuar nga kryetari i bashkisë.

4.2.4. Rregullorja e punës e Këshillit komunal, përgatitja dhe shpërndarja e materialit për vendimet e këshillit

Maqedonia:

Dokumentacioni për këshillin komunal përgatitet nga administrata komunale. Seancat e këshillave komunale dhe puna e komisioneve përgatiten nga administrata komunale.

Të gjitha vendet e shqyrtuara ndjekin procedurat e ngjashme në këtë drejtim. Materialet e propozuara për votim në mbledhjet e këshillit komunal përgatiten nga **administrata dhe/ose nga komisione të veçanta**. Këshilli voton me procedurë të rregullte të **shumicës së votave të atyre që janë të pranishëm** dhe me procedurë emergjente në raste të caktuara. Intervistat e kryera me asociacionet e autoriteteve lokale në Shqipëri dhe Lituani për këtë shqyrtim, nxorën në pah rëndësinë e mbështetjes së TI dhe prezencës së sporteleve. Mbështetje e jashtme kërkohet edhe për disa çështje teknike.

Një çështje që theksohet në këtë raport është se si të përmirësohet cilësia e dokumenteve të përgatitura për këshillat, duke përfshirë kapacitetin e stafit lokal për të përgatitur dokumentet, në mënyrë që të kuptohen dhe ndiqen nga këshilltarët komunalë. (Shih më tepër mbi komponentët e trajnimit).

Shqipëria	Në rastin e Shqipërisë , sekretari i këshillit komunal është "përgjegjës të kujdeset për përgatitjen e materialeve për mbledhjet e këshillit, sipas rendit të ditës", ndërsa "Kryetari merr masa për përgatitjen e materialeve për këshillat komunalë mbledhjen e këshillit dhe temën e shtuar prej tyre". Mbështetja e jashtme ofrohet vetëm për çështje teknike që kërkojnë ekspertizë specifike.
Serbia	Kërkesat për mbledhje dhe materialet për seancat u sigurohen anëtarëve të kuvendit lokal para çdo seance. Materiali për seancat mund të dorëzohet në mënyrë elektronike (aty ku ka kushte) të gjithë këshilltarëve nëpërmjet adresave të tyre zyrtare të e-mailit. Sekretariati për Administratë të Përgjithshme dhe Çështje të Përbashkëta mbështet përgatitjen e materialit për këshilltarët (si pjesë e mbështetjes së tij profesionale dhe administrative). ²⁵ Kjo përfshin dhënien e materialeve në selinë e kuvendeve të qytetit. Takimet e komisioneve mund të organizohen për informacione të mëtutjeshme dhe për përpunimin/diskutimin e temave specifike para mbajtjes së seancave të kuvendit.
Slllovenia	Materialet për seancat e këshillit komunal përgatiten nga administrata. Disa kompani iu ofrojnë ndihmë komunave në përgatitjen e disa akteve ligjore.
Lituania	Lejohet të ftohen ekspertë dhe organizata të jashtme për të shfrytëzuar përvojën e tyre në përgatitjen e dokumenteve.
Danimarka	Çdo komunë ka një administratë që i shërben këshillit komunal dhe komisioneve. Departamenti i kryetarit kryen shërbimet e sekretarisë së këshillit (p.sh. ata përgatisin mbledhjet e këshillit, agjendën, vendin, shtojcat etj.).

25 Kjo mbështetje përfshin përgatitjen dhe organizimin e seancave, mbajtjen dhe hartimin e procesverbaleve të seancave të Kuvendit të Qytetit dhe organeve të tij të punës, si dhe çështje që lidhen me publikimin e vendimeve dhe akteve të tjera në "Gazetën Zyrtare të Qytetit". Njësia është përgjegjëse për përkthimin dhe redaktimin e materialeve për këshillin dhe organet e tij të punës si dhe për aktivitetet e shumëzimit të materialeve.

4.2.5. Kompensimi i këshilltarëve komunalë.²⁶

Maqedonia:

Kompensimi i këshilltarëve është një çështje vendimtare në lidhje me motivimin e këshilltarëve (respekt për njohjen shoqërore dhe ndjenja e përgjegjësisë shoqërore). Sidoqoftë, këshilltarët komunalë, edhe kur nuk konsiderohen *se punojnë për komunën*, marrin kompensimin që mund të jetë prej 150 deri 250 euro në muaj (me përjashtim të Qytetit të Shkupit ku kompensimi mund të arrijë 350 euro). Ky kompensim është i barabartë me një pagë të mirë sipas standardeve maqedonase. Kryetari i këshillit mund të jetë profesionist (nëse nuk ka ndonjë punë tjetër), por paga e tij nuk arrin shkallën e të ardhurave mesatare. Nuk ka tarifa shtesë apo pagesa shtesë për angazhimin e këshilltarëve komunalë në komisionet. Sidoqoftë, këshilltarët mund të sanksionohen nëse nuk marrin pjesë në mbledhjet: pas tre mungesave me radhë në seancë, këshilltari humbet pozitën e tij në këshill.

VENDI	LLOJI I KOMPENSIMIT
Shqipëria	Këshilltarë paguhen me 10% të pagës mujore të kryetarit të bashkisë . Paga e kryetarit ndryshon sipas madhësisë së popullsisë. Pjesëmarrja në komisionet është pjesë e detyrave të këshilltarit.
Serbia	Anëtarët e Kuvendit të Serbisë kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të transportit dhe kompensim për kryerjen e funksionit të këshilltarit (tarifa e këshilltarit) . Pagesa mujore është 30 për qind e pagës mesatare mujore për punonjës (rreth 50 euro). Pagesa për pjesëmarrje në komisione varet nga buxheti i këshillit, statuti dhe vendimet e brendshme.
Sllovenia	Këshilltarët e Sllovenisë konsiderohen “vullnetarë” dhe punojnë mesatarisht 0 deri në 4 orë në ditë për këshillin. Atyre u jepet kompensim për pjesëmarrje (afërsisht 200 euro në muaj). Pjesëmarrja në komisionet dhe komitetet e këshillit është pjesë e detyrave të tyre. Anëtarët e komisioneve mbikëqyrëse kryejnë vullnetarisht detyrat e tyre.
Lituania	Këshilltarët, me përjashtim të kryetarëve dhe nënkryetarëve të komunave, ²⁷ rimbursohen me <i>orë pune</i> . Këshilli cakton shumën e kompensimit . Ky kompensim llogaritet në bazë të të dhënave zyrtare për pagat mesatare. Në Lituani pagat caktohen duke në bazë të pagës mesatare bruto (të dhënat e fundit në dispozicion: qershor 2017 - 817.60 EUR / muaj). Këshilltarit mund t'i jepet një kompensim mujor për shpenzimet administrative.
Danimarka	Këshilltarët komunalë punojnë 15 orë në javë për këshillat dhe paguhen sipas rrethanave. ²⁸ Shuma varet nga numri i banorëve në komunë dhe nga numri i komisioneve që i ndjekin .

26 Shih: Kompensimi financiar i përfaqësuesve të zgjedhur lokalë dhe rajonalë dhe zyrtarëve publikë në ushtrimin e funksionit të tyre - prill 2017, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale.

27 Pagën për kryetarët e komunave dhe nënkryetarët e komunave e cakton këshilli komunal.

28 Në shumicën e komunave, përfaqësuesit e vetëm të zgjedhur që ushtrojnë funksionet e tyre me orar të plotë janë kryetarët e komunave, të cilët paguhen në përputhje me kompensimet. Këshilltarët gjithashtu marrin trajnim falas.

4.3. Këshillat komunalë dhe roli i tyre në financa dhe buxhetim

Rolet e personelit të përfshirë në kontrollin financiar dhe menaxhimin e komunave janë të ndarë në mes të stafit teknik/administrativ, ekzekutiv dhe organet që sigurojnë **drejtimin politik, kryesisht këshillat komunal, i cili duhet të përgjigjet para qytetarëve**, të cilët kanë të drejtën për këtë për të vendosur nëse do të rikonfirmojnë mandatin e këshilltarëve në zgjedhjet e ardhshme.

Menaxhimi i burimeve nga ana e komunave është kompleks dhe jo tërësisht i pavarur, i nënshtrohet **legjislacionit kombëtar dhe transfereve nga shteti për shërbimet që duhet t'u dorëzohen qytetarëve**. Për më tepër, buxheti komunal aprovohet në **baza vjetore**, por këtu ka një sfond historik (shpesh me borxhe të akumuluar) dhe **parashikon investimet dhe shpenzimet e ardhshme**. Në Shqipëri, përveç planit vjetor paraqitet edhe koncepti i një buxheti gjashtëmujor.²⁹ Shqyrtimet e shpenzimeve publike janë komplekse në vetvete dhe kërkojnë kompetenca specifike që rrallë janë në pronësi të mjaftueshme të këshilltarëve komunalë që votojnë për buxhetin. Një rol të madh në këto aspekte financiare të punës komunale shpesh luan stafi administrativ, teknik dhe ekzekutiv, të cilët përgatisin dhe paraqesin shifrat në këshillin dhe komisionet.

4.3.1. Roli i këshillave komunalë në procesin buxhetor

Maqedonia:

Komunat në Maqedoni demonstrojnë një qasje gjithëpërfshirëse në hartimin e buxhetit vjetor, me konsultime fillestare mbi idetë për projekte dhe me një vlerësim duke filluar që në bashkësitë lokale. Projektbuxheti diskutohet më pas në komisionin e financave dhe në nivel të administratës, ku kryetari i komunës jep mendimet e tij, i cili merr një cirkular (me detaje mbi transferet) nga Ministria e Financave në tetor. Një praktikë tjetër e mirë në Maqedoni është përdorimi i forumeve në bashkësi, një formë konsultimi me një gamë të gjerë të palëve të interesuara për çështjet buxhetore. Këshilli komunal duhet ta miratojë buxhetin deri më 31 dhjetor. Nëse buxheti nuk miratohet deri në atë datë, kryetari mund të punojë me një buxhet të përkohshëm për tre muaj. Pas konsultimeve, buxheti final duhet të miratohet nga këshilli deri më 30 mars të vitit vijues. Mos miratimi i buxhetit çon në shpërbërjen e këshillit.

Shqipëria	Buxhetet komunale hartohen nga komisionet dhe i paraqiten këshillit, i cili merr vendimin përfundimtar për këtë çështje. Legjislacioni parasheh që: "Çdo njësi e vetëqeverisjes lokale të hartojë, miratojë, zbatojë dhe menaxhojë buxhetin e saj vjetor <i>pa deficit</i> ". Zbatimi i planeve zhvillimore strategjike duhet të monitorohet përmes raporteve vjetore mbi ekzekutimin e buxhetit. Planet zhvillimore ndiqen me një procedurë përkatëse, që përfshin Ministrinë e Financave.
Serbia	Buxhetet komunale i hartojnë komisionet dhe i paraqiten këshillit, i cili sjell vendimin përfundimtar.
Sllovenia	Këshillat komunalë miratojnë buxhetet në bazë të propozimeve të paraqitura nga kryetarët e komunave. Buxheti komunal miratohet për vitin fiskal që fillon dhe mbaron njëkohësisht me vitin fiskal të buxhetit të shtetit. Nëse buxheti komunal nuk miratohet me kohë, shpenzimet publike të komunës financohen përkohësisht sipas buxhetit të vitit paraprak.
Lituania	Organet ekzekutive/komisionet e komunave përgatisin një projekt buxhet komunal në bazë të ligjeve dhe treguesve financiarë të buxheteve komunale të miratuara nga Seimas. Komitetet dhe organet ekzekutive paraqesin projekt-buxhetin në këshillat komunalë. Këshillat komunalë janë përgjegjës për rishikimin e buxhetit të komunës, si dhe shpërndarjen e të ardhurave shtesë dhe burimeve të tjera të parave të gatshme të paplanifikuara për buxhetin. Rol të rëndësishëm në qeverisjen lokale në Lituani luajnë njësitë e lagjes dhe koordinorët e tyre .

29 Kryetarët e komunave i raportojnë këshillit komunal për gjendjen ekonomike dhe financiare të komunës dhe të njësisve administrative të saj së paku çdo 6 muaj ose kurdo që kërkohet nga këshilli.

Danimarka	<p>Komunat daneze gëzojnë liri të madhe sa i përket të ardhurave të tyre dhe menaxhimit financiar të burimeve të tyre. Sistemi i ekuilibrit financiar në Danimarkë bazohet në madhësinë e suficitit / deficitit strukturor të autoriteteve lokale. Në rastin e komunave më të dobëta financiare, barazimi garanton një shkallë të caktuar të uniformitetit në nivelin dhe cilësinë e shërbimeve. Buxheti miratohet nga këshilli komunal nëpërmjet bisedimeve ndërmjet asociacionit të komunave dhe qeverisë qendrore, pas së cilës miratimi bëhet në një kontratë në të cilën qeveria gjithashtu merr parasysh pasojat në rast se pushteti lokal hyn në krizë financiare.</p> <p>Danimarka ka një sistem të garancisë buxhetore për autoritetet lokale, ku grantet që u jepen komunave pasqyrojnë ndryshimet ciklike në kostot e tyre. Garancia buxhetore mbulon shpenzimet neto të komunave më të prekura, duke garantuar që autoritetet lokale në fjalë të vazhdojnë të përmbushin përgjegjësitë e tyre.</p>
------------------	--

4.3.2. Këshillat komunalë kontrollojnë mbishpenzimet

Maqedonia:

Këshillat komunalë në Maqedoni marrin pjesë në kontrollin e shpenzimeve të tepërta. Këshilltarët komunalë vlerësojnë të ardhurat aktuale nga buxheti i shtetit dhe marrin në konsideratë saktësinë e parashikimeve të tjera. Në shqyrtimet e shpenzimeve, këshillat komunalë i krahasojnë shpenzimet e vazhdueshme me buxhetin çdo tre muaj. Një dobësi e madhe është tendenca e këshillave në Maqedoni për të hartuar buxhete tepër optimiste me kosto të fshehura në të ardhmen. Në mënyrë tipike kjo është rezultat i parashikimit joreal të të ardhurave për të ardhmen dhe nuk mbulon të gjitha kostot, gjë që rrit rrezikun e borxhit dhe gjeneron kriza në rrjedhën e parave. Ministria e Financave nuk ndërhyr në procesin e kontrollimit të buxheteve komunale, pasi që këto buxhete nuk janë në kompetencë të saj (transfertat nga shteti), gjë që buxhetet lokale i bën tejet të paqëndrueshme dhe i lë në përgjegjësinë e aktorëve lokalë.

Përgjegjësia e këshilltarëve komunalë është vendimtare në miratimin e buxheteve, kontrollin e shpenzimeve të tepërta dhe vlerësimet tremujore. Kryetari i komunës është personalisht përgjegjës për kryerjen e këtyre detyrave. **Përgjegjësia e këshilltarëve komunalë në të gjitha vendet e shqyrtuara mbetet politike, jo personale (përveç nëse ndëshkohet).**

Kontrolli i shpenzimeve të tepërta

Shqipëria	<p>Këshillat bashkiakë në Shqipëri kanë për detyrë të miratojnë këto elemente të buxhetit: a) drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme në lidhje me financat; b) prioritetet strategjike të zhvillimit; c) politikat fiskale lokale (në përputhje me ligjin në fuqi); ç) buxhetin afatmesëm dhe buxhetin vjetor; dhe d) huamarrjen e pushtetit vendor.³⁰ Kryetari harton një raport mujor mbi ecurinë e të ardhurave dhe të shpenzimeve në krahasim me planin e periudhës përkatëse. Ky raport përfshin rezultatet sipas zërave të njëjtë në vitet e mëparshme dhe një vlerësim të rezultateve të pritura në fund të periudhës buxhetore. Raporti i dorëzohet për informim këshillit bashkiak më së voni ditën e 10-të të muajit vijues.</p> <p>Procedurat e rishikimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve buxhetore ndjekin të njëjtat rregulla si ato për buxhetin vjetor.</p>
Serbia	<p>Mbishpenzimet regjistrohen si borxh lokal në baza vjetore. Organet e pushtetit vendor, siç janë komiteti i financave dhe kuvendi komunal, mbikëqyrin mbishpenzimet. Shteti e njeh borxhin dhe mund të sigurojë mbështetje për vitin e ardhshëm.</p> <p>Disa komuna në Serbi planifikojnë së pari shpenzimet e tyre dhe pastaj, siç kërkohet me ligj për të pasur buxhet të balancuar, <i>shtypin</i> shifrën e të ardhurave, të cilat <i>nuk</i> do të realizohen. Pas një viti, shpenzimet realizohen dhe të ardhurat e parashikuara nuk mbledhen, dhe pastaj u detyrohen atyre nga të cilët kanë blerë mallra ose shërbime.</p>

30 No. 68/2017 Neni 6: Kompetencat e këshillave të njësisve të vetëqeverisjes lokale.

<p>Slovenia</p>	<p>Komitetet mbikëqyrëse komunale janë organet më të larta të mbikëqyrjes së shpenzimeve publike komunale. Këto komitete kontrollojnë buxhetin dhe parandalojnë tejkalimin e shpenzimeve. Në kuadër të kompetencave të tyre, komitetet mbikëqyrëse mbikëqyrin shitjen e pronës komunale, mbikëqyrin qëllimin dhe kuptimin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe operacionet financiare të përdoruesve të fondeve buxhetore. Këto komisione duhet të njoftojnë Ministrinë kompetente dhe Gjykatën e Auditorëve për çdo shkelje.</p> <p>Çështjet që i nënshtrohen mbikëqyrjes përfshijnë ligjshmërinë dhe korrektësinë e veprimeve të organeve kompetente dhe efikasitetin dhe efektivitetin e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit komunal.</p> <p>Këshillat komunalë, kryetarët e komunave dhe organet e shfrytëzuesve të fondeve të buxhetit komunal janë të detyruar të diskutojnë raportet e komisioneve mbikëqyrëse dhe të marrin parasysh rekomandimet dhe propozimet e tyre në përputhje me kompetencat e tyre. Detyrimet individuale të posaçme profesionale mbikëqyrëse mund të kryhen nga një ekzekutues i caktuar nga këshilli komunal me propozim të komitetit mbikëqyrës.</p>
<p>Lituania</p>	<p>Kontrollorët komunalë (kontrollorët komunalë dhe shërbimet e auditimit) janë përgjegjëse për kontrollin e shpenzimeve, që përfshin kryerjen e auditimeve financiare dhe të performancës në administratën komunale, subjektet që administrohen nga komuna dhe ndërmarrjet e kontrolluara nga komuna. Kontrollorët komunalë janë përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e opinionit çdo vit në këshill për grupin e raporteve financiare të konsoliduar të komunës.</p> <p>Për zbatimin e funksioneve të kontrollit dhe auditimit komunal, këshillat komunalë, më këshillën e një kontrolluesi komunal, mund të krijojnë³¹ një shërbim komunal të kontrollit dhe auditimit.³²</p> <p>Këshillat komunalë nuk mund të miratojnë buxhetet e pabalancuara. Hartimi i buxhetit komunal rregullohet rreptësisht me ligj. Procedura e përgatitjes, shqyrtimit dhe miratimit të buxheteve komunale përcaktohet në Ligjin për Strukturën e Buxhetit dhe rregullat miratohen me vendim të Qeverisë. Sipas nevojës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me vendim të Auditorit të Përgjithshëm, mund të kryejë auditimin financiar (ligjor) dhe performancën e komunave, si dhe institucionet dhe ndërmarrjet komunale nën kontrollin e komunave.</p>
<p>Danimarka</p>	<p>Mbikëqyrja e financave komunale dhe rajonale kryhet nga pesë departamente rajonale të decentralizuara nën drejtimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Brendshëm. Këto departamente vërtetojnë ligjshmërinë, megjithëse jo përshtatshmërinë, të veprimeve lokale dhe rajonale. Avokati i Popullit mbikëqyr të gjitha departamentet qeveritare, prandaj ka një rol ndërmjetës.³³</p>

31 Në rast se numri i banorëve të një komune është më pak se 30 mijë.

32 Nëse nuk është themeluar një shërbim komunal i kontrollit dhe auditimit, mund të thirren kontrolluesit e komunave të tjera për të kryer auditimin e jashtëm të parashikuar në plan.

33 Burimet financiare të ndara për autoritetet lokale për kryerjen e përgjegjësi të tyre rregullohen me ligjin LBK nr. 797 të datës 27 qershor 2011 për financat lokale dhe rajonale (Bekendtgørelse af lovin om regionernes finansiering).

Çfarë ndodh në rast të shpenzimeve të tepërta?

Maqedonia:

Çdo borxh dhe shpenzim i tepërt i bërë nga buxhetet komunale duhet të miratohet nga këshilli komunal me pëlqimin e Ministrisë së Financave ose Ministrisë së Ekonomisë. Ministria e Financave e Maqedonisë nuk autorizon më shumë se 3% të borxheve për komunat (që kanë të bëjnë me huat aktuale nga bankat). Megjithatë, kjo përqindje nuk përfshin shërbimet dhe blerjet e pambuluara, të cilat mund të jenë shumë më të larta se 3%. Për disa komuna, llogaritë bankare mund të bllokohen ose pjesërisht të bllokohen deri në riintegrimin e plotë të burimeve. Në këtë rast, këshillat komunalë mund të miratojnë buxhetet që marrin parasysh faktin se të ardhurat në tërësi (më shumë se ajo e përdorur për të paguar administratën e rregullt) do të përdoren për mbulimin e borxheve në të kaluarën dhe rihapjen e llogarisë. Shteti nuk mbulon borxhet e komunave.

Shqipëria	<p>Një komunë konsiderohet të jetë në probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor shënon vonesa prej më shumë se 30 ditësh në shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e përlllogaritura por të papaguara përbëjnë 15% të shpenzimeve vjetore të aprovuara.³⁴ Kryebashkiakët e informojnë këshillin dhe propozojnë masa korrektuese për tejkalimin e problemeve financiare.</p> <p>Një komunë konsiderohet të jetë në vështirësi financiare kur shtyn shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur gjendja e detyrimeve të përlllogaritura dhe të papaguara është rritur në mënyrë progresive dhe përbëjnë mbi 25% të shpenzimeve vjetore të aprovuara.</p> <p>Kryetari mund të propozojë një plan të rimëkëmbjes, i cili i dorëzohet Këshillit dhe më pas i dorëzohet Ministrisë së Financave. Ajo mund të vendosë të përdorë të ardhurat e saj burimore (brenda dy muajve nga njoftimi i këshillit) dhe/ose të përdorë fondet në rast emergjence dhe rezerve për të reduktuar detyrimet ndaj palëve të treta dhe/ose për të ndryshuar buxhetin duke rishikuar arsyet e shpenzimeve dhe/ose për të rritur nivelin e taksimit brenda kufijve të lejuar me ligj, dhe/ose për të negociuar me kreditorët për të ristrukturuar pagesat e vonuara. Duhet të publikohet plani i rimëkëmbjes nga kriza financiare i miratuar nga këshilli komunal. Një procedurë tjetër mund të zhvillohet në rast të krizës së rëndë.</p>
Serbia	<p>Rishikimi i buxhetit është i mundur dhe kryhet sipas procedurës së njëjtë si për miratimin e buxhetit. Komuna mund të ndryshojë buxhetin pa kufij gjatë vitit buxhetor. Ndryshimet e shpeshta buxhetore tregojnë planifikimin joreal të buxhetit ose rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme që kërkojnë ndryshim të buxhetit. Kur qeveria qendrore ndihmon një pushtet vendor duke marrë përsipër detyrimet e tij, këshilli ka të drejtën e ripagimit të këtij borxhi me normë interesi të shtyrë. Në këtë drejtim, shteti mund të pezullojë transferet nga buxheti tek komunat.</p> <p>Asambleja komunale duhet të miratojë buxhetin deri në dhjetor. Nëse nuk miratohet një buxhet, vendoset financimi i përkohshëm dhe qeveria qendrore mund të shpërndajë kuvendin lokal.</p> <p>Gjatë vitit, gjatë ekzekutimit të buxhetit, është e mundur të pajtohen të ardhurat dhe shpenzimet përmes rebalancit, në rast të ligjeve të reja ose arsye të tjera. Buxheti miratohet nga kuvendi komunal.</p> <p>Në rast të mbishpenzimit, borxhi publik akumulohet dhe mund të mbështetet nga transferime shtetërore shtesë, duke çuar kështu potencialisht drejt një cikël të rrezikshëm. Përkundër nivelit të lartë të borxhit publik lokal, asnjë rast i falimentimit nuk është raportuar deri tani, duke rritur kështu borxhin publik kombëtar.</p>

34 Sipas Ligjit për Financimin e Vetë-qeverisjes Lokale t, No. 68/2017.

Sllovenia	Nëse pasqyra financiare është e justifikuar, përgatitet një buxhet i rishikuar. Në rastet kur është e pamundur të balancohet zbatimi i buxhetit për shkak të një fluksi të pabarabartë të të ardhurave, komuna mund të marrë hua fonde të likuiditetit, që nuk i kalon 5% të të gjitha shpenzimeve sipas buxhetit të fundit të miratuar në mënyrë të rregullt. ³⁵ Shteti mund t'i shpërbëjë komunat për shpenzime të tepërta .
Lituania	Nëse buxheti i aprovuar është tejkaluar, këshilli komunal mund të vendosë të rialokojë buxhetin, të zvogëlojë shpenzimet dhe/ose të marrë hua.
Danimarka	Rastet e trajtuara nga autoriteti mbikëqyrës zakonisht janë objekt i një deklaratë konsultative në të cilën autoriteti jep një opinion ligjor për rastin në fjalë. Autoriteti mbikëqyrës njofton këshillin lokal për përgjegjësitë e tij sipas legjislacionit aktual. Ai gjithashtu mund të vendosë sanksione për vendimet e marra nga një këshill lokal ose kundër këshilltarëve të veçantë që kanë bashkëpunuar në një veprim të paligjshëm. Ndëshkimet në dispozicion janë anulimi, pezullimi, gjobat dhe veprimet ligjore për dëmshpërblim.

4.3.3. Roli i këshillave komunalë në përcaktimin e taksave komunale

Këshillat komunalë janë përgjegjës për përcaktimin e shkallës së taksave brenda legjislacionit kombëtar. Në varësi të nivelit të decentralizimit dhe kapaciteteve financiare për të vjelur taksat vendore, ky aspekt i qeverisjes ka rëndësi të veçantë. (Në komunat më autonome dhe të pasura, si në Danimarkë, votimi i këshillit mund të përfshijë edhe një debat thelbësor politik). Në Maqedoni, këshilli komunal miraton gamën e taksave vendore dhe duhet të jetë në gjendje të justifikojë një rritje të mundshme duke ofruar shërbime më të mira. Nevoja për të siguruar dëshmi për lidhjet midis taksave komunale dhe ofrimit të shërbimeve është një nga elementët kryesorë që i bëjnë qeveritë lokale llogaridhënëse para qytetarëve.

Shqipëria	Bashkitë e Shqipërisë ushtrojnë të drejtën e tyre për të vendosur mbi normat e taksave, mënyrën e llogaritjes së tyre dhe sistemin e vjeljes dhe administrimit të taksave, në përputhje me ligjet në fuqi. ³⁶ Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale ka të drejtë të vendosë taksa të përkohshme për ofrimin e shërbimeve specifike dhe investimeve publike për një periudhë të kufizuar kohore. Vendosja e një takse të përkohshme duhet të paraprihet nga hartimi i një plani që, së paku, tregon qartë disa kriteret. Plani i nënshtrohet seancave dëgjimore dhe miratimit të mëtejshëm të këshillit bashkiak.
Serbia	Sipas ligjit për financimin e pushtetit lokal, komunat kanë të drejtën e të ardhurave burimore të realizuara në territorin e tyre. ³⁷ Normat e të ardhurave burimore si dhe mënyra dhe kriteret për përcaktimin e shumës së taksave dhe tarifave lokale përcaktohen nga kuvendi komunal në pajtim me ligjin.
Sllovenia	Këshilli komunal përcakton shumën e taksave me dekret. ³⁸
Lituania	Këshilli komunal merr vendime për dispozitat tatimore.
Danimarka	Këshillat komunalë hartojnë buxhetet e tyre brenda kuadrit kombëtar dhe secila komunë mbledh taksat e veta.

35 Neni 10a: Krijimi i borxheve për zbatimin e buxhetit komunal; Pika 5: Ligji i Financimit të Komunave.

36 Baza e taksave lokale dhe normat e tyre maksimale dhe/ose minimale përcaktohen me ligj të veçantë. Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë të drejtë të aplikojnë ose jo një taksë vendore. Kur njësitë e tilla aplikojnë taksat vendore, ata do të ushtrojnë të drejtën për të vendosur mbi normat e tyre dhe mënyrën e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre, sipas kriterëve dhe brenda kufijve të përcaktuar me ligjin në fuqi. Përndryshe, komunat do të krijojnë të ardhura nga taksat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; e drejta për të përdorur pronën publike lokale; lëshimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe dokumenteve të tjera, mbi të cilat ato kanë autoritet të plotë, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe; dhe do të ngarkojë çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj.

37 Sipas ligjit, tatimi mbi pagat që paguhet sipas vendbanimit të punonjësit. Buxheti komunal i takojnë një maksimum prej 80% të taksave të mbledhura të këtij lloji. Kur është fjala për tatimin në pronë, kuvendi i njësisë së vetëqeverisjes lokale përcakton shumën e normës së taksimit, deri në normën maksimale të përcaktuar nga ligji që rregullon tatimin në pronë.

38 Për financimin e çështjeve lokale me interes publik, të ardhurat vijuese i takojnë komunës: tatimi mbi pasuritë; pasuritë e trashëgimisë dhe dhurimit; tatimi mbi fitimin nga lojërat e fatit; tatimi mbi tregtimin e pronës së paprekshme; tatime të tjera të përcaktuara me ligj. Proporcioni për ndarjen e të ardhurave nga paragrafi paraprak përcaktohet me një akt të veçantë të Kuvendit Nacional.

4.3.4. Planet e prokurimit, borxhet dhe asetet e autoriteteve lokale

Planet e prokurimit ndjekin procesin, i cili përfshin punën e administratës, rolin përkatës të kryetarit të komunës dhe miratimin përfundimtar nga KK. Dispozitat për borxhin ndryshojnë nga vendi në vend në aspektin e mjeteve të përdorura, aktorët e përfshirë dhe kufizimet e vendosura me ligj. Një kufi i caktuar i borxheve është i autorizuar (pas aprovimit nga institucionet kombëtare dhe këshillat komunalë), por mund të çojë në pezullimin e aktiviteteve dhe shpërbërjen e komunës. Këshilli komunal miraton marrjen dhe asgjësimin e pronës.

Maqedonia:

Planet e prokurimit janë pjesë përbërëse e procesit të miratimit të buxhetit pasi ato identifikojnë disa nga burimet e alokuara për shërbimet publike dhe shpenzimet e tjera. Sistemi i prokurimit rregullohet me ligjet kombëtare (procedurat, regjistri i kompanive që ofrojnë shërbime për institucionet publike, dukshmëria dhe transparenca, etj.). Pra, këshilli komunal njoftohet me burimet e alokuara dhe me projektet e mundshme që kanë nevojë për mbështetje (për të cilat do të kërkohet një tender publik / për prokurime) gjatë miratimit të buxhetit.

Pronat komunale blihen dhe shiten me miratimin e këshillit komunal.

Autoritetet lokale, me miratimin e KK, miratojnë borxhet (shih pikën rreth mbishpenzimit më sipër).

Shqipëria	<p>Planet e prokurimit: Planet e prokurimit publik miratohen nga Kryetari i bashkisë dhe përgatiten nga administrata bashkiake. Këshilli bashkiak e miraton planin brenda vendimit të përgjithshëm mbi buxhetin. Planet e prokurimit publik duhet të publikohen në faqet e internetit të bashkive. Megjithatë, Ligji i Prokurimit Publik në Shqipëri nuk përcakton procedurat për planet e prokurimit publik.³⁹</p> <p>Pronat: Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe asetëve bashkiake i nënshtrohen një procedure transparente dhe konkurruese. Asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose qira duhet të publikohen së bashku me kriteret. Vendimi për shitjen dhe blerjen e pronës bëhet fillimisht nga këshilli bashkiak.</p> <p>Borxhet: Komunitet mund të bëjnë një borxh afatshkurtër në përputhje me vendimin e këshillit vendor për buxhetin e vitit aktual fiskal. Një pushtet vendor mund të pësojë një borxh afatshkurtër vetëm pas një përgjigjeje negative nga Ministria e Financave në një kërkesë për financimin e deficitit të përkohshëm të buxhetit nëpërmjet një huaje pa interes ose të butë nga buxheti i shtetit.⁴⁰ Brenda kufizimeve afatshkurtra të borxhit të përcaktuara në këtë ligj, këshilli bashkiak përcakton kufirin aktual brenda të cilit kryetari i bashkisë është i autorizuar të lëshojë një borxh afatshkurtër sipas rastit.</p> <p>Në mbledhjen e radhës të këshillit, kryebashkiaku informon këshillin lokal për lëshimin e borxhit afatshkurtër, së bashku me kushtet dhe afatet e tij, duke përfshirë marrëveshjen me huamarrësin, kriteret dhe procesin e zgjedhjes së huamarrësit, si dhe provat të pajtueshmërisë me kufizimet e borxhit të përcaktuara në Ligjin për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore.⁴¹</p> <p>Një komunë mund të bëjë një borxh afatgjatë në përputhje me vendim të miratuar me shumicë nga këshilli i bashkisë.</p> <p>Njoftimi duhet të jepet përpara seancës në të cilën Këshilli e shqyrton vendimin për aprovimin dhe ky njoftim publikohet në gazetë të përditshme. Njoftimi përfshin të gjitha informacionet në lidhje me huan e kërkuar.</p> <p>Këshilli bashkiak vendos për kontratat e huamarrjes.</p>
------------------	---

39 Neni 54 - Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal - Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

40 Neni 6 - Ligji për Huamarrjen Lokale (Shqipëri).

41 Neni 7 - Ligji për Huamarrjen Lokale (Shqipëri).

<p>Serbia</p>	<p>Planet e prokurimit: Kuvendi komunal përcakton rregullat e prokurimit publik. Dokumenti rregullon prokurimin publik, përgjegjësitë dhe mënyrën e kryerjes së prokurimit publik në përputhje me ligjin që rregullon prokurimin publik, si dhe kontrollin e prokurimit publik dhe mënyrën e monitorimit të ekzekutimit të kontratave. Vendimet për planet e prokurimit publik miratohen dhe publikohen në <i>gazetën zyrtare</i> të komunës. Shumica e komunave kanë njësi të prokurimeve publike përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në pajtim me ligjin dhe për të cilat sigurohen mjete financiare me buxhetin ose në planin financiar. Investimet në projekte investimi zakonisht raportohen në buxhetet për një periudhë prej tre vjetësh.</p> <p>Pronat: Kuvendet komunale miratojnë vendimet për strukturat e brendshme administrative të përcaktuara me Statut. Sekretariati për Çështje Pronësore dhe Juridike ndjek procedurat.⁴²</p> <p>Borxhet: Komunat në Serbi nuk mund të shpallin falimentimin, pasi komunat dhe qytetet nuk përballen me problemin e servिसimit të borxhit, por me një vonesë në pagimin e detyrimeve aktuale ose të prapambetura. Megjithatë, ekzistojnë mekanizma ligjorë që, kur zbatohen në mënyrë strikte, parandalojnë gjëra të tilla në sistemin.</p>
<p>Sllovenia</p>	<p>Planet e prokurimit: Planet e prokurimit publik miratohen nga Kryetari i komunës dhe përgatiten nga administrata bashkiake.</p> <p>Pronat: Procedura për blerjen dhe disponimin me pronën në pajtim me ligjin drejtohet nga administrata komunale. Këshilli komunal miraton vetëm vendimin për shitjen ose disponimin.</p> <p>Këshilli komunal⁴³ miraton një akt me të cilin prona e komunës përcaktohet në bazë të bilancit të pasurisë dhe inventarit.⁴⁴ Shitja e pjesëve individuale të aseteve komunale lejohet vetëm kundrejt pagesës së vlerës së tyre të plotë, e cila më pas bëhet pjesë e aseteve të komunës, përveç nëse një pjesë e aseteve është dhuruar për qëllime humanitare, edukative, shkencore ose kërkimore apo për qëllime të tjera të këtij lloji. Vendimi për dhënien e pjesëve individuale të pasurisë miratohet nga këshilli komunal. Komisioni mbikëqyrëse e mbikëqyrin menaxhimin e pronës komunale.</p> <p>Borxhet: Këshillat komunalë vendosin për marrjen e një borxhi për mbulimin e shpenzimeve aktuale dhe të ardhshme me kredi afatshkurtra. Komunat mund të kenë borxhe afatgjata për investimet e miratuara nga këshilli komunal.⁴⁵ Komunave u lejohet të bëjnë borxhe deri në një maksimum prej 10% të të ardhurave të realizuara në vitin para vitit në të cilin do të bëhen borxhet. Ripagimi i principalit dhe interesit nuk duhet të tejkalojë 5% të shpenzimeve të garantuara brenda një viti.⁴⁶</p> <p>Kontratat për borxhet e bëra firmosen nga kryetari i komunës në bazë të buxhetit të miratuar pas miratimit paraprak nga Ministri i Financave.⁴⁷</p>

42 Karakteristikat themelore të situatës në lidhje me pronën komunale në Serbi, si dhe në vendet e tjera në tranzicion, mund të formulohen si në vijim. Qytetet kanë një numër të madh të pronave (që është tipike në vendet në tranzicion). Serbia është vonë në lidhje me shumicën e vendeve post-socialiste në fushën e përkufizimeve komunale të pronës. Të drejtat e qyteteve / komunave në lidhje me pronën (dmth. E drejta për shfrytëzimin dhe disponimin e pronës) përcaktohen nga Ligji për Pronën Publike i vitit 2011. Portofoli komunal i aseteve ndryshohet për shkak të kthimit. Hapësira publike në pronësi të qyteteve / komunave përfshin një përqindje të madhe (shpesh më të madhe) të biznesit të hapësirës me qira. Komunat japin subvencione indirekte për qiramarrësit përmes çmimeve që janë më të ulëta se në treg dhe nuk vlerësojnë ose monitorojnë shumën e këtyre subvencioneve. Nuk ka plane afatmesme apo afatgjata për zhvillimin e tokës. Menaxhimi i shumë portofolave u është besuar ndërmarrjeve dhe njësive ekonomike.

43 Ligji për Financimin e Komunave (i miratuar në nëntor 2006) ka qenë në fuqi që nga 1 janari 2007. Ai zëvendësoi Ligjin e mëparshëm të Financimit të Komunave (miratuar në mars 2006 si akt i përmirësuar i versionit). Oë nga hyrja e tij në fuqi në 2007, ligji aktual është ndryshuar disa herë.

44 Të drejtat e huamarrjes së pushtetit lokal rregullohen nga Akti i Financave Publike (1999) dhe Ligji për Financimin e Komunave.

45 Kontratat për borxhet e bëra firmosen nga kryetari i komunës në bazë të buxhetit të miratuar pas miratimit paraprak nga Ministri i Financave, i cili vendos në lidhje me kërkesat për lëshimin e miratimit brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesave.

46 Komunat mund të pësojnë borxhe për financimin e ndërtimit të banesave, furnizimit me ujë dhe eliminimit dhe pastrimit e ujërave të zeza në një shumë që tejkalon 10% të të ardhurave të realizuara në vitin para vitit në të cilin do të lindin borxhet, nëse shlyerja e shumës së principalit dhe interesit në një vit të ripagimit individual nuk kalon 3% të të ardhurave të realizuara.

47 Ligji i Financave Publike në Slloveni parasheh që një komunë mund të huazoj para në bazë të pëlqimit paraprak të dhënë nga ministri përgjegjës për financa sipas termave dhe kushteve të përcaktuara nga ZFO- (decentralizimi fiskal në Slloveni, B. Brezovnik, 2014).

<p>Lituania</p>	<p>Planet e prokurimit: Kontrolluesi komunal përpilon dhe dorëzon konkluzionet e nevojshme për të marrë vendime në këshillin komunal. Këto konkluzione sigurojnë bazën për këshillin që të miratojë kushtet dhe procedurat e prokurimit publik, si dhe kushtet kryesore të një kontrate të partneritetit me subjektet private. Pasi që këshilli komunal ka përcaktuar afatet dhe procedurën e prokurimit publik, si dhe kushtet kryesore të kontratës së partneritetit me subjektet private, ai përgatit konkluzionet lidhur me draftin përfundimtar të kontratës së partneritetit me subjektet private.</p> <p>Kontrollues komunal është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e një opinioni këshillit komunal në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduar të komunës që janë paraqitur për miratim, si dhe gjetjet e nevojshme për të marrë vendime në lidhje me përdorimin nga Komuna e kredive bankare, prokurimeve, borxhet dhe huat për këtë qëllim.</p> <p>Pronat: Këshillat komunalë marrin vendime për blerjen dhe disponimin me prona publike lokale.</p> <p>Sipas ligjit, këshillat komunalë marrin vendime për menaxhimin, përdorimin dhe disponimin e tokës shtetërore dhe pronës tjetër shtetërore të caktuar në një komunë. Këshillat komunalë marrin vendime për disponimin e pronës që i takon një komune me të drejtën e pronësisë, si dhe vendosjen e rregullave për procedurën e administrimit, shfrytëzimit dhe disponimit të pronës së tillë. Borxhet: Kreditë nuk mund të tejkalojnë normat e përcaktuara me ligj.</p> <p>Borxhet: Huat nuk mund t'i tejkalojnë normat e parapara me ligj. Borxhet lejohen vetëm në përputhje me një vendim të këshillit komunal dhe vetëm në rastet kur ka mungesë të fondeve për financimin e projekteve investuese të një pushteti lokal (kredi afat-gjatë), ose për të mbuluar mungesat e përkohshme të parave në qoftë se asetet aktuale janë të pamjaftueshme (borxhet afatshkurtra).⁴⁸</p>
<p>Danimarka</p>	<p>Planet e prokurimit: Asnjë referencë nuk është bërë për planet e prokurimit në legjislacionin për qeverisjen vendore; prokurimi rregullohet nga ligjet kombëtare.</p> <p>Pronat: Çështjet që lidhen me pronën trajtohen nga këshillat komunalë në përputhje me rregulloret e brendshme.</p> <p>Borxhet: Kufizimet ligjore në lidhje me investimet, huazimet, tatimet dhe stafi janë futur në marrëveshjet e lidhura ndërmjet qeverisë qendrore dhe LGDK dhe Danske Regioner (rajonet daneze). Të ardhurat e tjera rrjedhin nga kthimet në kapital dhe investimet, kryesisht nga shitja e pasurisë dhe e interesit financiar neto.</p> <p>Komunat kërkojnë autorizim paraprak nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Brendshme për të kontraktuar hua për mbulimin e borxheve. Pas një reforme në sistemin e pushtetit vendor të Danimarkës, këshillat komunalë kanë kompetenca për të vendosur mbi investimet afatgjate brenda komunave të tyre. Për të arritur këtë, ato kanë punuar vazhdimisht për të krijuar kushte të mira në qytetet e tyre. Komunat kanë fuqinë dhe fondet për të komisionuar projektet e qytetit, duke marrë 50% të buxhetit kombëtar. Mbi gjysma e komunave në Danimarkë kanë zbatuar projekte të zgjuara (smart) të qytetit.⁴⁹</p>

48 Kufijtë e huamarrjes për autoritetet lokale që ndjekin projektet e investimeve të financuara nga burimet e BE-së janë rritur nga 3% në 6%. Ky privilegj nuk iu dha komunave të Kaunas dhe Vilniusit, sepse kushtet e tyre financiare janë më të mira në krahasim me të tjerët. Kufijtë e përgjithshëm të huamarrjes të përcaktuara me ligj për autoritetet lokale janë si vijon: për komunat e qyteteve të mëdha (Vilnius dhe Kaunas) 50%, dhe për pjesën tjetër 35% të burimeve të tyre buxhetore të aprovuara nga një autoritet lokal për vitin aktual.

49 Një **qytet i zgjuar** (smart) është një vizion i zhvillimit urban për të integruar teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe teknologjinë 'Interneti i gjërave' në një mënyrë të sigurt për të menaxhuar asetet e qytetit.

4.3.5. Kontrollat e brendshme dhe të jashtme

Kontrollat mund të jenë të brendshme dhe të jashtme. Proceset rregullohen nga ligjet kombëtare, statutet komunale dhe dispozitat e brendshme, dhe mund të kryhen me **auditime** të rregullta të bëra nga kompani të jashtme.

Maqedonia ka një nivel të kontrollit të brendshëm me kontrole të rregullta administrative, si dhe një auditor të brendshëm të identifikuar. Ministria e Financave kryen auditime të rregullta të komunave në baza të rregullta. Çdo komunë mund të presë një vizitë nga një kontrollues çdo tre ose katër vjet. Auditimi i jashtëm privat nuk është as praktikë, as detyrim.

4.3.5.1. Kontrolli i brendshëm

Në të gjitha vendet e shqyrtuara, pushteti lokal ka themeluar organe për auditim të brendshëm dhe për monitorimin e financave dhe buxheteve. Këshilli komunal përzgjedh ose emëron anëtarët e komisioneve ose organeve të auditimit të brendshëm nga radhët e anëtarëve të tij.

Shqipëria	Këshillat bashkiakë të Shqipërisë caktojnë një komision për çështje financiare të ngarkuar me monitorimin e shpenzimeve. Njësia e auditimit të brendshëm themelohet në komunë. Kjo njësi kryen aktivitetet e saj në përputhje me ligjin që rregullon auditimet e brendshme.
Serbia	Në kuvendet komunale të Serbisë , trupi që merret me çështjet financiare është Këshilli për Buxhet dhe Financa (një organ i detyrueshëm sipas statuteve komunale). Objektivat kryesore të Savet-it përbëhen nga shqyrtimi dhe dhënia e mendimeve në lidhje me çështjet buxhetore dhe financiare, buxhetin vjetor dhe llogarinë përfundimtare dhe planet financiare dhe raportet për punën e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, duke garantuar se të gjitha propozim vendimet dhe aktet që kanë implikime buxhetore shqyrtohen dhe rishikohen.
Sllovenia	Në Slloveni , këshilli komunal emëron ose shkarkon anëtarët e komisionit mbikëqyrës . ⁵⁰ Ky komision është një organ i pavarur kontrollues për financat e komunës dhe është një veçori e qeverisë lokale sllovene. Këshilli komunal emëron anëtarët e bordit mbikëqyrës. Këshilli mbikëqyrës është një organ i pavarur dhe autonom i komunës, i cili nuk duhet të jetë nën ndikimin e kryetarit ose këshillit bashkiak. Organet e komunës janë këshilli komunal, kryetari i komunës dhe bordi mbikëqyrës. Komiteti mbikëqyrës është autoriteti më i lartë i kontrollit të shpenzimeve publike në komunë. ⁵¹ Anëtarët e komitetit mbikëqyrës kryejnë <i>vullnetarisht</i> detyrat e tyre. Anëtarët e këshillit komunal, kryetari i komunës, nënkryetari, anëtarëve të këshillave të seksioneve të ngushta të komunës, sekretari i komunës, nëpunësit civil komunal, dhe anëtarët e menaxhmentit të organizatave të cilët janë përdorues të fondeve buxhetore nuk mund të jenë anëtarë të komitetit mbikëqyrës.

50 Si dhe anëtarë të tjerë të komisioneve dhe komiteteve të këshillit komunal. Anëtarët e komitetit mbikëqyrës duhet të emërohen jo më shumë se 45 ditë pas zgjedhjeve.

51 Detyrat e tij janë: të kryejë mbikëqyrjen e asgjësimit të pronës komunale; të mbikëqyrë qëllimin dhe ndjenjën e përdorimit të fondeve buxhetore; për të mbikëqyrur operacionet financiare të shfrytëzuesve të fondeve buxhetore.

<p>Lituania</p>	<p>Këshilli komunal emëron kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin e komitetit të kontrollit dhe miraton programin e punës së komitetit të kontrollit. Komiteti i kontrollit përbëhet nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të deleguar nga të gjitha grupet politike të këshilltarëve komunalë dhe një grup të këshilltarëve komunalë, në rastet kur ai përbëhet nga të paktën tre këshilltarë komunalë. Duhet të zbatohet parimi i përfaqësimit proporcional të shumicës dhe pakicës. Këshilli komunal emëron kryesuesin e komitetit të kontrollit me propozimin e pakicës (opozitës) të këshillit komunal dhe zëvendës kryesuesin e komitetit të kontrollit, me propozim të kryetarit të komunës. Organi kryesor përgjegjës për dorëzimin e raporteve financiare në këshillat komunalë është “kontrolluesi komunal” dhe shërbimi i auditimit.⁵² Kontrolluesi komunal caktohet përmes konkursit dhe shkarkohet në mënyrën e përcaktuar me ligj.⁵³ Ai kryen auditimin financiar dhe të performancës në administratën komunale, në subjektet e administruara nga komuna dhe në ndërmarrjet e kontrolluara nga komuna.</p> <p>Secila komunë ka një “shërbim të centralizuar të auditimit të brendshëm komunal”.⁵⁴ Për zbatimin e funksioneve të kontrollit të komunës dhe auditimit, këshilli komunal krijon (dhe në rast se numri i banorëve të një komune është më pak se 30 mijë veta, ajo mund të krijojë) një kontroll komunal dhe të shërbimit të auditimit me këshillë nga kontrolluesi komunal. Kontrolluesi komunal drejton këtë shërbim dhe është përgjegjës për aktivitetet e tij. Nëse nuk është themeluar një shërbim komunal i kontrollit dhe auditimit, kontrolluesit e komunave të tjera (nëpunësit publikë të shërbimit të kontrollit dhe auditimit) mund të angazhohen për të kryer auditimin e jashtëm të parashikuar në plan.⁵⁵</p>
<p>Danimarka</p>	<p>Danimarka ka një sistem të decentralizuar shumë të fuqizuar në të cilin vetë-organizimi i komunave është rregull. Komisioni buxhetor ose financiar përgatit dhe kontrollon punën për çështjet e buxhetit të pushtetit lokal me rregulla të parapara edhe në nivel kombëtar. Gjithashtu ekziston një sistem i rreptë i auditimit të jashtëm.</p>

52 Republika e Lituanië: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, 7 korrik 1994, Nr. I-533, Vilnius (I ndryshuar më 28 qershor 2016 - Nr. XII-2494), Kapitulli VI, Neni. 27.

53 Kontrolluesi komunal duhet jetë me arsim të lartë dhe të ketë së paku tre vjet përvojë pune në sferën e financave, ekonomisë, ligjit, auditimit, kontrollit ose administratës publike.

54 Republika e Lituanië: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, 7 korrik 1994, Nr. I-533, Vilnius (I ndryshuar më 28 qershor 2016 - Nr. XII-2494), Kapitulli VI, Neni. 28.

55 Këshilli komunal vendos Shërbimin e Centralizuar të Auditimit të Brendshëm Komunal gjatë miratimit të strukturës së administratës komunale.

4.3.5.2. Kontrolli i jashtëm

Auditimet e jashtme mund të sigurojnë mbështetje të vlefshme për shpenzime publike të shëndosha dhe efektive. Megjithatë, auditimet e jashtme janë mjaft të shtrenjta dhe nuk rregullohen si të tilla në **Maqedoni**.

Shqipëria	Pas një vendimi të veçantë të një këshilli komunal apo këshillit të qarkut, organet ekzekutive të një njësie të vetëqeverisjes lokale mund t'i nënshtrohet auditimit të kryer nga kompanitë e specializuara në fushën e auditimit. ⁵⁶ Secila njësi e vetëqeverisjes lokale është subjekt i kontrollit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në mënyrë të përcaktuar me ligj. Të gjitha raportet e auditimit të jashtëm ose të brendshëm mbi funksionimin e njësisë së vetëqeverisjes lokale duhet të jenë në dispozicion të publikut. Kryetari përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të të gjitha raporteve të auditimit të jashtëm dhe i paraqet këshillit raporte të rregullta për ecurinë e zbatimit. ⁵⁷
Serbia	Nuk kërkohen auditime të jashtme.
Sllovenia	Kontrolli i jashtëm kryhet nga një auditor i pavarur dhe një bord mbikëqyrës komunal (një autoritet i veçantë komunal i përbërë nga qytetarë), i cili i raporton këshillit komunal.
Lituania	Me kërkesën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Lituanisë, raportet e kontrolluesit komunal dorëzohen për mbikëqyrje të jashtme.
Danimarka	Të gjitha komunat janë të detyruara t'ia dorëzojnë llogaritë e tyre një zyre të auditimit të jashtëm.

56 Neni 54 LGS; Neni 13 LSG; Neni 40 LGS; Neni 43 LGS.

57 Këto procedura i ndjekin të gjitha nivelet e pushtetit lokal në Shqipëri. Dispozitat i referohen Kryetarit të Njesisë së Qeverisjes Vendore, përkatësisht kryetarit të bashkisë në rastin e bashkive.

4.4. Roli i këshillave komunalë në qeverisjen e mirë dhe demokracinë në nivel lokal

Qeverisja e mirë lokale nënkupton pjesëmarrje të shëndoshë dhe të barabartë të të gjitha palëve të interesuara, zgjedhje të drejta, transparencë, këshilla komunale përgjegjëse dhe pjesëmarrës, kryetarë komunash dhe organe ekzekutive përfshirëse dhe efikase. Administrata gjithashtu luan një rol esencial në ofrimin e shërbimeve dhe në zbatimin e vendimeve politike në nivel lokal. Pjesëmarrja në të gjitha nivelet dhe në çdo vendimmarrje u mundëson autoritetet publike të adresojnë nevojat e qytetarëve të tyre, duke krijuar një ndjenjë të përkatësisë dhe përgjegjësisë në mesin e tyre, gjë që nuk mund të sigurohet nëse qytetarët janë pasivë dhe të përjashtuar.

Përpjekjet për të fuqizuar qytetarët dhe për të siguruar qeverisje lokale pjesëmarrëse janë një trend i fuqishëm në të gjitha vendet e studiuara. Edhe pse kjo qasje përfshirëse ndaj pushtetit lokal ende nuk është zbatuar plotësisht, ajo po del nga iniciativat e qytetarëve ose përmes ofrimit të shërbimeve nga autoritetet lokale. Dialogu dhe **partneriteti midis shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale ofrojnë mënyra të reja për përfshirjen e qytetarëve dhe zhbllokimin e burimeve dhe potencialeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet e nevojave specifike të grupeve të cënueshme të qytetarëve. Roli i grupeve të specializuara të shoqërisë civile është vendimtar për të siguruar qasje në të drejtat ligjore për të gjithë qytetarët në nivel lokal.** Sidoqoftë, mbetet mjaft i kufizuar kur është fjala për përfshirjen e këshilltarëve komunalë pasi që i drejtohet më shumë organeve drejtuese dhe administratës.⁵⁸

Ekziston një trend në rritje dhe nevojë për **një qeverisje më transparente**.⁵⁹ Përdorimi i internetit, faqeve të internetit dhe rrjeteve sociale për të përmirësuar transparencën tani është mjaft e përhapur, megjithëse nuk ka qenë gjithnjë e dobishme. Shembull i mirë, megjithatë, është që qytetarëve u lejohet të marrin pjesë në mbledhjet e këshillave komunale.⁶⁰ Disa takime janë transmetuar edhe në internet.

Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal është gjithashtu një aspekt kyç i parimeve të SIGMA-së, me një fokus të veçantë në pjesëmarrjen e grave si një dimension themelor i politikës së përfshirjes:

SIGMA - OECD, Parimet e Administratës Publike (botimi 2017):

- Parimi 1:** Qeveria e ka hartuar dhe miratuar një agjendë për reformë efektive të administratës publike e cila adreson sfidat kryesore.
- Parimi 4:** Reforma e administratës publike ka struktura koordinuese të fuqishme dhe funksionale si në nivelin politik ashtu edhe në atë administrativ për të drejtuar dhe menaxhuar procesin e planifikimit dhe zbatimit të reformës.
- Parimi 6:** Vendimet e Qeverisë përgatiten në mënyrë transparente dhe bazohen në gjykimin profesional të administratës; sigurohet edhe përputhshmëria e këtyre vendimeve me ligjin.
- Parimi 11:** Politikat dhe legjislacioni hartohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse e cila mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë dhe mundëson koordinimin e perspektivave brenda Qeverisë.⁶¹

58 Për shembull, shpesh paraqitet zhvillimi i **veprimeve vullnetare** në mbështetje të ofrimit të shërbimeve publike dhe të së mirës publike (fushata kundër ndotjes dhe pastrimit të zonave), por në këto aktivitete rrallë angazhohen këshilltarët komunalë.

59 Në Slloveni Akti i Informimit Publik është ligji kryesor që synon sigurimin e funksionimit të hapur dhe transparent të autoriteteve publike.

60 Nga kjo ka përjashtim. Për shembull, në Shqipëri, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të mbyllet për publikun me kërkesë të kryetarit ose një të pestës së anëtarëve të këshillit.

61 http://www.sigmaweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration_Edition-2017_ENG.pdf. Më shumë hollësi janë dhënë në parimin 11 dhe ata e konsiderojnë Qeverinë Kombëtare. Megjithatë, ato gjithashtu përfshijnë "qeverinë" në nivel lokal.

4.4.1. Marrëdhëniet ndërmjet këshillave komunalë, kryetarëve të komunave dhe administratës komunale

Ky tregues është i rëndësishëm për të kuptuar marrëdhëniet midis aktorëve kryesorë të qeverisjes vendore. *De facto*, edhe për shkak të rolit më profesional të kryetarit të komunës, rasti i Maqedonisë vë në dukje një prani të fortë të tij dhe të organeve ekzekutive, të cilat ndoshta shpesh ngufasin dimensionin e KM dhe rolin e tij vendimmarrës në nivel lokal.

Maqedonia:

Kryetarët e komunave zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët. Kryetari mban pushtetin ekzekutiv dhe posti i tij është profesional. Pasiqë këshilltarët komunalë dhe kryetarët e komunave zgjidhen në zgjedhje të veçanta, ka raste në të cilat kryetari i komunës nuk është nga e njëjta parti politike si këshilltarët.

Kryetari i këshillit komunal zgjidhet nga anëtarët e këshillit me shumicën e votave. Kryetari thërret dhe drejton seancat e këshillit komunal dhe është përgjegjës për organizimin dhe punën e këshillit. Seancat e Këshillit mbahen të paktën një herë në tre muaj. Seancat mund të thirren nga kryetari i këshillit komunal, ose me kërkesë të kryetarit të komunës ose të një të katërtës të anëtarëve të këshillit komunal.

Punëtorja e politikës dhe takimet e zhvilluara si pjesë e këtij shqyrtimi treguan **se në Maqedoni nuk vlerësohet mjaftueshëm roli i këshilltarëve komunalë, të cilët mbështeten shumë mbi rolin dhe përgjegjësinë e kryetarit të komunës.**

	Si zgjidhen kryetarët e komunave/organet ekzekutive	Kush kryeson me këshillin/kuvendin komunal	Komente mbi raportet midis kryetarit/ekzekutivit dhe këshillit komunal
Shqipëria	Kryebashkiaku zgjidhet drejtpërsëdrejti nga qytetarët.	Këshillat kryesohen nga kryetari i këshillit bashkiak.	Asgjë e veçantë për t'u vënë re.
Serbia	Kryetarët e qyteteve dhe komunave zgjidhen nga kuvendet komunale. Anëtarët e këshillit komunal dhe të qytetit zgjidhen nga kuvendet komunale ose të qytetit dhe propozohen nga kryetarët e komunave ose qyteteve. Kuvendet komunale udhëhiqen nga kryetarët e kuvendeve. ⁶²	Kuvendet komunale kryesohen nga kryetarët e kuvendit. Kryetari i këshillit (<i>Predsednik Skupštine opštine</i>) është post i veçantë me një funksion tjetër në qeverinë lokale.	Organet ekzekutive të Komunës janë kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës. (Këshillat e komunave quhen kuvende komunale në Serbi). ⁶³ Kryetari i kuvendit të komunës propozon kandidatët për kryetarin e komunës. ⁶⁴
Sllovenia	Kryetarët e komunave zgjidhen drejtpërsëdrejti nga qytetarët në të njëjtat zgjedhje si për këshillat komunalë. ⁶⁵	Seancat e këshillit komunal thirren dhe kryesohen nga kryetari i komunës. Kryetari NUK ka të drejtë vote.	Këshillat komunalë mbikëqyrin veprimtarinë e kryetarëve të komunave, nënkryetarit dhe administratës komunale lidhur me zbatimin e vendimeve të këshillit komunal. ⁶⁶

62 Shihni më shumë informata për zgjedhjet dhe ndarjen territoriale në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Serbisë dhe Ligjin për Organizimin Territorial të Republikës së Serbisë.

63 Anëtarët e KK (Trupi Ekzekutiv që shoqëron Kryetarin në rastin serb) nuk mund të jenë në të njëjtën kohë anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës. Anëtarët e KK mund të jenë punonjës të rregullt të qeverisjes vendore. Organizimi i punës së Këshillit Komunal përcaktohet nga Kuvendi i Qytetit në përputhje me Statutin e Qytetit.

64 Kandidati për kryetar të komunës propozon kandidatin për zëvendës kryetarin e komunës nga radhët e këshilltarëve të zgjedhur nga kuvendi i komunës në të njëjtën mënyrë si kryetari i komunës. Kryetari i komunës kryeson këshillin dhe funksioni më i rëndësishëm i tij është "të zbatojë drejtpërdrejtë dhe të sigurojë zbatimin e vendimeve dhe akteve të tjera nënligjore të Kuvendit Komunal".

65 Rrethi i dytë mbahet nëse në rrethim e pare një kandidati nuk fiton më shumë se 50% të votave.

66 Kryetari i komunës mund të refuzojë publikimin e aktit të përgjithshëm komunal nëse beson se ky akt është jokushtetues ose i paligjshëm, në të cilin rast kryetari i komunës propozon që këshilli të miratojë një vendim të ri mbi këtë akt në seancën e ardhshme. Në këtë seancë, kryetari i komunës duhet të deklarojë arsyet e tyre për moslëshimin e aktit.

Lituania	Kryetari zgjidhet drejtpërsëdrejti nga qytetarët ⁶⁷ (që nga viti 2014 me legjislacion të modifikuar). Kryetari i komunës gjithashtu bëhet edhe këshilltar Kryetari gjithashtu bëhet këshilltar. Këshilli vendos për formimin e një këshilli komunal me rekomandim të kryetarit të komunës.	Këshillat komunalë kryesohen nga kryetarët e komunave.	Asgjë e veçantë për t'u vënë re.
Danimarka	Këshilli komunal zgjedh një nga anëtarët e tij për kryetar komune.	Këshillat komunalë kryesohen nga kryetarët e komunave. Është përgjegjësi e kryetarit të komunës të përgatis, të thërras dhe të kryesojë seancat e këshillit.	Kryetari kryeson këshillin dhe administratën dhe ndihmohet nga një ose dy deputetë, të cilët zgjidhen gjithashtu nga anëtarët e këshillit. ⁶⁸ Kryetari është menaxheri ekzekutiv i administratës dhe duhet të sigurojë që të gjitha vendimet e këshillit të zbatohen.

4.4.2. Roli i këshillave komunalë në forma të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare (referendume lokale, iniciativa qytetare, dëgjime publike dhe forma të tjera)

Janë krijuar mënyra inovative për të angazhuar qytetarët. Megjithatë, **ligjet dhe rregulloret shpesh aplikohen në mënyrë jo shumë të rreptë që të lihet hapësirë për mundësi më spontane për të bashkëpunuar, siç janë takimet publike apo seancat e rregullta të informimit dhe debatet publike.**⁶⁹ Pjesëmarrja e qytetarëve nuk është aq një det, por është më tepër një përpjekje politike dhe shoqërore për t'u angazhuar vazhdimisht me qytetarët me të gjitha mundësitë. **Referendumet lokale** përmenden në disa shtete të këtij shqyrtimi, por me pak zbatim dhe shumë shpesh me një **rol vetëm konsultativ.**⁷⁰

Maqedonia:

Tre format e pjesëmarrjes së qytetarëve përmenden në legjislacionin maqedonas:

1. **Iniciativat e qytetarëve:** Këshillat komunalë duhet të diskutojnë dhe të përgjigjen në nisma të tilla.
2. **Tubimet publike:** Mund të organizohen me iniciativë të këshillave komunalë ose me 10% të banorëve të komunës. Pas një tubimi publik, këshilli diskuton rezultatet dhe përfundimet e tij. Mbledhja dhe përcjellja e rezultateve të tubimeve publike nuk është e detyrueshme.
3. **Referendume lokale:** Mund të shpallen me kërkesë të më së paku 20% të zgjedhësve në komunë ose me iniciativë të vetë këshillit (për çështje nga kompetencat e veta). Konsultimet publike janë të detyrueshme **vetëm në rastin e planifikimit urban.**

67 Para vitit 2014, kryetarët e komunave u zgjedhën nga radhët e këshilltarëve komunalë, por ligji u ndryshua në vitin 2014 nga Seimas-i dhe tani kryetari i komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, në të njëjtën kohë me zgjedhjen e këshilltarëve komunalë.

68 Në lidhje me strukturën e organeve ekzekutive, Kopenhaga (si Aarhus, Aalborg dhe Odense) zbaton një sistem ndryshe nga komunat e tjera daneze. Në veçanti, ajo zbaton menaxhimin e përbashkët të vendimeve politike dhe administrative për sektorët e ndryshëm të ndërhyrjes komunale.

69 <https://rm.coe.int/168071a7c6>, Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal, dokumenti i Këshillit të Evropës, 2011.

70 Rezultatet e referendumit nuk janë të detyrueshme.

Në demokracinë pjesëmarrëse, praktikat shpesh janë më të rëndësishme se legjislacioni dhe rregullat. Në Maqedoni, **Forumet në bashkësi** janë një formë e rëndësishme e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Legjislacioni gjithashtu ofron forma të ndërveprimit me qytetarët: **bashkësitë lokale dhe urbane** (në maqedonisht: *mesna i urbana zaednica*). Ekziston një potencial për zhvillim më të madh të këtyre bashkësive.

Shqipëria	<p>Referendume lokale përmenden në ligj por zbatohen rrallë.⁷¹ Ato janë të detyrueshme në rastin e ndryshimit të kufijve të komunave. Megjithatë, rezultatet e referendumeve nuk janë të detyrueshme.⁷²</p> <p>Seancat e konsultimit me bashkësitë gjithashtu parashihen me ligj.</p> <p>Para shqyrtimit dhe miratimit të akteve, këshillat komunalë dhe/ose ato rajonale mbajnë seanca konsultimi me bashkësitë. Konsultimet me publikun mbahen sipas asaj që e parashohin statutet e këshillave komunalë (duke përfshirë edhe takimet e hapura me banorët dhe palët e interesuara, takimet me ekspertë, institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse, ose duke marrë iniciativën për të organizuar një referendum lokal).</p> <p>Çdo qytetar apo grup që përfaqëson bashkësinë ka të drejtë të paraqesë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve të vetëqeverisjes lokale në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale. Organet e njësive të vetëqeverisjes lokale janë të detyruara të marrin në konsideratë dhe t'u përgjigjen kërkesave, ankesave ose kundërshtimeve të tilla.</p> <p>Qytetet mund të krijojnë dhe drejtojnë këshilla të bashkësisë me iniciativën e qytetarëve të tyre. Këto mund të përbëhen nga një e katërta e banorëve dhe të organizuara në baza vullnetare. Këshillat komunalë përcaktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e këshillave të bashkësisë. Nga radhët e anëtarëve zgjidhet një oficer për lidhje për të organizuar dhe menaxhuar punën. Roli i tyre është të zbatojnë projekte në dobi të bashkësisë.⁷³</p> <p>Iniciativat e qytetarëve: Kur propozimet e paraqitura para këshillave komunalë siç janë iniciativat e qytetarëve që kanë ndikim financiar në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes lokale, ato merren në shqyrtim nga këshilli sipas agjendës dhe nuk miratohen pa u dëgjuar dhe pa shqyrtuar mendimin e kreut të njësive të vetëqeverisjes lokale.</p> <p>Shqipëria ka ndërmarrë kohët e fundit reforma të mëdha të qeverisjes vendore dhe përbërjes territoriale. Tani ka propozuar një qasje më sistemike ndaj transparencës dhe qeverisjes së mirë vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të caktojnë një koordinator të transparencës dhe të miratojnë një program transparence që siguron qasje për të gjithë, veçanërisht për komunitetet më të varfra. Promovohen dhe mbështeten konsultimet publike në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë një koordinator për njoftimet publike dhe konsultimet në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimet dhe konsultimet publike.⁷⁴</p>
------------------	---

71 Kufijtë e komunave nuk mund të ndryshohen pa dëgjuar më parë mendimin e banorëve të tyre. Kjo kusht është i detyrueshëm; megjithatë, ai nuk ka asnjë efekt detyrues. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve lokale.

72 <http://www.oldsite.idea.int/elections/dd/country.cfm?id=7>

73 Bazuar në vendimet e Këshillit Komunal, ata do të kenë të drejtë të ushtrojnë kompetenca dhe funksione të caktuara. Mund t'u delegohen fonde nga këshillat komunalë, të cilët nuk mund të përdoren si tarifa apo shpërblime për anëtarët e këshillit të komunitetit. Megjithatë, anëtarët e këshillit komunal mund të shpërblehen financiarisht për punën e tyre, në bazë të kriterëve të vendosura nga këshillat komunal dhe në pajtim me ligjin.

74 Shqipëria ishte vendi i parë në rajon për të miratuar kuadrin ligjor për të siguruar qytetarët të drejtën e informimit dhe qasjes në dokumentet zyrtare të paklasifikuara përmes ligjit nr.8503, datë 30.06.1999. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe e shoqërisë civile në vendimmarrje. http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2015/12/study_citizen_participation.pdf

	<p>Ligji për Vetëqeverisjen Vendore në Shqipëri ofron bazë për seancat e konsultimit me komunitetin. Çdo akt i miratuar nga një këshill bashkiak publikohet në faqen zyrtare të internetit dhe shfaqet në vende publike.⁷⁵</p> <p>Me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, praktikat e buxhetimit me pjesëmarrje zhvillohen në Shqipëri me njëfarë suksesi,⁷⁶ por aty përfshihen kryesisht qytetarët dhe funksionarët</p>
Serbia	<p>Format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në qeverinë lokale në Serbi përbëhen nga nismat qytetare, takimet e qytetarëve dhe referendumet.</p> <p>Iniciativat e qytetarëve: Përmes iniciativave qytetare, qytetarët mund të paraqesin propozime në kuvendet komunale për të miratuar legjislacionin që do të rregullojë një çështje të caktuar brenda kompetencës së qytetit; të ndryshojë statutin ose aktet e tjera; dhe për të thirrur një referendum në përputhje me ligjin dhe Statutin. Nismat e qytetarëve janë të vlefshme nëse lista e nënshkruesve përbëhet nga të paktën 10% e votuesve të regjistruar në listën zgjedhore në ditën e veprimit me iniciativë të qytetarëve.</p> <p>Pasi që propozimet e tilla të jenë dorëzuar, kuvendet duhet të mbajnë një seancë dëgjimore dhe të paraqesin një përgjigje të arsyetuar për qytetarët brenda 60 ditëve nga marrja e propozimit. (Kjo është një zgjidhje legjislative që është jashtëzakonisht e vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Sipas OJQ-ve lokale, është ngritur një nismë për të ndryshuar këtë dispozitë). Disa raste të buxhetit pjesëmarrës janë testuar (shih më tej).</p>
Slovenia	<p>Referendume lokale: Këshillat komunalë mund të shpallin referendum me propozim të kryetarit të komunës ose një anëtar të këshillit. Këshillat komunalë duhet të shpallin referendumin nëse kërkohet nga të paktën 5% të elektoratit komunal. Referendumi konsultativ mund të kërkohet për të gjithë komunën ose për një ose disa pjesë të saj. Rezultatet e referendumeve konsultative nuk janë të detyrueshme për organet komunale.⁷⁷</p> <p>Në vitin 2005, Slovenia paraqiti konceptin e transparencës pro-aktive të të dhënave publike. Ky është një element thelbësor për mbikëqyrjen publike të ligjshmërisë së veprimtarive të autoriteteve të sektorit publik dhe përdorimin e fondeve publike. Komisionet dhe komitetet komunale duhet të përpiqen t'i sigurojnë publikut sa më shumë informata për punën e tyre si pjesë e detyrave të tyre dhe në përputhje me autoritetet komunale.⁷⁸</p> <p>Mjete të tjera të pjesëmarrjes: Një minimum prej pesë për qind të votuesve në një komunë mund të kërkojë që aktet e përgjithshme dhe vendimet të tjera të këshillave komunalë apo organeve të tjera komunale, të lëshohen ose të shfuqizohen.</p>

75 Portali i ri për NJQV-të partnere për të inkurajuar pjesëmarrjen qytetare http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2015/12/study_citizen_participation.pdf

76 http://siteresources.worldbank.org/INTALBANIA/Resources/PBP_Toolkit_Dec_06_Eng.pdf

77 Këshilli komunal bën thirrje për një referendum brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e një vendimi ose kërkimi nga votuesit për të thirrur një referendum. Slovenia është ndër vendet kryesore në përdorimin e referendumeve kombëtare, por ka një rezultat të dobët kur është fjala për referendumet lokale. Shih më shumë në "Demokracia e drejtpërdrejtë në Sloveni: praktika e dobët në nivel lokal", nga Bernard Nezmah.

78 Ndryshimet e vitit 2005 të Ligjit (ZDIJZ-A) ishin shumë të rëndësishme në drejtim të sigurimit të transparencës më të madhe të fondeve publike. Reforma përcaktoi se informacioni në lidhje me përdorimin e fondeve publike duhet të jetë gjithmonë në dispozicion të publikut.

<p>Lituania</p>	<p>Autoritetet lokale mund të organizojnë sondazhe mbi vendimet e marra nga pushtetet lokale dhe për çështje të tjera. Sidoqoftë, këto sondazhe sipas natyrës nuk janë të detyrueshme por janë vetëm këshilluese. Nuk ka dispozitë specifike për referendumet lokale.</p> <p>Banorët e një komune mund të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në përgatitjen dhe debatimin e projekt-vendimeve, të organizojnë sondazhe, kuvende, takime, diskutime publike të peticioneve, si dhe të promovojnë forma të tjera të iniciativave qytetare.</p> <p>Një praktikë tjetër e mirë në Lituani është bashkëpunimi i grupeve të shoqërisë civile dhe qendrave kërkimore me këshillat komunalë në paraqitjen e rekomandimeve tek organet më të larta vendimmarrëse. Ka shumë forma të komunikimit midis komunave dhe OJQ-ve,⁷⁹ duke përfshirë 'orët e dyerve të hapura', takime, e-qeveri, konferenca, përfshirje në planifikimin e buxhetit komunal, biseda personale, etj. Në zonat rurale ka Grupe të Veprimit Lokal (GVL).⁸⁰</p> <p>Format e ndryshme të angazhimit të qytetarëve mund të mbështeten dhe të shqyrtohen nga këshilltarët komunalë. Megjithatë, për të qenë me të vërtetë efektiv, duhet të ketë bashkëpunim të rregullt midis administratës, udhëheqësisë së zgjedhur dhe qytetarëve.</p>
<p>Danimarka</p>	<p>Referendume lokale: Referendumet lokale të Danimarkës: Kushtetuta daneze lejon mbajtjen e një referendumi vendor. Në nivel lokal, këshillat komunalë kanë liri për të organizuar referendume lokale për çdo çështje që bie nën përgjegjësinë e tyre. Megjithatë, referendume të tilla kanë vetëm funksion konsultativ.</p> <p>Risi të tjera: Pjesëmarrja e qytetarëve, e cila gjatë kohë është praktikuar në forma të ndryshme në Danimarkë, u zgjerua me reformat e vitit 2007, përkundër reduktimit të numrit të komunave dhe qarqeve. "Samitet e qytetarëve" dhe "këshillat e qytetarëve" për tema siç janë shëndeti apo planifikimi hapësinor janë disa nga shembujt e praktikave të mira. Samitet e qytetarëve janë zhvilluar disa herë dhe përdoren kryesisht për çështje të planifikimit hapësinor dhe vizionit afatgjatë për komunitetin. Përdoren teknologjitë e reja për të paraqitur planifikimin strategjik dhe proceset e komunitetit.⁸¹</p> <p>Danimarka ka themeluar edhe Këshilla të Qytetarëve të Moshuar në disa komuna. Këshilli i Qytetarëve të Moshuar është një iniciativë shoqërore inovative që mbështet pjesëmarrjen e qytetarëve të moshuar dhe ndikimin mbi vendimet dhe veprimet në komunitetet e tyre.</p>

Rasti i buxhetit pjesëmarrës në Serbi: Buxhetimi pjesëmarrës dhe buxhetet në favor të qytetarëve përfshihen në Strategjinë e Reformës së Administratës Publike dhe Planet e Veprimit të Serbisë për 2018-2020, me referencë të veçantë për parimet e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik. **Komuna Ruma** është një nga njësitë e vetëqeverisjes lokale në Serbi në të cilën është zbatuar sistematikisht dhe vazhdimisht buxhetimi me pjesëmarrje. Përveç buxhetimit me pjesëmarrje, Komuna e Rumës gjithashtu ka praktikon publikimin e Udhëzimeve të Buxhetit Qytetar në faqen zyrtare të komunës.

79 "Relationships between Municipal and Non-Governmental Organisations in Lithuania", (Për marrëdhëniet ndërmjet organizatave komunale dhe joqeveritare në Lituani), Studim i rasteve të qyteteve Vilnius dhe Ukmerge https://www.mruni.eu/upload/iblock/237/A.%20Guogis_A.%20Stasiukynas.pdf

80 Shihni më shumë në <http://mts.asu.lt/mtsrbid/article/view/689>. Këto grupe synojnë të aktivizojnë popullatën rurale dhe organizatat e bashkësive rurale, të inkurajojnë risitë, të forcojnë konkurrueshmërinë e zonave rurale dhe të zvogëlojnë hendekun mes qyteteve dhe fshatrave.

81 <http://base-adaptation.eu/participatory-methods-applied-adaptation-planning-kalundborg-denmark>

4.4.3. Këshillat komunalë dhe përfshirja ndëretnike

Maqedonia:

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (OFA), procesi i decentralizimit synonte dhënien e të drejtave të barabarta qytetarëve nga të gjitha bashkësitë etnike lidhur me çështjet lokale. Ligji për Pushtetin Lokal i sjellë në vitin 2002 parasheh krijimin e komisioneve për marrëdhënie ndërmjet komuniteteve në të gjitha komunat, në të cilat më shumë se 20% e popullsisë përbëhet nga një bashkësi etnik e që nuk i takon shumicës. Komisione të tilla mund të themelohen në komuna të tjera në baza vullnetare. Anëtarët e këtyre komisioneve mund të jenë anëtarë të këshillave komunalë, por jo domosdoshmërisht. Numri i anëtarëve në komisione të tilla përcaktohet nga komuna. Këto komisione adresojnë çështjet e interesit për bashkësitë dhe formulojnë rekomandime për këshillin komunal. Këshilli është i detyruar t'i diskutojë këto rekomandime. Krijimi i këtyre komisioneve nuk parashihet vetëm për respektimin e të drejtave të barabarta të të gjitha bashkësive etnike në Maqedoni, por gjithashtu favorizon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën publike lokale.

Rregulloret lidhur me përfshirjen e pakicave etnike janë artikuluar në mënyrë më specifike në vendet e Ballkanit. Megjithatë, financimi i aktiviteteve të komisioneve ndëretnike dhe projektet e tyre nuk është identifikuar apo siguruar.

Ngjashmëritë

Në të gjitha vendet e shqyrtuara bëhen përpjekje për përfshirjen e **përfaqësuesve të bashkësive etnike** në zgjedhjet lokale për këshillat komunalë. Zgjidhje më të mira për bashkëjetesë paqësore mes minoriteteve dhe shumicës kanë më shumë gjasa të gjenden në nivelin lokal të qeverisjes. Kjo gjithashtu paraqet një moment të ndjeshëm që ka nevojë të gjejë ekuilibrin e duhur midis mbrojtjes së diversitetit dhe identitetit dhe qëllimit të krijimit të një shoqërie kohezive. Në Maqedoni, bashkësitë etnike përfaqësohen përmes partive politike.

Veçoritë

Shqipëria	Disa parti politike kanë dalë në zgjedhjet vendore me kandidatë nga pakicat etnike më të mëdha, megjithëse nuk ka dispozita specifike që e parashohin këtë. ⁸² Grupet e minoriteteve kanë pasur mundësinë të zhvillojnë fushatë të lirë në gjuhën e tyre në zgjedhjet e fundit . Derisa votuesit kanë pasur qasje në materialet e votimit në gjuhët e minoriteteve në vitin 2013, fletëvotimet për zgjedhjet lokale të vitit 2015 ishin vetëm në gjuhën shqipe. Megjithatë, zyrtarët zgjedhor ofruan materiale për edukimin e votuesve në gjuhët e tyre. Ndërsa pjesëtarët e minoritetit rom dhe grupet tjera të marginalizuara janë të pambrojtur ndaj shfrytëzimit politik dhe skemave të blerjes së votave, shpërndarjes së vauçerëve të karburantit dhe parave. Vëzhguesit e OSBE-së kanë vënë në dukje në vitin 2015 se bashkësitë etnike bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme për fuqinë e votës së tyre dhe më të angazhuar politikisht.
------------------	---

82 PBDNJ, e bazuar në një platformë që përfaqësonte të gjitha pakicat kombëtare, por kryesisht e lidhur me pakicën greke, dhe Minoritetet Etnike Greke për të Ardhmen (MEGA), qëndronin në mënyrë të pavarur. Aleanca Maqedonase për Integrim Evropian (MAEI) dhe Partia për Evropianizim dhe Integrim (përfshirë Romët dhe Egjiptianët) u zhvilluan si pjesë e AEA. Vërejtje, një kandidat i MEGA u zgjodh kryetar i bashkisë në Finiq dhe kandidati për kryetar komune maqedonase për komunën e Pustecit u rizgjodh. Kandidatët romë dhe egjiptianë ishin të pranishëm në listat e AEA dhe PAWD; megjithatë, ato zakonisht nuk u vendosën në pozita të fituara.

Serbia	<p>Në zonat me një prezencë të fortë të minoriteteve (kryesisht në Vojvodinë), partitë që përfaqësojnë bashkësinë minoritare janë të përfshira në shpërndarjen e mandateve, edhe në qoftë se ata kanë marrë më pak se 5% të numrit të përgjithshëm të votave (5% është pragu që një listë duhet ta arrijë për t'u përfshirë në shpërndarjen proporcionale të vendeve).</p> <p>Suksesi i partive të tilla në nivel lokal është mjaft i pabarabartë dhe varet nga kapaciteti financiar i autoriteteve lokale.⁸³ Kuadri institucional për çështje të tilla përbëhet prej një zyre për përfshirjen e romëve dhe Avokatin e Popullit në nivel lokal, ndërsa disa qytete dhe krahina autonome të Vojvodinës kanë gjithashtu një këshill lokal për të drejtat e minoriteteve dhe një zyrë për refugjatët dhe personat e zhvendosur.⁸⁴ OJQ-të kanë një qëndrim proaktiv ndaj pushtetit lokal, dhe bashkëpunimi ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale mund të konsiderohet i frytshëm, sidomos në komunat e varfra në jug të Serbisë.⁸⁵</p>
Sllovenia	<p>Ka dispozita të veçanta në Slloveni për zgjedhjen e anëtarëve të bashkësive italiane, hungareze dhe rome.⁸⁶ Në veçanti, ata gjithmonë zgjidhen sipas parimit të shumicës në këshillat komunalë me më pak se 12 anëtarë. Në secilën zonë etnikisht të përzier me një numër të madh italianësh ose hungarezësh (siç përcaktohet me ligj), këto bashkësi kanë të paktën një përfaqësues në këshillin komunal. Nëse organet komunale vendosin për çështje që lidhen me zbatimin e të drejtave të veçanta të bashkësive etnike, ata duhet së pari të kërkojnë mendim nga organi vetëqeverisës i bashkësisë etnike, i quajtur Këshilli i Bashkësisë Etnike. Në komunat etnikisht të përziera, krijohet një komision për çështjet etnike. Anëtarët e një bashkësie etnike përbëjnë gjysmën e anëtarëve të komisionit. Në zonat e banuara nga bashkësia rome, grupi rom duhet të ketë të paktën një përfaqësues në këshillin komunal.⁸⁷</p>
Lituania	<p>Një parti që përfaqëson bashkësinë polake⁸⁸ ka arritur rezultate të mira në zgjedhjet e fundit, por nuk ka asnjë dispozitë ligjore përkatëse për zgjedhjet komunale.</p>
Danimarka	<p>Në një pjesë të vendit ka një minoritet gjerman. Asgjë e veçantë nuk është parashikuar për theksimin e rolit të tyre në këshillat komunalë.</p>

83 <http://sociojalnoukljucivanje.gov.rs/en/mapping-of-social-protection-services-under-the-competence-of-local-self-governments-in-the-republic-of-serbia-survey-published/>

84 Shih më tepër rreth këshillave të minoriteteve në "The national councils of national minorities in Serbia", (Këshillat kombëtarë të minoriteteve në Serbi), nga Katinka Beretka dhe István Gergő Székely, Janar 2016.

85 Parimet e Programit të Partneritetit të Qeverisë së Hapur <https://www.opengovpartnership.org/about/about-ogp> të mishëruara në hartimin e strategjisë së RAP- Serbi 2018-2020 - Programi i qeverisjes së mirë: <http://dobraprava.rs>.

86 Nenet 6, 7, 8, LLE.

87 Në komunat ku sllovenët etnikë janë pakicë, dispozitat e këtij ligji në lidhje me përfaqësimin e bashkësive etnike italiane dhe hungareze në organet komunale duhet të zbatohen përkatësisht.

88 Veprimi zgjedhor i polakëve në Lituani - Lietuvos lenku rinkimu akcija (LLRA).

4.4.4. Dispozitat ligjore dhe politikat e orientuara drejt barazisë gjinore në nivel lokal

Sipas kërkesës në kontekstin maqedonas, shqyrtimi i kushton vëmendje të veçantë **perspektivës gjinore** dhe përfaqësimit të saj në këshillat komunalë. Në **Maqedoni**, burrat dhe gratë duhet të përbëjnë të paktën 40% të listave të kandidatëve për zgjedhjet komunale. Sistemi ligjor nuk përfshin një kuotë të tillë për listat e kandidatëve në zgjedhjet për kryetar komune. Vetëm katër prej 81 kryetarëve të zgjedhur në zgjedhjet e fundit lokale ishin gra.

<p>Shqipëria</p>	<p>Kodi zgjedhor parasheh që listat e partive politike të sigurojnë përfaqësim të barabartë me 50% të kandidatëve meshkuj dhe femra, por kjo ende nuk është arritur plotësisht. Që nga reformat e fundit territoriale, ku këshillat komunalë zgjedhin përfaqësuesit e tyre në këshillat e qarqeve, 50% e përfaqësuesve të emëruar duhet të jenë gra.⁸⁹ Ekziston një detaj i veçantë në citimin e balancës dhe barazisë gjinore në të gjitha aspektet e tyre të ndryshme në legjislacionin e fundit të Shqipërisë mbi qeverisjen vendore. Në zgjedhjet lokale të vitit 2015, 49.36 për qind (17.937 jashtë 36.341) e kandidatëve ishin gra, duke rezultuar me një pjesëmarrje të konsiderueshme të grave në këshillat vendorë. Përqindja e grave në këshillat vendorë thuhet të trefishuar që nga viti i kaluar.</p> <p>Në mënyrë domethënëse, legjislacioni kombëtar ofron trajnime për gratë kandidatë për punën e pushtetit vendor dhe aftësitë personale.</p> <p>Janë vënë në veprim aktivitete efektive për përkrahjen e angazhimit të grave kandidatë me trajnime dhe ngritje të vetëdijes për institucionet kombëtare, institucionet vendore dhe aftësitë personale lidhur me rolin e këshilltarit.</p>
<p>Serbia</p>	<p>Çdo kandidat i tretë në listat e kandidatëve duhet të jetë anëtar i gjinisë më pak të përfaqësuar (parim i së paku 30% të grave të zgjedhura). Serbia gjithashtu ka vendosur një Komision për Barazi Gjinore midis <i>Savet-eve</i> të ndryshëm (Komisioneve).⁹⁰</p>
<p>Sllovenia</p>	<p>Sllovenia ka prezantuar politikën e integritit gjinor me një akt jo-diskriminues pas pranimit të saj në BE. Në zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2006 ishte e detyrueshme të propozohej një minimum prej 20% të kandidatëve për çdo gjini. Në vitin 2010, kjo shifër u rrit në 30% dhe në 2014 në 40%, ndërsa kandidatët në gjysmën e parë të listave duhet të alternohen sipas gjinisë.⁹¹</p>
<p>Lituania</p>	<p>Lituania nuk ka ndonjë dispozitë specifike për përfaqësimin gjinor në autoritetet lokale, përveç ligjit të përgjithshëm kombëtar për përfaqësimin e barabartë gjinor.⁹² Kryeqyteti i Vilniusit ishte pushteti i parë lokal që caktoi një person përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore në vitin 2001.</p>

89 Ky balancë gjinore vlen edhe në Shqipëri për përfaqësuesit e fshatrave.

90 Në nivel kombëtar është themeluar Rrjeti Parlamentar i Grave (<http://www.womeninparliaments.org/wp-content/uploads/2014/07/Serbia-WPN-Washington.pdf>)

91 Kishte një periudhë kalimtare, me kuotën 20% në zgjedhjet lokale të vitit 2006 dhe kuotën 30% në zgjedhjet e vitit 2010, ndërsa kuota 40% u zbatua plotësisht në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2014.

92 Balanca gjinore sigurohet në sajë të Ligjit për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat dhe Komisionit Ndërmënyror për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat, i përbërë nga një gameë e gjerë e institucioneve dhe OSHC-ve.

	<p>Gratë përbëjnë 52.8% të popullsisë, por përfshirja e tyre në jetën politike dhe në administratën publike është shumë e ulët. Zgjedhjet lokale të vitit 2000 shënuan rënie në pjesëmarrjen e grave në administratën publike: përqindja e grave anëtare të këshillave komunalë ka rënë nga 22% në 1997 në 17.6% në vitin 2000. Edhe pse qëndrimet ndaj pjesëmarrjes së grave në politikë janë gjithnjë e më pozitive dhe numri i atyre që mendojnë ndryshe është në rënie të konsiderueshme, shumica e popullsisë nuk besojnë se më shumë gra në pushtet dhe vendimmarrje do të kenë ndikim pozitiv ose negativ në shoqëri. Në nivel partiak-politik, vetëm një parti përqendrohet në nxitjen aktive të angazhimit të grave,⁹³ veçanërisht duke u lidhur me përfaqësueset e grave nga partitë e vendeve të tjera. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumica e partive politike në Lituani nuk janë të vetëdijshëm për nevojën për të siguruar barazinë gjinore. Ekziston një program kombëtar që synon nxitjen e angazhimit të grave, por fondet për këtë program janë të pasigurt dhe është e vështirë të parashikohet se si do të përparojë.</p>
<p>Danimarka</p>	<p>Danimarka nuk ka ndonjë dispozitë specifike për përfaqësimin gjinor në autoritetet lokale, përveç ligjit të përgjithshëm kombëtar për përfaqësimin e barabartë gjinor. Gratë janë të nën-përfaqësuara në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Në zgjedhjet lokale të mbajtura në 2013, 29.7% e politikanëve të zgjedhur ishin gra, (nga 32% në 2009). Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, 13% të kryetarëve të komunave ishin gra, duke shënuar kështu rënie prej 17% nga zgjedhjet e vitit 2009.⁹⁴ Të gjitha autoritetet publike dhe komunat duhet të hartojnë një raport mbi barazinë gjinore çdo dy vjet që i paraqitet Ministrit për Barazi Gjinore.⁹⁵</p>

93 Rrjetëzimi brenda partisë dhe me gratë socialdemokratë nga vendet e tjera; 2) Aktivitete informative dhe edukative për anëtarët e sindikatës; 3) Deklaratat politike dhe nismat publike për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore; 4) Monitorimi i zbatimit të parimeve të barazisë gjinore brenda partisë. s. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumica e partive politike në Lituani nuk janë të vetëdijshme për të siguruar bilancin gjinor në organet politike të vendimmarrje.

94 Ekziston një Ministri për Barazi Gjinore dhe Danimarka ka miratuar një Akti për Barazinë Gjinore që përcakton që çdo organ vendimmarrës është i detyruar të punojë dhe të integrojë çështjet e barazisë gjinore.

95 Shih Deloitte, 'Ligestillingsredegørelser for kommuner, regioner og stat 2007', 2008. Shih gjithashtu të dhënat e Këshillit të Grave në Danimarkë: <http://www.womenlobby.org/Women-s-Council-in-Denmark?lang=en>

4.5. Tregues të tjerë të rëndësishëm

4.5.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe përzgjedhja e kreut të administratës

4.5.1.1. Plane të karrierës për stafin dhe nëpunësit publikë

Marrëdhënia midis këshillave komunalë dhe nëpunësve publikë lokalë është zakonisht e kufizuar, meqenëse nëpunësit publikë i raportojnë dhe kryesisht punojnë për organet ekzekutive të pushtetit lokal dhe, në veçanti, me kryetarin e komunës dhe stafin e tij. Këshilltarët komunalë marrin materiale dhe informata për vendimet e këshillit nga stafi i komunës. Në disa prej vendeve të shqyrtuara, Këshilli vendos në detaje për përbërjen e stafit të administratës, dhe në disa raste vendos madje edhe për pagat e stafit.

Maqedonia:

Rasti i Maqedonisë është veçanërisht interesant, atje këshilltarë komunalë luajnë një rol të rëndësishëm në miratimin e **planit të sistematizimit**. Paga e nëpunësve publikë është e përcaktuar me legjislacionin kombëtar, dhe nuk mund të modifikohet në nivel lokal. Në Maqedoni, kreu i administratës është sekretari i komunës.

Shqipëria	Këshilli komunal miraton numrin maksimal të punonjësve dhe institucioneve të tjera të kontrolluara nga komuna. Këshilli miraton pagat dhe normat e bonusit për punonjësit dhe personat e tjerë , të zgjedhur dhe të emëruar. ⁹⁶ Kryetari i komunës miraton strukturën e organizimit, kategoritë/klasat e pagave për secilën pozitë të nëpunësit civil, statutet themelore të administratës komunale, njësitë të buxhetit komunal, dhe institucionet e kontrolluara nga komuna.
Serbia	Kuvendet komunale të Serbisë janë gjithashtu përgjegjëse për "marrjen e vendimeve për organizimin e administratës komunale" dhe "mbikëqyrjen e punës së administratës komunale".
Sllovenia	KK miraton <i>urdhëresat dhe aktet lidhur me organizimin e aktiviteteve të administratës komunale</i> . Kryetari i komunës sjellë aktin për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale. Organizimi i brendshëm dhe fushat e punës përcaktohen nga këshilli komunal me propozim të kryetarit të komunës me një akt të përgjithshëm. ⁹⁷ Kryetari i komunës ose sekretari i komunës vendosin për emërimin dhe punësimin e stafit në administratën komunale.
Lituania	Këshillat komunalë miratojnë strukturën , rregulloret dhe fondet e pagave të administratës komunale dhe përcaktojnë numrin maksimal të mundshëm të pozitave të nëpunësve civilë dhe punonjësve. Këshilli i miraton drejtorët e administratës komunale me rekomandimin e kryetarit të komunës. Këshilli vendos për numrin e pozitave të nëpunësve publikë të besimit politik (personal) të kryetarit dhe për krijimin e sekretariatit të këshillit komunal . Këshillat komunalë gjithashtu vendosin për pagën e kryetarit të komunës dhe për numrin e nënkryetarëve.
Danimarka	Autoritetet lokale (në përputhje me rregulloret e tyre të brendshme që u japin kompetenca organeve të ndryshme, duke përfshirë këshillat komunalë) mund të përcaktojnë strukturat e tyre të brendshme administrative në mënyrë që ato t'u përshtaten nevojave lokale dhe të sigurojnë menaxhim efektiv: " <i>Kushtet e shërbimit të punonjësve të pushtetit lokal duhet të jenë të tilla që të lejojnë rekrutimin e personelit të cilësisë së lartë në bazë të meritave dhe kompetencave; Për këtë qëllim, mund të ofrohen mundësi adekuate për trajnime, shpërblime dhe perspektiva të karrierës.</i> " Komunitat dhe regjionet kanë mundësi të përcaktojnë strukturat e tyre administrative, statusin e stafit të tyre dhe mundësitë për trajnimin dhe shpërblimin e tyre . Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk përmban rregulla për strukturat administrative komunale ose trajnimin e stafit; nuk ka asnjë rregull që kufizon mundësinë që këshillat lokalë t'ia delegojnë përgjegjësitë e tyre stafit komunal.

96 Me miratimin e Ligjit të vitit 2015.

97 Në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës.

4.5.1.2. Përzgjedhja e kreut të administratës

Maqedonia:

Kreu i administratës emërohet nga kryetari i komunës dhe është një aleat dhe përkrahje e rëndësishme në menaxhimin e komunës. Megjithatë, ndonëse posti i sekretarit të komunës është detyrimisht edhe shef i administratës, vetëm 50 nga 81 komunat në Maqedoni kanë një sekretar. Kështu, pushteti ekzekutiv dhe menaxhues mbeten në duart e kryetarëve të komunave.

Shqipëria	Këshillat bashkiak emërojnë Sekretarin bashkiak .
Serbia	Këshillat komunalë të Serbisë caktojnë dhe shkarkojnë shefin dhe zëvendës shefin e administratës komunale me një njoftim publik.
Slllovenia	Kryetari i komunës është shefi i administratës komunale, ndërsa funksionimin e administratës komunale e drejton drejtpërdrejt sekretari i komunës, i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i komunës . Sidoqoftë, këshilli mund të vendosë edhe për shkarkimin e sekretarit ose kryetarit të komunës.
Lituania	Drejtori i administratës komunale emërohet me rekomandim të kryetarit të komunës, me vendim të këshillit komunal në bazë të besimit politik (personal).
Danimarka	Çdo komunë vendos se si të merret me menaxhimin e brendshëm , duke përfshirë edhe atë se kush do të drejtojë administratën. Përveç nëse vendoset ndryshe, kryetari i komunës është kreu i administratës.

4.5.2. Roli i këshillave komunalë në bashkëpunimin ndër-komunal

4.5.2.1. Bashkëpunimi ndër-komunal në nivel kombëtar

Maqedonia:

Bashkëpunimi ndër-komunal kryhet në baza vullnetare dhe i nënshtrohet miratimit të këshillave komunalë. **Një bashkëpunim i tillë mund të propozohet nga kryetari i komunës ose anëtari i këshillit të komunës, ndërsa, iniciativë për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal mund të paraqesin së paku 10% e zgjedhësve të komunës.** Bashkëpunimi ndër-komunal ka për qëllim që të ofrojë shërbime më efikase dhe racionale (për shembull, kur një komunë është shumë e vogël për të blerë vet një shërbim). Sidoqoftë, disa forma të bashkëpunimit ndër-komunal - edhe pse jo të detyrueshme - *de facto* ekzistojnë (siç është përdorimi i gjashtë deponive në baza rajonale që duhet të përdoren për të gjitha komunat e Maqedonisë). Një shembull tjetër është kur duhet të ndahen shërbimet mes dy komunave, sepse burimet njerëzore dhe financiare nuk mund të mbështesin shërbimin e dyfishtë (për shembull, një kopsht i përbashkët në mes Gradsko dhe Veles).

Bashkëpunimi ndër-komunal ekziston në të gjitha vendet e shqyrtuara. Një bashkëpunim i tillë mund të marrë formën e një marrëveshjeje midis komunave ose mund të organizohet me një kompani publike/private që ofron shërbime. **Këshillat komunalë duhet të bien dakord për krijimin dhe organizimin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe duhet të miratojnë burimet e ndara për një bashkëpunim të tillë.**

Shqipëria	<p>Lejohet bashkëpunimi ndërmjet dy ose më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore:⁹⁸ “Për të kryer funksionet e tyre dhe për të ofruar shërbime specifike për të mirën e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose shërbime të caktuara me ligj, duke hyrë ose duke zbatuar marrëveshje ose kontrata të përbashkëta, duke deleguar kompetenca dhe përgjegjësi specifike për njëri-tjetrin ose duke kontraktuar një palë të tretë.”⁹⁹ Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-bashkiak miratohen nga këshillat përkatës të secilës njësi të vetëqeverisjes vendore që është palë e marrëveshjes. Detyrimi financiar për secilën nga njësitë e vetëqeverisjes vendore që janë palë në marrëveshje miratohet çdo vit si një zë i veçantë në buxhetin vendor.</p> <p>Ekzistojnë udhëzime qendrore për bashkitë për të bashkëpunuar, për shembull për furnizimin me ujë.</p>
Serbia	<p>Bashkëpunimi ndër-komunal kontraktual merr formën e kontratave afatgjate midis dy ose më shumë njësive të vetëqeverisjes lokale, në të cilën një qytet ka rolin e një ofruesi të shërbimeve dhe njësitë e tjera të qeverisjes lokale kanë rolin e shfrytëzuesve.</p> <p>Këshillat komunalë mund të vendosin për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësitë e tjera të vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë Autoritetin e kompetencave të përbashkëta, dhe palët e treta. Komunat mund të veprojnë si themelues të Agjencive të Zhvillimit Rajonal, me ç’rast ata marrin detyrime në organet qeverisëse të themeluara. Shembuj specifikë të bashkëpunimit ndër-komunal mund të gjenden në rastin e krijimit të deponive rajonale që veprojnë si kompani publike - të menaxhuara bashkërisht nga disa komuna.</p> <p>Bashkëpunimi ndër-komunal mund të identifikohet kur dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale (ose ndërmarrjet e tyre publike) krijojnë një ndërmarrje të përbashkët, e cila mund të marrë formën e një shoqërie të përbashkët të shërbimeve ose të një ndërmarrjeje të përbashkët (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare). Bashkëpunimi ndër-komunal financohet nga buxheti lokal ose nga programet mbështetëse të donatorëve (siç është programi i BE-së i mbështetur nga BE-ja në Serbi).</p>
Sllovenia	<p>Komunitetet lokale vullnetarisht bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të bashkojnë forcat për të rregulluar dhe kryer punët lokale me rëndësi publike. Për këtë qëllim, ato mund të bashkojnë fondet e tyre dhe, në përputhje me ligjin, të krijojnë organe të përbashkëta të administratës komunale, të krijojnë dhe menaxhojnë fonde, institute publike, shoqëri publike dhe institucione dhe t’i lidhin ato së bashku për të formuar bashkësi, unione dhe asociacione.¹⁰⁰</p> <p>Shteti mund të mbulojë deri 50% shpenzimet e asociacioneve të tilla.</p>

98 Neni 14 i Ligjit për Vetë-qeverisje Lokale.

99 Më tepër rreth bashkëpunimit ndërkombëtar: Çdo marrëveshje e bashkëpunimit ndër-komunal miratohet nga këshillat e të dy qyteteve të përfshira. Njësitë e vetëqeverisjes lokale mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndër-komunal edhe me njësitë e vetëqeverisjes lokale të shteteve të huaja. Para lidhjes së marrëveshjeve të tilla, njësitë e vetëqeverisjes lokale marrin mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në këtë drejtim, marrëveshja përcakton qëllimin dhe kohëzgjatjen e saj dhe të gjitha aspektet ligjore dhe financiare, si dhe funksionet që duhet të ushtrohen nga secila komunë ose së bashku. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale brenda një regjioni ose nga regjione të ndryshme mund të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre ose me institucionet e qeverisë qendrore për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët të cilëve u japin autoritet dhe kompetenca specifike.

100 Lidhur me bashkimin, ligji përcakton mënyrën e promovimit të bashkimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe themelimit të komunave nëpërmjet bashkimit të dy ose më shumë komunave me më pak se 5,000 banorë ose bashkimin e këtyre komunave me komuna më të mëdha. Komunitet në mënyrë të pavarur marrin vendime për t’u bashkuar me komunitete dhe rajone lokale më të gjera të vetëqeverisjes. Rajonet rregullojnë dhe kryejnë çështje lokale me interes të gjerë që tejkalojnë kapacitetet e komunave. Shteti me ligj, mundet të garantojë kryerjen e funksioneve të veçanta që bien brenda juridiksionit të saj në një rajon, me pëlqimin paraprak ose pajtimin e rajonit dhe me sigurimin e mjeteve për këtë qëllim.

Lituania	Këshilli komunal merr vendime lidhur me inkorporimin, riorganizimin ose likuidimin e subjekteve juridike publike dhe private dhe vendos për të themeluar ndërmarrje të përbashkëta me komunat e tjera , për t'u bashkuar me unionet komunale, për të bashkëpunuar me komunat e shteteve të huaja ose për t'u bashkuar me organizata ndërkombëtare të vetëqeverisjes. Bashkëpunimi ndër-komunal në Lituani nuk është i detyrueshëm dhe mund të vendoset në baza vullnetare, edhe pse kjo nuk është e shpeshtë në praktikën aktuale. Forma kryesore e bashkëpunimit midis komunave është ajo e këshillave të zhvillimit rajonal .
Danimarka	Bashkëpunimi ndër-komunal është i detyrueshëm dhe vullnetar. ¹⁰¹ Me ligj, bashkëpunimi ndër-komunal është i detyrueshëm për zjarrfikësit dhe për parandalimin e aksidenteve. Autoritetet lokale gjithashtu mund të hyjnë në partneritete bashkëpunuese me kompanitë private (p.sh. për gazin natyror, transportin publik). Një bashkëpunim i tillë menaxhohet nga një organ specifik.

4.5.2.2. Bashkëpunimi ndër-komunal në nivel kombëtar

Bashkëpunimi ndër-komunal me palët e interesuara ndërkombëtare gjithashtu përshkruhet si **“bashkëpunim i decentralizuar”**.

Maqedonia:

Autoritetet lokale maqedonase kanë të drejtë të angazhohen në bashkëpunim ndërkombëtar me komunat e tjera në vendet e tjera. Këshillat komunalë janë përgjegjës për të vendosur mbi angazhimet formale dhe për angazhimin e burimeve.

Shqipëria	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale identifikon qartë të drejtat dhe detyrat e bashkëpunimit midis bashkive . <i>“Komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe të përfaqësohen në organizata ndërkombëtare në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi. Ata kanë të drejtë të organizohen në shoqata në pajtim me ligjin në fuqi.”</i>
Serbia	Komunat serbe kanë përfituar shumë nga bashkëpunimi ndër-komunal ndërkombëtar në nivel lokal, të stimuluar përmes një sërë programesh mbështetëse (p.sh. USAID dhe Programi i Progresit të BE-së në Serbinë Juglindore).
Sllovenia	Autoritetet lokale janë të autorizuara të angazhohen në bashkëpunim të decentralizuar në varësi të mjeteve financiare në dispozicion.
Lituania/ Danimarka	Bashkëpunimi ndërkombëtar funksionon kryesisht midis shteteve baltike dhe vendeve të Evropës Lindore, duke u mbështetur në miqësinë dhe bashkëpunimin e kaluar. Këshillat komunalë duhet të miratojnë hapa formale, por bashkëpunimi shpesh udhëhiqet nga ekzekutivi (gjegjesisht nga kryetari dhe ekipi i tij).

¹⁰¹ Komunat që dëshirojnë të shmangin bashkimin, duhet të nënshkruajnë marrëveshje të bashkëpunimit të ndërsjellë ligjërisht të detyrueshëm sipas statutit të miratuar enkas për këtë qëllim. Ky statut vlen për pesë komuna ishullore dhe për vetëm dy komuna të vendosura në Danimarkën kontinentale.

4.5.3. Instrumentet për ngritjen e kapaciteteve dhe skemat e motivimit për këshilltarët komunalë

Çështjet që kanë të bëjnë me ofrimin e trajnimit, duke përfshirë edhe atë se cilat organe duhet të ofrojnë një trajnim të tillë (p.sh. institucionet shtetërore, shoqatat, programet e posaçme dhe institutet e certifikuara) dhe mënyrën se si mbështetet financiarisht trajnimi, nuk janë përcaktuar gjithmonë qartë në legjislacionet dhe materialet e tjera përkatëse.

Trajnimi kombëtar për këshilltarët komunalë nuk duket të jetë një detyrim ligjor në shumicën e vendeve të shqyrtuara, edhe pse praktikohet deri diku. Sigurimi i një trajnimi të tillë duket i domosdoshëm për zhvillimin e shumë aftësive (ndërgjegjësimi, kompetencat, mirëkuptimi dhe përgjegjësia). Më shumë vëmendje i kushtohet gjithmonë mbështetjes së nëpunësve publikë (shkolla dhe programe të akredituara), posteve ekzekutive dhe zyrtarëve të zgjedhur (kryetarët). Mbështetja ndërkombëtare është përqendruar më shumë në sigurimin e ngritjes së kapaciteteve për administratën dhe ekzekutivin sesa për këshilltarët komunalë. Partitë politike shpesh zëvendësojnë këshilltarët komunalë në këtë trajnim, por ato mbeten shumë larg asaj që është e nevojshme. Programet e trajnimit për këshilltarët komunalë duhet të kenë rrugën, rolet dhe specifikat e tyre, por ato gjithashtu shpesh propozohen si një transpozim i trajnimit për nëpunësit publikë në nivel lokal, gjë që nuk është e përshtatshme.

Maqedonia:

Disa trajnime për këshilltarët komunalë janë organizuar së fundi nga organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë trajnimin për rolin e këshillave komunalë dhe për dialogun me qytetarët. BNJVL gjithashtu ka ofruar materiale trajnimi, megjithëse ato më shumë iu destinohen kryetarëve komunalë dhe autoriteteve lokale si një tërësi.

Shqipëria	Këshilltarët bashkiakë të Shqipërisë kanë të drejtën e trajnimit profesional sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak. Financimi për një trajnim të tillë është në dispozicion në përputhje me ligjin në fuqi, por nuk ka informacion të detajuar rreth trajnimit në Shqipëri.
Serbia	Trajnimi i rregullt për këshilltarët komunalë nuk është planifikuar në nivel kombëtar. Programi i trajnimit mbetet në duart e Konferencës së Përhershme të Qyteteve dhe Bashkive të Asociacionit të Qyteteve dhe Komunave të Serbisë (KPOB).
Sllovenia	Asociacioni i njësive të vetëqeverisjes lokale ofron trajnime për administratën komunale dhe këshilltarët komunalë në lidhje me prokurimet publike, partneritetin publiko-privat, kontabilitetin, financat dhe energjinë etj.
Lituania	Trajnimi për këshilltarët komunalë nuk sigurohet as nga qeveria kombëtare, as nga autoritetet lokale. Shoqata e Autoriteteve Lokale në Lituani ofron trajnim, veçanërisht në çështjet buxhetore dhe financiare. ALAL është qendra kryesore e konsultimit për autoritetet lokale. Bordet e këshillave komunalë planifikojnë prioritetet e çdo viti për këshilltarët komunalë. ¹⁰² Komunitat lituaneze kanë përfituar shumë nga përvoja e vendeve të tjera dhe modelet e organizimit komunal në shtetet baltike. Koordinatorët shumë aktivë të njësive <i>komunale të lagjes</i> në Lituani shpesh zhvillojnë kompetencat për t'u bërë këshilltarë komunalë. (Koordinatorët e njësive të lagjes kanë të drejtë të kandidohen për këshilltarë të ardhshëm komunalë).
Danimarka	Ka trajnime të rregullta falas për këshilltarët. Kohët e fundit, ky trajnim është fokusuar më shumë në këshilltarët komunalë. Një rol të rëndësishëm luan Shoqata e Autoriteteve Lokale. Dëshmitë nga hulumtimi tregojnë se një trajnim i tillë duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të ofrohet rregullisht dhe se duhet të fillojë menjëherë pas zgjedhjeve, me qëllim që të shmanget vakumi pas periudhës së zgjedhjeve.

¹⁰² ALAL ka një entitet publik: Oendra për Trajnim dhe Konsulencë ALAL. Kjo qendër organizon trajnime në fusha të ndryshme për këshilltarë komunalë dhe ekspertë komunalë etj. ALAL gjithashtu organizon trajnime për kryetarët e komunave të paktën një herë në vit dhe për ekspertët komunalë.

4.5.4. Skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të rrjetëzimit për këshilltarët komunalë

Këshilltarët komunalë nuk e ndejnë se janë pjesë e një grupi në vetvete. Ndjesia e tyre e përkatësisë është më shumë në nivel partiak dhe në nivel të qytetit dhe komunës, sesa me këshilltarë të tjerë në të njëjtin vend. Në Maqedoni, pika kryesore kolektive për këshilltarët komunalë, janë takimet e Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL), e cila siguron një mjedis të përshtatshëm për rrjetëzimin e këshilltarëve.

Shqipëria, Serbia dhe Sllovenia	Aktualisht nuk ka skema kombëtare dhe ndërkombëtare të rrjetëzimit për këshilltarët komunalë.
Lituanian	Asociacioni i Autoriteteve Lokale përfaqëson kryetarët e komunave në të gjithë vendin, por ky asociacion nuk përfshin asnjë përfaqësim të veçantë të këshilltarëve komunalë.
Danimarka	Komunat daneze janë të përfaqësuara në një asociacion kombëtare të komunave (LGDK). Komunat janë anëtarë të këtij asociacioni në baza vullnetare. LGDK ofron shërbime të ndryshme për anëtarët e saj, duke përfshirë informacionin, regjistrimin e problemeve, rrjetëzimin, trajnimin dhe arsimin. Disa shërbime duhet të paguhet (p.sh. shërbimet në lidhje me çështje të veçanta në komunat individuale), ndërsa të tjerat janë (p.sh. shërbime të lidhura me çështjet e interesit të përgjithshëm) pa pagesë, dhe disa janë në mes (gjegjësisht, shërbimet të abonimit siç janë informatat mbi ligje specifike). Ekzistojnë disa rrjete të këshilltarëve komunalë të bazuara kryesisht në përkatësinë partiake ose në elementet tematike. Siç u përmend më herët në dokument, komunat e Rajonit Baltik kanë përfituar shumë nga solidariteti rajonal dhe nga shkëmbimi i praktikave më të mira në kushte të ngjashme.

Forumet dhe mbështetja ndërkombëtare duket të jenë të rëndësishme për përfaqësuesit e anëtarëve të këshillit. Këto përfshijnë përfaqësimin e këshilltarëve në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale, ndërsa për Lituaninë dhe Danimarkën, Komiteti i Rajoneve. Gjithashtu me rëndësi është pjesëmarrja e komunave në rrjete të tjera të qyteteve që përfshijnë këshilltarët në aktivitete të ndryshme (Shembuj: ALDA - Shoqata Evropian për Demokraci Lokale, që përqendrohet në qeverisjen lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve; qytetet e energjisë, që punon në fushën e energjive të rinovueshme dhe qyteteve të zgjuar, etj.). Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këshilltarët marrin pjesë (dhe përfitojnë) në aktivitetet e rrjetit më pak se zyrtarët ose nëpunësit publikë. Përveç kësaj, NALAS paraqet një burim të njohurive dhe mbështetjes për këshilltarët komunalë në Rajonin e Ballkanit.

5. INTERVISTAT DHE MBËSHTETJA

Autori dëshiron të falënderojë:

- Partnerët nga Shqipëria – **Drejtori Juli Hoxha** dhe ekipi i saj
- Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, **Drejtori i Përgjithshëm Agron Haxhimali** dhe ekipi i tij
- Shoqata e Komunave të Danimarkës, Konsulent, zyra e Kopenhagës, **Rasmus Scheelke**
- Shoqata e Komunave të Lituanisë, Zyra e Brukselit, **Ieva Andriulaitytė, Shefe e Zyrës së Brukselit**
- Asociacioni i Komunave të Sllovenisë dhe Shoqata për Zhvillimin e Punës Vullnetare Novo Mesto, **Mitja Bukovec**
- Qyteza e Kragujevcit (Serbi), **Dobrica Milovanoviq**, ish nënkryetare e Kragujevcit
- Koordinautore e LDA Suboticë dhe SEE ALDA, **Stanka Parac**
- ALDA – Shoqata Evropiane e Agjencive për Demokraci Lokale dhe ekipi i ALDA në Shkup (**Ivana Petrovska dhe Milena Dimitrovska**), **Matteo Mirigliano, Francesco Pala**,

Për intervistat dhe vizitat në terren në Shkup:

- **znj. Kristina Kollozova**, Zyrtare e Lartë për Programin Kombëtar të Ambasadës Zvicerane
- **znj. Dushica Perishiq**, Drejtore Ekzekutive e Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë (BNJVL), **znj. Eli Çakar**, anëtare e Bordit të Projektit, dhe **z. Pllamen Georgievski**, përgjegjës për bashkëpunimin ndër-komunal, në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale
- **z. Harald Schenker**, Kryekëshilltar Teknik dhe Shef i Njësive të Qeverisjes, UNDP
- **z. Zoran Jankullovski**, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Punonjësve Financiar (AFO)
- **znj. Radmilla Sandeva**, anëtare e Bordit të Projektit, Ministria e Financave
- **z. Trajçe Donev**, kryetar i Këshillit të Bashkisë së Kisella Vodës dhe kryetar i Komitetit të Këshillave të BNJVL-së
- **znj. Luiza Vinton**, Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së
- **znj. Zhaneta Çaushevska**, Kryetare e Komunës Gradsko

6. MATERIALE DHE BIBLIOGRAFI

- Raporti për "Demokracinë lokale dhe rajonale në Danimarkë" nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës: <http://www.regioner.dk/media/1172/overvaagningsrapport-dk.pdf>
- Asociacioni i Qeverisjes Lokale të Danimarkës (LGDK): <http://www.kl.dk/English/Municipal-responsibilities/>
- Ligji i Buxhetit të Danimarkës: <https://www.retsinformation.dk/forms/r0710.aspx?id=142466#Kap5>
- Ligji Zgjedhor: LBK No. 769 i 09/06/2015 - J.nr. 2015-3732: <https://www.retsinformation.dk/pdfPrint.aspx?id=170459>
- "Integration Policies in Denmark", (Politikat e integritimit në Danimarkë) Per Mouritsen dhe Christine Hovmark Jensen (INTERACT Research Report 2014/06): http://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/32020/INTERACT-RR-2014_06.pdf
- Kushtetuta e Republikës së Lituaniës
- Ligji i Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Lituaniës
- Ligji për Strukturën Buxhetore të Republikës së Lituaniës
- Ligji për Metodologjinë e Përcaktimit të të Ardhurave Buxhetore i Republikës së Lituaniës
- Ligji për Zgjedhjet për Këshillat Komunalë - Republika e Lituaniës, 7 korrik 1994 No I-532 Vilnius, (me ndryshimet e fundit më 2 tetor 2012 - No XI-2267)
- Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale
- "The establishment of local action groups in Lithuania", (Ngritja e grupeve lokale të veprimit në Lituani) nga Vilma Atkociuniene, Ruta Petrauskiene, nga Universiteti Lituanez i Bujqësisë
- "Analysis of the finance system of Lithuanian local authorities", (Analiza e sistemit financiar i autoriteteve lokale lituaneze) nga Gediminas Davulis, nga Universiteti Mykolas Romeris
- "Lithuanian Municipal Ethics Commissions against Corruption Outsets", (Komisionet Komunale Lituaneze Etike kundër Korrupsionit) nga Algirdas Astrauska, nga Universiteti i Mykolas Romeris dhe nga Dalia Paulauskait, Komisioni Kryesor Zyrtarë i Etikës
- "Lithuania - Constitutional Rights of Local Government", (Lituania - Të drejtat kushtetuese të qeverisjes lokale) nga Vitalija Tamavičiūtė, Universiteti i Trentos, "Co.Co.A. Comparing Constitutional Adjudication" - Shkolla Verore për Interpretimin Krahasues të Jurisprudencës Evropiane Kushtetuese Edicioni i 2 - 2007
- "Citizen Participation in Local Public Service Provision and Quality Improvement", (Pjesëmarrja e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe përmirësimin e cilësisë) nga Edita Stumbraitė-Vilkišienė, nga Universiteti Mykolas Romeris
- "Budgeting in Lithuania" (Buxhetimi në Lituani), nga Ian Hawkesworth, Richard Emery, Joachim Wehner dhe Jannick Saegert, Revista e OECD *Journal on Budgeting* Vëllimi 2010/3
- "Access to electoral rights Lithuania", (Aksesi në të drejtat zgjedhore Lituani), nga Dainius Žalimas, EUDO Citizenship Observatory, qershor 2013
- Participatory aspects of strategic sustainable development planning in local communities: Experience of Lithuania", (Aspektet pjesëmarrëse të planifikimit strategjik të zhvillimit të qëndrueshëm në bashkësitë lokale: Përvoja e Lituaniës) , nga Remigijus Čiegis & Dalia Gineitiene, Zhvillimi Ekonomik dhe Teknologjik *Baltic Journal on Sustainability*, 2008, 14:2, 107-117
- "Government-Community Conflict: the Lithuanian Public Governance Challenge", (Konflikti Qeveri-Bashkësi: Sfida e Qeverisjes Publike Lituaneze) nga Mantas Bileišis, Arvydas Guogis, Aušra Šilinskytė, nga Universiteti Mykolas Romeris
- "Legal regulation on municipal budgets' expenditure", (Rregullimi ligjor i buxhetit komunal), nga Dovile Mingelaite dhe Vaitiekus Novikevicius, nga Universiteti Romeris Mykolas, Fakulteti i Ekonomisë dhe Menaxhimit të Financave, Lituani
- LFMI Releases 2015 Indeksi i Komunave të Lituaniës - <http://4liberty.eu/lfmi-releases-2015-lituanisht-municipal-index/>
- "On Relationships between Municipal and Non-Governmental Organisations in Lithuania", (Reth marrëdhënieve ndërmjet organizatave komunale dhe organizatave joqeveritare në Lituani), nga Arvydas Guogis, Andrius Stasiukynas, nga Universiteti Mykolas Romeris; botuar në *Public Policy and Administration Journal*, 2011, T. 10, nr. 1, f. 115-126 1, p. 115-126.
- <http://www.cbss.org>
- <http://www.balticcouncil.org/en/sakums/>
- <http://denmark.dk/en/society/greenland-the-faroes-and-the-german-minority/>

the-german-minority-in-denmark

- Ligji 115/2014 për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë (versioni anglisht)
- Shënim shpjegues i ligjit 115/2014 (anglisht). http://www.reformaterritoriale.al/images/presentations/relacion_projektligji_nderja_administrativo_territoriale_eng_.pdf
- Parimet e Programit të Partneritetit të Qeverisë së Hapur <https://www.opengovpartnership.org/about/about-ogp> të mishëruara në hartimin e strategjisë së RAP
- Serbia 2018-2020 Program i Qeverisjes së Mirë: <http://dobraprava.rs>.
- <http://socijalnoukljucivanje.gov.rs/en/mapping-of-social-protection-services-under-the-competence-of-local-self-governments-in-the-republic-of-serbia-survey-published/>
- "The national councils of national minorities in Serbi" (Këshillat kombëtarë të minoriteteve në Serbi) nga Katinka Beretka dhe István Gergő Székely, janar 2016





